

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË

Studime Juridike



Tiranë, Dhjetor 2016

REDAKSIA

Prof. Dr. Paskal Haxhi, Kryetar
Prof. Dr. Kudret Çela, Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Anëtare
Prof. Dr. Skënder Kacupi, Anëtare
Prof. Dr. Vasilika Hysi, Anëtare
Prof. Dr. Argita Berisha, Anëtare
Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi Anëtare

Sekretare shkencore:

Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi

Adresa e redaksisë:

FAKULTETI I DREJTËSISË
TIRANË, ALBANIA
Tel/Fax: + (355) (4) 22 25 37

© Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Revista botohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe me fondet e Fakultetit të Drejtësisë

Kopertina: Ilmi Shahu

Përgatiti për botim:

Shtëpia Botuese "FLESH" shpk
Rruga "S. Pitarka" Tiranë
Cel. +355 (0) 692033302
E-mail: botimflesh@gmail.com

ISSN - 2220-3990

Përmbajtja

Prof.Asoc.Dr. Skerdian Kurti	SUBJEKTET PËRGJEGJËS PËR KRYERJEN E VEPRAVE PENALE NË SHOQËRITË TREGTARE..... 5
Arbër BASHOLLI & Prof. Asoc. Dr. Engjëll LIKMETA	KUNDERVAJTJA, NJE PERQASJE MIDIS NORMES KANUNORE DHE BASHKEKOHORE. (RASTI I KANUNIT TE LABERISE) 21
Dr. Ervin SULKO	DISA ASPEKTE TË INTERPRETIMIT KUSHTETUES 37
Dr. Saimir SHATKU & Phd.c. Erdi KUKA	CËNIMI I PARIMIT PACTA SUNT SERVANDA NË KUADËR TË KONTRATËS SPORTIVE (rastet Matuzalem dhe Ariosa)..... 65
Msc. Marbona CUKA	INTEGRITETI DHE ROLI I TIJ NË PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT..... 81
MSc, Doktorante Linda GJERMANI	BAZAT LIGJORE TE PROGRAMEVE TE NDIHMËS SË JASHTME TË BE.....99
Msc. Agathi NANO	VEPRAT PENALE E FALIMENTIMIT NE TE DREJTEN PENALE TE EKONOMISE.....117
Msc. Ajet MAKSUTI	LIGJSHMËRIA E VEPRIMEVE TË AUTORITETIT PËRGJEGJËS KOMBËTAR NË RASTET E FLUTURIMEVE “RENEGADE” 135
Artemida HOXHAJ	KONTROLLI GJYQËSOR I AMENDAMENTEVE KUSHTETUESE. RASTI I SHQIPËRISË 151

Abstract

Prof.Asoc.Dr. Skerdian Kurti	SUBJEKTET PËRGJEGJËS PËR KRYERJEN E VEPRAVE PENALE NË SHOQËRITË TREGTARE..... 181
Arbër BASHOLLI & Prof. Asoc. Dr. Engjëll LIKMETA	KUNDERVAJTJA, NJE PERQASJE MIDIS NORMES KANUNORE DHE BASHKEKOHORE. (RASTI I KANUNIT TE LABERISE)..... 182
Dr. Ervin SULKO	DISA ASPEKTE TË INTERPRETIMIT KUSHTETUES 183
Dr. Saimir SHATKU & Phd.c. Erdi KUKA	CËNIMI I PARIMIT PACTA SUNT SERVANDA NË KUADËR TË KONTRATËS SPORTIVE (rastet Matuzalem dhe Ariosa)..... 184
Msc. Marbona CUKA	INTEGRITETI DHE ROLI I TIJ NË PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT..... 185
MSc, Doktorante Linda GJERMANI	BAZAT LIGJORE TE PROGRAMEVE TE NDIHMËS SË JASHTME TË BE..... 186
Msc. Agathi NANO	VEPRAT PENALE E FALIMENTIMIT NE TE DREJTEN PENALE TE EKONOMISE..... 187
Msc. Ajet MAKSUTI	LIGJSHMËRIA E VEPRIMEVE TË AUTORITETIT PËRGJEGJËS KOMBËTAR NË RASTET E FLUTURIMEVE "RENEGADE" 188
Artemida HOXHAJ	KONTROLLI GJYQËSOR I AMENDAMENTEVE KUSHTETUESE. RASTI I SHQIPËRISË 189

SUBJEKTET PËRGJEGJËS PËR KRYERJEN E VEPRAVE PENALE NË SHOQËRITË TREGTARE

(Disa probleme të zbatimit në praktikë të ligjit penal)

Prof.Asoc. Dr. Skerdian Kurti

Hyrje

Kryerja e një vepra penale nënkupton konfigurimin e të katër elementëve përbërës të veprës penale: objekt, anë objektive, subjekt, anë subjektive.

Me objekt të veprës penale do të kuptojmë ekzistencën e të mirave juridike apo vlerave të rëndësishme të personit, të shoqërisë, apo të Shtetit, që preken ose vihen në rrezik nga veprat penale. Mund të përmendim këtu disa prej këtyre të mirave juridike si: të drejtën për të jetuar, shëndetin, nderin dhe dinjitetin, pasurinë, pavarësinë dhe rendin kushtetues¹.

Sipas doktrinës, kërkesa e kundërligjshmërisë së veprës penale buron nga parimi themelor i ligjshmërisë në të drejtën penale dhe është në pajtim me natyrën e kësaj të fundit, e cila për shkak të rrezikshmërisë së veprës, parashikon edhe sanksione penale që janë më të rënda². Kundërligjshmëria ka karakter objektiv dhe subjektiv: karakteri objektiv lidhet me faktin se veprimi apo mosveprimi bie ndesh me normën penale; karakteri subjektiv lidhet me faktin se vepra penale duhet të jetë e kryer me faj.

Përveç elementëve të mësipërm, një rëndësi të madhe në cilësimin juridik të veprës penale merr edhe individualizimi i autorit të veprës penale ose e thënë ndryshe e subjektit aktiv të veprës penale. Subjekt i veprës penale mund të jenë jo vetëm personat fizikë por edhe personat

1 Shih, I. Elezi, E drejta penale (pjesa e posaçme), Erik, Tiranë, 2008, fq. 16.

2 Shih. I. Elezi, S. Kaçupi, M. Haxhia, Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Geer, Tiranë, 2006, fq. 45.

juridikë. Sipas ndërtimit të normave penale, subjektet ndahen në subjekte të përgjithshëm dhe në subjekte të posaçëm.

- Subjektet quhen të përgjithshëm nëse për kryerjen e një vepre penale autori apo autorët nuk duhet të jenë në posedim të ndonjë cilësie të veçantë, kanë arritur moshën për përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm: p.sh. vepra penale e nenit 76 k.p. (vrasja me dashje); vepra penale e nenit 183 k.p. (fallsifikimi i monedhave).
- Subjektet quhen të posaçëm kur për cilësimin juridik të veprës penale duhet të gëzojnë disa cilësi konkrete të veçanta. Këto cilësi duhet ti përdorë në kryerjen e veprës penale por edhe vepra penale që kryhet duhet të kërkojë përdorimin e këtyre cilësive: p.sh. vepra penale e nenit 175 k.p. (kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore); vepra penale e nenit 164 k.p. (shpërdorimi i kompetencave).

Në përgjithësi përcaktimi i subjektit përgjegjës për kryerjen e veprës penale nuk përbën ndonjë vështirësi të madhe në praktikë. Gjithsesi, duke u nisur edhe nga rastet e shumta të verifikuara në realitetin tonë, ne do të mundohemi të paraqesim më poshtë disa probleme në lidhje me përgjegjësinë penale të subjekteve përgjegjës për kryerjen e veprës penale.

1. Subjektet e posaçëm në të drejtën penale tregtare

Sipas doktrinës³, në veprat penale të shoqërive tregtare bëjnë pjesë ato vepra penale (veprime ose mosveprime) të kundërligjshme të kryera me dashje, në forma dhe mënyra të ndryshme, të cilat çënojnë ecurinë e rregullt të sistemit ekonomik të vendit.

Po paraqesim më poshtë karakteristikat e disa prej subjekteve të posaçëm të përmendur në veprat penale të shoqërive tregtare.

1.1. Eksperti kontabël

Eksperti kontabël⁴ ushtron si profesion kryerjen e kontrollit të

3 Shih, I. Elezi, E drejta penale (pjesa e posaçme), Erik, Tiranë, 2008, fq. 256.

4 Shih, Vendim i Këshillit të Ministrave n. 150, datë 31 mars 2000 “Për miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël

shoqërive tregtare⁵, ndërmarrjeve apo organizatave të tjera, të cilat detyrohen nga ligji për këtë kontroll ose e kërkojnë vetë atë. Për realizimin e këtij funksioni, eksperti kontabël kontrollon dhe jep mendimin e tij profesional për vërtetësinë e pasqyrave financiare të kontrolluara. Përdoruesit e jashtëm të informacionit kontabël (kreditorët, investitorët, bankat) që si burim informacioni kanë pasqyrat financiare të publikuara, u kushtojnë një rëndësi shumë të madhe raporteve vjetore të kontrollit të bëra nga kontabilistët. Ai mund të kryejë si veprimtari dytësore çdo mision tjetër brenda fushës së profesionit, me përjashtim të atyre që bien në kundërshtim me pavarësinë e tij ose që me ligj i janë rezervuar një profesioni tjetër: p.sh., mund ti ofrojë konsultime dhe këshillime drejtuesve të shoqërisë tregtare për probleme të ndryshme të drejtimit dhe për marrjen e vendimeve ekonomike, mund të përgatisin buxhetin për nevojat monetare të shoqërisë tregtare etj.

Sipas doktrinës, mund të dallohen dy kategori të ekspertëve kontabël⁶:

- Në kategorinë e parë bëjnë pjesë kontabilistët që punojnë si nëpunës në shoqëri tregtare të veçanta, sidomos kur ato kanë përmasa të mëdha. Ky kontabilist mund të merret me kontabilitetin financiar, me kontrollin e brendshëm ose edhe me kontabilitetin e drejtimit në njësitë ekonomike ku punon. Në këto njësi ky i fundit ka përgjegjësi dhe mund të kryejë këto proçese: a) *të kontrollojë rregullin e rregjistrimeve dhe të organizimit kontabël*; b) *të përcaktojë ndërtimin dhe organizimin e ekspertit kontabël të shoqërisë*; c) *të ndihmojë drejtuesit të kontrollojnë koston e prodhimit dhe të shpërndarjes*; d) *të regjistrojë veprimet ekonomike dhe të ndërtojë pasqyrat financiare*;

të autorizuar” (Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave n. 625, datë 12 nëntor 2001); Ligji n. 10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të rregjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.

5 Në pikën 3 të nenit 1 të LTSHT thuhet: “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare mbajnë libra kontabël, hartojnë e publikojnë të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

6 S. Dhamo, Kontabiliteti Financiar, Grevis, Tiranë 2000, fq.21

e) të bëjë analizën e pasqyrave financiare duke bërë dhe parashikime financiare; f) të mbajë kontabilitetin e të ardhurave dhe të taksave të pagueshme; g) të kryejë kontrole të brendshme; h) të mbajë kontabilitetin e veprimit dhe në disa raste mund ti jepet e drejta e çertifikimit të llogarive të drejtimit.

- Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë profesionistët kontabël të autorizuar që punojnë në shoqërinë tregtare dhe që kryejnë shërbime kontabël. Ata janë të pavaruar nga shoqëritë të cilave u kryejnë shërbimin kontabël. Ata duhet të jenë objektivë dhe të ndjekin me korrektësi parimet e pranuar të kontabilitetit në vlersimin e situatës financiare të një shoqërie të caktuar. Kontabilistët e autorizuar në përgjithësi mund të kryejnë këto shërbime: a) *shërbimin e taksave që konsiston në llogaritjen dhe planifikimin e taksave dhe tatimeve mbi fitimin, në kontrollin nëse ato aplikohen conform ligjeve në fuqi si dhe planifikimin e uljes së taksave në të ardhmen*; b) *konsultime dhe këshillime drejtuesve të shoqërisë tregtare. Duke u bazuar në aftësitë e larta profesionale që zotërojnë ata japin këshilla dhe sygjerime për problem të ndryshme të drejtimit dhe për marrjen e vendimeve ekonomike*; c) *ofrojnë shërbime të tjera kontabël si p.sh., ndërtime dhe aplikime të një sistemi kontabël, përpilimin dhe analizën e pasqyrave financiare të ndryshme, përgatitjen e buxhetit për nevoja monetare të shoqërisë tregtare, ndjekjen e klientëve etj*; d) *shërbimin e kontrollit*. Për këtë kontabilistët kontrollojnë dhe japin mendimin e tyre profesional për “sinqeritetin” dhe realitetin e pasqyrave financiare të shoqërive të kontrolluara. Përdoruesit e jashtëm të informacionit kontabël si bankat, investitorët, kreditorët, që si burim informacioni kanë pasqyrat financiare të publikuara, u kushtojnë një rëndësi shumë të madhe të raporteve vjtores të kontrollit të bëra nga kontabilistët. Nga këto raporte ata vërtetojnë dhe saktësinë e rregullave të zbatuara për mbajtjen e kontabilitetit dhe ndërtimin e raporteve vjtores financiare të njëjësive të ndryshme.

1.2. Administratorët

Sipas legjislacionit shqiptar, shoqëritë aksionare kanë të drejtë të zgjedhin ose sistemin me një nivel drejtimi (ku Këshilli i Administrimit, ka edhe funksion të kontrollit mbikëqyrës edhe funksion administrimi, dhe përbëhet nga anëtarë administratorë dhe jo administratorë) ose sistemin me dy nivele drejtimi (me Këshill Mbikëqyrës, i cili ka funksion të kontrollit mbikëqyrës, dhe anëtarët e të cilit nuk janë administratorë; dhe Administratorë, të cilët kanë funksion administrimi).

- Në rastin e shoqërisë tregtare që ka zgjedhur një nivel drejtimi, Këshilli i Administrimit u jep direktiva Administratorëve dhe ndjek e mbikëqyr zbatimin e tyre; kujdeset që shoqëria tregtare t'i përmbushë detyrimet e veta për respektimin e kërkesave ligjore; harton raportet përkatëse vjetore; merr në marrëdhënie pune dhe vendos pagën e administratorëve dhe kujdeset në përgjithësi për drejtimin e duhur të aktivitetit tregtar të shoqërisë.
- Në rastin e shoqërisë që ka zgjedhur sistemin me dy nivele të drejtimit, shoqërinë tregtare e drejtojnë administratorët, të cilët marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikës tregtare ndërsa Këshilli Mbikëqyrës vlerëson vënien në zbatim të politikës dhe kontrollon respektimin e kërkesave ligjore nga shoqëria tregtare. Në përputhje me praktikat më të mira, bashkëpunimi ndërmjet administratorëve dhe këshillit mbikëqyrës duhet të ndjekë këto drejtime: administratorët dhe këshilli mbikëqyrës duhet të bashkëpunojnë nga afër për të mirën e shoqërisë tregtare; administratorët dhe këshilli mbikëqyrës duhet të kenë përgjegjësi solidare për t'i dhënë informacion të mjaftueshëm këshillit mbikëqyrës; administratorët dhe këshilli mbikëqyrës duhet të angazhohen në diskutime të hapura, duke ruajtur plotësisht fshehtësinë e informacionit.

Sipas legjislacionit, administratorët⁷ detyrohen të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të

7 Shih, nenin 95 dhe 158 të LTSHT

rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

1.3. Anëtarët e këshillit mbikqyrës

Nëse administratorët janë përgjegjës për drejtimin e shoqërisë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, anëtarët e këshillit mbikqyrës⁸ monitorojnë vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin. Më konkretisht këshilli mbikqyrës duhet të ushtrojë këto funksione: a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët; b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë; c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë; ç) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit; d) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë; dh) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një

8 Shih nenin 154 dhe 167 të LTSHT

përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar; e) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën “dh” të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit; ë) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre; f) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve; g) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Anëtarët e këshillit mbikqyrës duhet gjithashtu të thërrasin asamblenë e përgjithshme nëse: a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim; b) kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara; c) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

1.4. Likuiduesi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Gjykata emëron likuiduesin⁹ në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc

9 Shih, nenet nga 190 deri 203 LTSHT

përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

2. Subjekti i përgjithshëm që ushtron konkretisht funksionet e subjektit të posaçëm

Mund të ndodhë që gjatë zhvillimit të aktivitetit tregtar, funksione të cilat sipas ligjit duhet të kryhen nga persona që gëzojnë karakteristika të veçanta, kryhen konkretisht nga subjekte të tjerë që nuk i kanë këto karakteristika: p.sh. babai që menaxhon shoqërinë tregtare, administrator i së cilës rezulton të jetë formalisht djali i tij.

Në ipoteza të këtij lloji, shtrohet para së gjithash një pyetje që lind natyrshëm: a mund të ndiqet penalisht edhe personi që konkretisht ushtron funksionet e posaçme edhe pse nuk gëzon cilësitë e veçanta të kërkuara nga ligji?

Sipas mendimit tonë, në raste të tilla është e pamundur zbatimi i normës penale juridike, pasi po të ndodhte ndryshe do të kishim një kontrast me parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 2 k.p.: *askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose si kundërvajtje penale*. Bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që të ekzistojnë elementët e një figure të veprës penale të parashikuar nga ligji penal: në rast se mungon një nga elementët e figurës së veprës penale, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose edhe në qoftëse ka filluar duhet të pushojë¹⁰.

Mendojmë se në raste të tilla, personat që konkretisht ushtrojnë funksione të posaçme pa pasur cilësitë e nevojshme të kerkuara nga ligji nuk duhet të ndiqen penalisht as si bashkëpunëtorë (në rolin e bashkekzekutorit) të subjekteve që *de jure* ushtrojnë ato funksione: p.sh., në bazë të nenit 164 k.p. "*shpërdorimi i kompetencave*"¹¹, do të ndiqet

10 Shih. I. Elezi, S. Kaçupi, M. Haxhia, Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Geer, Tiranë, 2006, fq. 88.

11 Neni 164 i Kodit penal: "Shpërdorimi i kompetencave nga anëtarët e këshillit mbikqyrës apo administratorët e shoqërisë me qëllim përfitimi apo për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet".

penalisht administratori që shpërdoron kompetencat me qëllim përfitimi apo favorizimi të një shoqërie tjetër ku ka interesa; nëse këtë sjellje antiligjore do e bënte një person tjetër që *de facto* ushtron funksionet e administratorit por që nuk i gëzon cilësitë e kërkuara nga ligji atëherë ky person nuk do të mund të ndiqej penalisht për shkelje të nenit 164 k.p., jo vetëm si përgjegjës i drejtëpërdrejtë i shkeljes së dispozitës penale por as si bashkëpunëtor i administratorit të vërtetë të shoqërisë tregtare. Ky argumentim mbështetet tek vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr. 1 datë 26 mars 2002, sipas të cilave kur ndodhemi para figurave specifike të veprës penale (*delictum proprium*) në të cilat bashkezekutimi është i mundur vetëm midis personave që janë mbajtës të disa cilësive të veçanta për të qenë subjekte të disa veprave penale (subjekte të posaçme), vepra penale e kryer prej tyre do të cilësohet sipas dispozitës së pjesës së posaçme të Kodit Penal, subjekt i të cilës mund të jenë vetëm personat që janë mbajtës të këtyre cilësive të veçanta¹².

Për ti dhënë zgjidhje një problemi të tillë që mund të ndeshet në praktikën tonë jurisprudenciale, dhe të mos ngelen pa u dënuar personat (subjekte të përgjithshëm) kundrejt të cilëve nuk mund të zbatohet një normë specifike penale me subjekt të posaçëm, vlen të përmendet si zgjidhje e mundshme orientimi maxhoritar i doktrinës dhe i jurisprudencës italiane, sipas së cilës lejohet zbatimi i normës penale edhe në ato raste kur sjellja e jashtëligjshme kryhet nga një subjekt i përgjithshëm i cili merret konkretisht me menaxhim e punëve që u përkasin subjekteve të veçanta të përcaktuara nga ligji¹³.

Një zgjidhje e tillë e këtij problem do të ngarkonte me përgjegjësi penale (në formen e bashkëpunimit) edhe subjektin e posaçëm (administratorin *de jure*) i cili me anë të mosveprimit të tij do t'ia

12 Shih. Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, n. 1 datë 26 mars 2002.

13 Ky mendim bazohet në parimin e efektivitetit të zbatimit të normës penale i cili duke iu referuar figurës “*së funksionarit konkret*” në të drejtën administrative, i jep përparësi rrethanave aktuale ndaj atyre formale. Shih. E. Musco, *Diritto penale societario*, Giuffrè Editore, Milano, 1999, fq. 22.; Vendim i Gjykatës së Lartë italiane, Cass., sez. V pen., 04.06.1998, Platania, në Riv. Cass. Pen., 2001, fq. 1622.

lehtësonte kryerjen e sjelljes antiligjore subjektit që konkretisht ushtron funksionet specifike pa gëzuar cilësitë e kërkuara nga ligji.

Megjithatë, zgjidhja më e mirë e mundshme për të parandaluar abuzimin me anë të kësaj skeme është ndërhyrja e legjislatorit dhe rregullimi i këtyre normave penale duke shtuar tek subjektet përgjegjës edhe ato subjekte që nuk gëzojnë cilësitë e kërkuara nga ligji por që *de facto* ushtrojnë funksionet e subjekteve të posaçëm.

3. Bashkëpunimi i subjektit të përgjithshëm (*extraneus*) në rastet e *delictum proprium*

Një problem tjetër i rëndësishëm jo vetëm për veprat penale në shoqëritë tregtare por edhe për të gjitha ato vepra penale që hyjnë në kategorinë e *delictum proprium* ka të bëjë me përgjegjësinë penale të subjektit që nuk gëzon cilësitë e kërkuara nga ligji në rastet kur bashkëpunon me subjektin e posaçëm për kryerjen e sjelljes antiligjore: p.sh., rasti i bashkëpunimit të administratorit të shoqërisë tregtare me ekspertin kontabël të kësaj shoqërie për të paraqitur një bilanc të rremë (dhënia e informacioneve të rreme, neni 168 k.p.).

Nuk ka dyshim që në këtë rast eksperti kontabël do të mbajë përgjegjësi penale për dhënien e informacioneve të rreme (neni 168 k.p.) kryer në bashkëpunim. Të këtij orientimi janë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat me anë të vendimit Nr.4, datë 15.04.2011 arritën në përfundimin unifikues se *kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paafësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë.*

Problemi qëndron nëse do të mbajë apo jo përgjegjësi penale edhe administratori në rastin e kryerjes së veprës penale të parashikuar në nenin 168 k.p. edhe pse nuk zotëron cilësitë e veçanta të kërkuara nga ligji.

Në bazë të nenit 25 k.p., "*bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre*", ndërsa sipas

nenit 27 k.p., “*organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi si edhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre*”.

Sipas mendimit tonë, edhe në rastet e *delictum proprium*, bashkëpunëtorët që nuk i zotërojnë cilësitë e veçanta të kërkuara nga ligji (*extraneus*) do të mbajnë përgjegjësi penale në të gjitha ato raste kur janë të vetëdijshëm për cilësitë e veçanta që disponon subjekti i posaçëm (*intraeus*). Ky mendim argumentohet me faktin se sipas doktrinës¹⁴ dhe jurisprudencës tonë¹⁵, për konfigurimin e institutit të bashkëpunimit kërkohet ekzistenca e qëndrimit subjektiv në raport me veprimet e secilit bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale, që shprehet me anë të arritjes së marrëveshjes mes tyre në kryerjen e saj.

Ky lloj bashkëpunimi do të ekzistojë jo vetëm në ipotezën kur subjekti *extraneus* jep një kontribut “material” (p.sh., roja i godinës ku janë vendosur zyrat e shoqërisë tregtare i cili së bashku me ekspertin kontabël të shoqërisë shpërndajnë një sekret që do të ndikojë në ecurinë e shitjeve të produkteve që prodhohen nga kjo shoqëri do të mbajnë përgjegjësi penale për shkelje të nenit 169 k.p. “*zbulimi i sekreteve të shoqërisë*”) por edhe në rastin kur jep një kontribut “moral” (p.sh. drejtori i përgjithshëm i shitjeve nëpërmjet këshillave nxit administratorin e shoqërisë tregtare për mosbërjen e disa shënimeve në lidhje me disa shitje të veçanta duke shkelur nenin 170 k.p. “*mosbërja e shënimeve të detyrueshme*”). Të

14 Shih. A. Koça, Grupi i strukturuar kriminal – si formë e veçantë e bashkëpunimit, në Rev. Stud. Jur., n.2, Fakulteti i Drejtësisë (UT), Tiranë, 2005, fq. 193. Sipas këtij autori, “*qëndrimi subjektiv shprehet në synimin për harmonizimin e veprimeve të secilit prej pjesëmarrësve që do të ndikonte në lehtësimin e arritjes të së njëjtës pasojë kriminale dhe uljen e mundësive për tu zbuluar*”.

15 Shih, Vendim i Kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, n. 394 datë 8 korrik 2009. Sipas këtij Kolegji, “*kusht themelor për të patur bashkëpunim në kryerjen e veprës penale është arritja e marrëveshjes midis bashkëpunëtorëve, e cila duhet ose të ekzistojë më parë ose gjatë kohës së kryerjes së krimit në mënyrë të heshtur, që do të thotë që secili nga personat që marrin pjesë në kryerjen e veprës penale, të kryejë veprime që drejtperdrejt të lidhen me pasojën e dëshiruar, e cila vjen si rezultat i këtyre veprimeve të kryera nga çdo person pra, kërkohet që çdo person me veprimet ose me mosveprimet e tij të marrë pjesë në realizimin e veprës penale*”.

njëjtin mendim ndan edhe doktrina italiane kur shprehet në lidhje me bashkëpunimin në rastet e veprave penale me subjekte të posaçme¹⁶.

4. Përgjegjësia penale e organeve me shumë subjekte

Në disa shoqëri tregtare, kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë i delegohen një organi të specializuar administrues të përbërë nga disa persona. Po ashtu kontrolli i veprimtarisë së shoqërisë tregtare mund të kryhet nga organe të posaçme të përbëra nga shumë subjekte.

Kështu sipas nenit 95 të ligjit n. 9901 datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, asambleja e përgjithshme e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, ndërsa sipas nenit 158 (sistemi me një nivel) dhe 167 (sistemi me dy nivele) të po këtij ligji, asambleja e përgjithshme apo këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët.

Ndërsa sipas paragrafit të parë të nenit 1 të VKM, n. 150 datë 31 mars 2000 (të ndryshuar) “Për miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të autorizuar”, eksperti kontabël i autorizuar ushtron si profesion kryerjen e kontrollit të shoqërive tregtare, ndërmarrjeve apo organizatave të tjera, të cilat detyrohen nga ligji për këtë kontroll ose e kërkojnë vetë atë. Ndërsa sipas nenit 4 të po kësaj VKM-je, ekspertët kontabël të autorizuar mund ta ushtrojnë profesionin e tyre ose në mënyrë të pavarur (individuale), ose të grupuar në shoqëri, apo si të punësuar tek një ekspert tjetër i pavarur ose tek një shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Si rrjedhim, paraqet rëndësi të veçantë fakti i shpërndarjes së përgjegjësisë penale në rastet e kryerjes së një veprë penale gjatë ushtrimit të detyrave specifike nga ana e organeve me shumë persona.

Duhet të kemi parasysh se këtu nuk bëhet fjalë për rastin kur të gjithë

16 Të njëjtin mendim ndan edhe doktrina italiane kur shprehet në lidhje me bashkëpunimin në rastet e veprave penale me subjekte të posaçme. Shih. G. Marinucci, E. Dolcini, Manuale di diritto penale: parte generale, Giuffrè Editore, Milano, 2004, fq. 278.

pjestarët e organit kolegjal bien dakord për të kryer një sjellje antiligjore, pasi në këtë rast të gjithë ata do të mbajnë përgjegjësi penale për normën e shkelur në kushtet e bashkëpunimit: p.sh. në rast se administratorët e një shoqërie aksionare bien dakord për të mos bërë shënimet e detyruara të përcaktuara nga ligji do të mbajnë përgjegjësi penale në bazë të nenit 170 dhe 25 k.p.

Situata do të ndërlikohet në rast se ndonjëri nga pjestarët e organit kolegjal nuk merr pjesë në diskutimin që paraprin marrjen e një vendimi antiligjor nga ana e këtij organi; ose në një rast tjetër kur njëri nga administratorët nuk po e kuptonte se po merrej një vendim që përbënte një vepër penale.

Kështu në bazë të nenit 164 të LSHT, anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratorët përgjigjen në mënyrë solidare për: vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së organizimit të shoqërisë, si ato vijuese, por pa u kufizuar në to, informacionin për sistemin e menaxhimit të riskut të shoqërisë, prospektet e veprimtarisë, planet e investimeve, burimet teknike, organizative dhe burimet, strukturat e praktikave të miradministrimit të shoqërisë. Ndërsa në bazë të nenit 170 k.p. do të mbajnë përgjegjësi penale të gjithë ata administratorë që nuk bëjnë shënimet e detyrueshme.

Le ta ilustrojmë me një shembull: Jemi në një shoqëri tregtare (sh.a.) që ushtron aktivitetin e saj në fushën e industrisë farmaceutike: Administrimi i kësaj shoqërie i është besuar një organi kolegjal të përbërë nga 5 administratorë, dy prej të cilëve janë diplomuar për ekonomi, dy për juridik dhe një për kimi. Ky organ në bazë të nenit 164 të LSHT ka detyrimin për të kontrolluar vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare të shoqërisë tregtare. Çfarë do të ndodhë kur administratori i diplomuar në kimi nuk arrin të kuptojë se vendimi që po merret në lidhje me vërtetësinë e pasqyrave financiare është i jashtëligjshëm pasi bilancet e shoqërisë janë të falsifikuara? A do të ketë përgjegjësi penale ky administrator për kryerjen e një sjellje të jashtëligjshme nga ana e organit pjesë e të cilit është edhe ai vetë?

Sipas mendimit tonë, për të përcaktuar përgjegjësinë penale të pjesëtarve të organeve kolegjiale është shumë e rëndësishme të studiohet

aspekti subjektiv i çdo anëtari të organit kolegjal në lidhje me marrjen e një vendimi të jashtëligjshëm.

Si rrjedhim, nëse në bazë të hetimeve që do të zhvillohen do të rezultojë se ky administrator ka vepruar me pakujdesi atehere kundrejt tij nuk do të zbatohet asnjë normë penale, por ai do të ketë vetëm detyrimin civil për të dëmshpërblyer shoqërinë ose kreditorët e saj nga dëmet e shkaktuara nga ky veprim antiligjor. Por edhe në këtë rast, sipas doktrinës dominuese, përgjegjësia civile do të ekzistojë vetëm atëhere kur anëtari i organit kolegjal nuk do të mundet që të provojë përmbushjen e detyrimit të kujdesit që ai i detyrohet shoqërisë¹⁷.

Nga ana tjetër, nëse në bazë të hetimeve do të rezultojë se administratori ka vepruar me dashje, atehere kundrejt tij do të zbatohet neni 170 k.p. në rast se do të ekzistojnë edhe elementët e tjerë përbërës të figurës së veprës penale.

Përsa i përket formave të dashjes, jemi të mendimit që në këto raste dashja mund të jetë e pranishme në të dyja format e saj: por nëse në rastin e dashjes direkte nuk ekziston asnjë lloj problemi për zbatimin e normës penale, në rastin e dashjes indirekte interpretimi i normës bëhet më i debatueshëm, edhe për vetë ngjashmërinë që ekziston mes saj dhe vetëbesimit të tepruar. Megjithatë, sipas mendimit tonë, anëtari i një organi me shumë subjekte do të ketë përgjegjësi penale edhe në rastin kur kryen një sjellje antiligjore me dashje indirekte. Kështu, administratori i një shoqërie tregtare që nuk merr pjesë në votimin për vërtetësinë e pasqyrave financiare të shoqërisë, do të mbajë përgjegjësi penale nëse do të rezultojë se ai e dinte që ai votim do të ishte i jashtëligjshëm por gjithsesi nuk u përpoq për t'iu kundërvënë, duke pranuar në mënyrë indirekte ardhjen e pasojave të jashtëligjshme për shoqërinë tregtare dhe kreditorët e saj; e thënë ndryshe, administratori i parashikon pasojat, nuk i dëshiron por me vetëdije lejon ardhjen e tyre.

17 Shih. Th. Bachner, E. Schuster, M. Winner, Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare: interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane, Guttenberg, Tiranë, 2009, fq. 130.

Përfundime

Si përfundim mund të themi se njohja e karakteristikave të subjekteve të posaçëm që kryejnë veprat penale paraqet një rëndësi të madhe për të realizuar një cilësim juridik sa më të saktë.

Pikësëpari duhet treguar kujdes në ndëshkimin e atyre personave që konkretisht ushtrojnë funksionet e posaçme edhe pse nuk gëzojnë cilësitë e veçanta të kërkuara nga ligji. Sipas mendimit tonë, zgjidhja më e mirë e mundshme për të parandaluar abuzimin me anë të kësaj skeme është ndërhyrja e legjislatorit dhe rregullimi i këtyre normave penale duke shtuar tek subjektet përgjegjës edhe ato subjekte që nuk gëzojnë cilësitë e kërkuara nga ligji por që *de facto* ushtrojnë funksionet e subjekteve të posaçëm.

Së dyti jo me pak i rëndësishëm paraqitet rregullimi i përgjegjësisë penale të subjektit që nuk gëzon cilësitë e kërkuara nga ligji në rastet kur bashkëpunon me subjektin e posaçëm për kryerjen e sjelljes antiligjore. Sipas mendimit tonë, ky lloj bashkëpunimi do të ekzistojë jo vetëm në ipotezën kur subjekti *extraneus* jep një kontribut “material” por edhe në rastin kur jep një kontribut “moral”.

Së fundmi duhet treguar kujdes edhe për përcaktimin e përgjegjësisë penale të organeve me shumë subjekte. Sipas mendimit tonë, për të përcaktuar përgjegjësinë penale të pjesëtarve të organeve kolegjiale është shumë e rëndësishme të studiohet aspekti subjektiv i çdo anëtari të organit kolegjial në lidhje me marrjen e një vendimi të jashtëligjshëm.

Referencat e librave

Bachner, TH. Schuster, E. & Winner, M. (2009), Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare: interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane, Tiranë.

Dhamo, S. (2000), *Kontabiliteti Financiar*, Grevis, Tiranë.

Elezi, I. (2008), *E drejta penale: Pjesa e posaçme*, Tiranë.

Elezi, I. Kaçupi, S. & Haxhia, M. (2006), *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë.

Koça, A. (2005), Grupi i strukturuar kriminal – si formë e veçantë e bashkëpunimit, *Studime Juridike* 2, Tiranë.

Marinucci, G. & Dolcini, E. (2004), Manuale di diritto penale: parte generale, Milano.

Musco, E. (1999), Diritto penale societario, Milano.

Kode dhe ligje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Ligji Nr.9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.

Ligji Nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 150, datë 31 mars 2000 “Për miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të autorizuar” (Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave n. 625, datë 12 nëntor 2001).

Ligji Nr. 10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të rregjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.

KUNDERVAJTJA, NJE PERQASJE MIDIS NORMES KANUNORE DHE BASHKEKOHORE (RASTI I KANUNIT TE LABERISE)

Doktor në proces Arbër BASHOLLI
Prof. Asoc. Dr. Engjëll LIKMETA

1. Hyrje

Shteti dhe e drejta janë dy fenomene shoqërore që kanë lindur në kushte konkrete historike dhe janë zhvilluar e ndryshuar sipas kushteve politike dhe ekonomike shoqërore të çdo vendi. Në rendin shoqëror parashetëror, kuptohet që në mungesë të organeve shtetformuese mungonin edhe ligjet¹.

Duke parë dhe studiuar zhvillimin historik të legjislationit shqiptar, deri në kodifikimin e parë të tij, normat juridike, qofshin këta penale apo administrative, me origjinë shqiptare, kanë qenë kryesisht norma të së drejtës zakonore².

Burimet kryesore të normave të së drejtës zakonore shqiptare ishin gojëdhënat popullore, nga është mbledhur dhe materiali në kanunet vendore³. Kanunet ishin një lloj kushtetute e pashkruar, të cilat ishin mbledhur dhe modifikuar nga persona nga real historik, por edhe nga persona apo figura mitologjike⁴.

1 Elezi, I., & Elezi, E., *Historia e së drejtës penale*, shtëpia botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2010, f. 11.

2 Turkeshi, E., *Mbrojtja juridike penale e mjedisit*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2014, f. 54.

3 Elezi, I., *E drejta zakonore penale e shqiptarëve*, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1983, f. 31.

4 Cana, J., *“Insitucioni i Kuvendit sipas të drejtës zakonore labe”*, tezë doktrature, Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2012, f. 66.

Këto kanune krahas të përbashkëtave që kishin me njëri tjetrin karakterizoheshin edhe nga dallimet në lidhje me institucione e organe të ndryshme të së drejtës⁵. E drejta kanunore si e drejtë e fshatërisë malësore të lirë⁶ mund të konsiderohet me të drejtë si një fazë e re, paraprake e ngritjes së shtetit dhe së drejtës në Shqipëri⁷.

Një nga kanunet më të rëndësishme që ka arritur deri më sot është edhe Kanuni i Labërisë⁸ që është mbledhur nën kujdesin e profesorit të shquar Rrok Zojzi dhe kodifikuar me përkushtim nga profesori i së drejtës penale Profesor Ismet Elezi. Kundërvajtjet zënë një vend të qënësishëm në kanun.

2. Kuptimi i kundërvajtjes

Kundërvajtjet, qofshin këta me natyrë administrative apo penale, duke qenë vepra me rrezikshmëri shoqërore, kanë qenë dhe janë ndër institucionet më të rëndësishme të së drejtës në tërësi, si dhe të drejtës administrative dhe penale në veçanti, por studimit të tyre nuk i është kushtuar rëndësia dhe vendi i duhur në literaturën tonë juridike⁹.

Në kushtet e sotme të shoqërisë sonë, kur procesi i thellimit të demokratizimit të vendit është i pashkëputur nga ai i forcimit të shtetit

5 Grup autorësh, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri II*, shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë, 1997, f. 6.

6 Mandro, A., *Organizimi shtetëror dhe e drejta në pashallëqet kryesore shqiptare*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1992, f. 202.

7 Mandro, A., *Organizimi shtetëror dhe e drejta në pashallëqet kryesore shqiptare*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1992, f. 202.

8 Cana, J., *“Insitucioni i Kuvendit sipas të drejtës zakonore labe”*, tezë doktrature, Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2012, f. 66.

9 Dobjani, E., *Kundërvajtjet administrative në Shqipëri*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1991, f. 2.

tonë juridik, problemet që kanë lidhje me kundërvajtjet marrin përparësi në kuadrin e reformës ligjore që po kryhet në vend¹⁰.

Lidhur me kundërvajtjet me natyrë penale, në përmbajtjen e kanunit bënin pjesë normat që parashikonin veprat penale dhe dënimet përkatëse, sipas një sistemi të caktuar, normat procedurale të pashkruara të hetimit e të gjyqimit të çështjeve penale. E drejta zakonore shqiptare parashikonte shkelje të tjera, të cilat njësoheshin me kundërvajtjet me natyrë administrative (dëmet)¹¹.

Po cili ishte kuptimi i dhënë nga norma kanunore labe në lidhje me kundërvajtjet apo shkeljet e rregullave të vendosura në njësinë e bashkësisë vendore ?

Me qëllim marrjen e një kuptimi përfundimtar lidhur me kundërvajtjet në krahinën e Labërisë, ne duhet t'i referohemi normave kanunore të saj. Kështu, sipas nenit 871 të Kanunit të Labërisë, me shkelje të rregullave të sjelljes të vendosura nga Këshilli i Pleqve apo Kuvendi i burrave duheshin kuptuar të gjitha ato veprime apo mosveprime që cenonin rendin dhe qetësinë e komunitetit si dhe synonin shmangien nga detyrimet e përbashkëta të bashkësisë pa ndonjë shkak të arsyeshëm¹².

Në tërësinë e këtyre veprimeve (kundërvajtjeve) vihet re se përfshiheshin elementë të veçantë të mjedisit që gëzonin mbrojtje juridike penale ndonëse në kontekstin e mbrojtjes së objekteve të tjera¹³, siç mund të ishin: dëmtimi, shkatërrimi apo ndotja e mjediseve të përbashkëta të bashkësisë, shkatërrimi me zjarr apo me mjete të tjera i sendeve personale, apo përvetësimi i kundërligjshëm i prodhimeve bujqësore dhe frutore, sasia dhe vlera financiare e të cilave ishte relativisht jo e lartë apo e konsiderueshme për t'u cilësuar si vepër penale. Gjithashtu, në to përfshiheshin edhe rregullat e vendosura nga fshati që kishin të bënë

10 Dobjani, E., *Kundërvajtjet administrative në Shqipëri*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1991, f. 1.

11 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 26.

12 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 269.

13 Turkeshi, E., *Mbrojtja juridike penale e mjedisit*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2014, f. 55.

me qarkullimin në rrugë të njerëzve, kafshëve e bagëtive, me rradhën e vaditjes së arave, me gjuetinë e kafshëve të egra dhe peshkimit në vendet e ndaluara etj¹⁴.

Kanuni i Labërisë përcaktonte vetëm kuptimin e kundërvajtjes. Në të nuk kishte të dhëna lidhur me llojet, klasifikimin, ndarjen e kundërvajtjeve në administrative apo penale. Njëkohësisht nuk ekzistonte vendosja e tyre në një sistem më vete. Ato mund të konstatoheshin vetëm nëpërmjet një leximi të kujdeshëm të tyre. Kjo ndodh, sepse në kohën në të cilën atë kanë ekzistuar nuk ishte bërë ende kodifikimi i legjisllacionit¹⁵. Në këtë kuptim, normat e këtij kanuni nuk ishin norma të mirëpërcaktuara juridike dhe si të tilla nuk mund të kishin karakter të mirëfilltë juridik penal apo administrativ¹⁶. Duhet patur në konsideratë fakti se, disa norma të kanunit që bëjnë fjalë për sigurimin e rendit dhe qetësisë së duhur për veprimtarinë ekonomiko – shoqërore, një pjesë e rregullave me karakter publik, sikurse mund të ishin: marrëveshjet e përbashkëta për sigurimin e rrugëve, gjuetinë, ujitjen, etj. kishin të bënin me rregullimin e çështjeve me karakter administrativ¹⁷.

Gjithësesi, duhet të kihet parasysh zhvillimi i kundërvajtjes administrative është i pandarë nga ai i veprës penale, në kuptimin se kundërvajtja administrative rrjedh nga vepra penale¹⁸.

Rregullat që kishin të bënin me subjektin e kundërvajtjes

14 Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 157.

15 Jançe, K., *Aspekte të zhvillimit të qyteteve në mesjetë dhe statutet e Shkodrës si momunemnte të vërteta të Shqipërisë mesjetare*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2011, f. 162.

16 Dobjani, E., *Kundërvajtjet administrative në Shqipëri*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1991, f. 20.

17 Dobjani, E., *Kundërvajtjet administrative në Shqipëri*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1991, f. 20.

18 Dobjani, E., *Kundërvajtjet administrative në Shqipëri*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1991, f. 10.

administrative dhe të veprës penale nuk ishin të njëjlojta për sa i takon moshës për përgjegjësi penale. Jemi të mendimit se, mosha për lindjen e përgjegjësisë në rastin e kundërvajtjeve penale ishte 16 vjeç. Në kanun, kjo vjen e parashikuar drejtëpërdrejtë në nenin 876, ku ndër të tjera, thuhet se: “Për shkeljet e bëra nga gratë ose fëmijët deri 14-15 vjeç përgjigjet i zoti i shtëpisë ose kujdestari njëjloj si për veprat penale”¹⁹.

Në rastin e kundërvajtjeve, sanksioni kryesor që jepej në kanun ishte dënimi me gjobë.

Kanuni i Labërisë sanksiononte rregullin se vlera e masës së dhënë shkonte në favor të bashkësisë vendore dhe administrohej nga pleqësia²⁰.

1.1. Këshilli i pleqve

Këshilli i pleqve ishte organi përgjegjës për dhënien e dënimit me gjobë në rastin e kundërvajtjeve. Ky organ përcaktonte edhe kufijtë minimalë dhe maksimalë në kuadër të masës së gjobës për shkeljen e rregullave të vendosura. Në çdo rast, duhet patur në konsideratë fakti se kufiri maksimal i gjobës në rastin e kundërvajtjes administrative ishte, ashtu siç ndodh rëndom edhe sot në sistemin tonë, më e ulët se masa e gjobës që jepej në rastin e zbatimit të një dënimi penal²¹.

Këshilli i pleqve ishte një ndër organizmat e vetëqeverisjes vendore të parashikuara nga Kanuni i Labërisë. Ai e ushtronte veprimtarinë e tij bazuar në normat e së drejtës kanunore dhe në traditë²².

Kanuni i Labërisë përcaktonte dy lloje të Këshillit të pleqve si elemente të qeverisjes vendore. Kështu, Kanuni normonte Këshillin e pleqve të mëhallës si një organizim të përkohshëm. Ai shërbente për zgjidhjen e çështjeve konkrete dhe përbëhej nga një numër i caktuar personash që gëzonin cilësi të larta moralo-etike²³.

Në kanun parashikohej edhe Pleqësia apo siç konsiderohej ndryshe dhe si Këshilli i pleqve të fshatit, krahas Këshillit të pleqve të mëhallës.

19 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 270.

20 Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 158.

21 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 270.

22 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 53.

23 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 54.

Pleqësia përbëhej nga pleq zakoni - meshkujt e bashkësisë që gëzonin një emër dhe reputacion të mirë në komunitet. Pleqësia gëzonte një sërë të drejtash siç mund të ishin: e drejta e marrjes së masave të caktuara për sigurinë dhe qetësinë e bashkësisë, për mbrojtjen e të drejtës së pronës së përbashkët, për dhënien e drejtësisë komunitare, mirëadministrimin e të ardhurave financiare etj²⁴. Si një një organizëm drejtues e zbatues për bashkësinë, Pleqësia ishte një organ i përhershëm. Ajo i merrte vendimet me kolegjalitet. Vendimet ishin të detyruara për zbatim. Efekti detyrues i tyre i shtrinte kufijtë e veprimit ndaj çilitdo anëtar i bashkësisë vendore.

Pleqësia siguronte ekzekutimin e vendimit të saj forcërisht, në rast të mozbatimit vullnetar të vendimeve të tyre, ndaj kundërvajtësve. Kështu, Këshillit të pleqve i lindte e drejta, bazuar në kanun, që të caktonte 2-3 djem për të siguruar ekzekutimin e vendimit të dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar në arën e tjetrit²⁵ apo për t'i marrë autorit të kundërvajtjes vleftën në natyrë për gjobën e marrë²⁶. Gjoha në natyrë e dhënë ndaj kundërvajtësit përbëhej nga një numër i caktuar bagëtish të imta si p.sh. 1-3 dele, dhi.

Kanuni kishte krijuar dhe institucionin përgjegjës për të evidentuar shkelësin (kundërvajtësin) e të drejtave në aspektin civil, administrativ dhe penal. Ai njihet me emrin *bekshiu/pojaku* apo siç quhej ndryshe roja. Kuptohej se ky lloj shërbimi nuk bëhej falas, për këtë detyrë kaq të ndërlikuar jepeshin shpërblime²⁷ vjetore në natyrë²⁸ apo në të holla nga Këshilli i pleqve²⁹.

Bekshiu/Pojaku kishte dy detyra kryesore. Ato ishin:

24 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 56.

25 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 57.

26 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 57.

27 Cana, J., *“Insitucioni i Kuvendit sipas të drejtës zakonore labe”*, tezë doktrature, Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2012, f. 84.

28 Kryeshisht shpërblimi në natyrë përbëhej nga prodhime bujqësore, blegtorale, siç mund të ishin: shpërblimi në grurë, miell, qumësht e nënproduktet e tij etj.

29 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 57.

Së pari, *Bekshiu* gëzonte të drejtën e hetimit të kundërvajtjes me qëllim zbulimin e fajtorit, kur ky i fundit nuk ishte i zbuluar. Ai kishte të drejtën të kërkonte prej kundërvajtësit shpërblimin për dëmin e shkaktuar si dhe vlerën e gjobës së dhënë ndaj tij³⁰.

Së dyti, *Bekshiu* gëzonte të drejtën për të informuar institucionin e Pleqësisë për një sërë shkeljes të caktuara në fushën e rregullit dhe rendit në bashkësi, të drejtës së pronës private dhe publike siç mund të ishte: cenimi i pasurisë së përbashkët dhe personale të pjesëtarëve të komunitetit që mund të dëmtohej nga dora e njeriut apo kafshët e egra dhe të buta etj³¹.

2.2 Kuvendi i burrave

Kuptohet që në sistemet vetqeverisëse, rolin kryesor në marrjen e vendime të rëndësishme në të gjitha aspektet e kanë luajtur kuvendet e burrave. Kuvendet, ishin një lloj parlamenti ku diskutoheshin dhe i jepej zgjidhje të gjitha shqetësimeve e problemeve shoqërore, ekonomike, marrëdhënieve midis njëerëzve dhe fiseve³².

Kanuni i Labërisë njihte disa lloje të kuvendeve të burrave. Këto kuvende nuk ishin organizma të qëndrueshëm dhe të përhershëm. Gjithashtu, kuvendet klasifikoheshin në bazë të shtrirjes dhe ndarjes territoriale të njërive vendore. Ata ndaheshin në Kuvende të fshatit, të krahinës si dhe kuvende ndërkrainore³³.

Kuvendi i burrave përfaqësonte organin më të lartë të qeverisjes vendore. Në “duart” e tij ishin përqëndruar një sërë funksionesh. Kështu, ai ushtronte funksione ekzekutive, ligjvënëse dhe gjyqësore.

Kuvendi i burrave kishte për detyrë dhënien e drejtësisë në komunitet. Kuvendi mund të caktonte ndaj autorit për krimet e kryera deri në dënimin

30 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 57.

31 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 56.

32 Cana, J., “*Institucioni i Kuvendit sipas të drejtës zakonore labe*”, tezë doktorature, Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2012, f. 99.

33 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 59.

me vdekje³⁴.

Vendimet e tij ishin të formës së prerë. Vendimet e dhëna nga Kuvendi ishin të detyrueshme për zbatim. Ato i shtrinin efektet e tyre në të gjithë bashkësinë vendore dhe ndaj anëtarëve të saj sipas rastit.

3. Hetimi dhe gjykimi i kundërvatjeve

Me të drejtë zakonore procedurale kuptohej tërësia e normave të pashkruara të vendosura nga pleqtë për hetimin dhe gjykimin e çështjeve administrative, penale apo civile³⁵.

Këshilli i pleqve ishte organi përgjegjës për hetimin dhe gjykimin e kundërvatjeve penale. Zbulimi i së vërtetës objektive dhe dhënia e një vendimi të drejtë kërkonte konstatimin me siguri të të gjitha fakteve që kishin lidhje me çështjen³⁶. Për këtë qëllim, në Labëri, procesi hetimor zhvillohej duke zbatuar pyetjen, si një veprim hetimor dhe gjyqësor me anën e të cilit merreshin drejtëpërsëdrejti thënie që kishin rëndësi për zgjidhjen e drejtë të konfliktit³⁷.

Subjekt i hetimeve ishin vetëm personat të cilët mendoheshin se mund të kishin dijeni për çështjen.

Njëkohësisht, norma kanunore labe njihte dhe institutin e parashkrimit në rastin e kundërvatjeve penale. Në një rast të tillë, Kanuni i Labërisë sanksiononte të drejtën e shuarjes së afateve për hetimin dhe ndjekjen e kundërvatjeve. Si rregull, afati kohor për parashkrimin e kundërvatjeve ishte 2-3 muaj nga moment i kryerjes së saj³⁸.

Mund të themi se, Kanuni i Labërisë kishte si veçanti të tij faktin se, procedura e gjyqimit të shkeljeve të rregullave të vendosura zhvillohej pa praninë e palëve, qoftë i dëmtuar apo dëmtues.

Pas respektimit të procedurës së hetimit dhe gjyqimit, Pleqësia jepte vendimin përfundimtar në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Si rregull, ky

34 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 58.

35 Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 193.

36 Latifi, V., *Kriminalistika*, shtypshkronja “Koha”, Prishtinë, 2011, f. 163.

37 Begeja, S., *Kriminalistika*, Ribotim, shtypshkronja “Perlat Voshtina”, Tiranë, 2007, f. 404.

38 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 271.

vendim ishte i bazuar në normat kanunore dhe në traditë, dhe si i tillë konsiderohej një vendim i dhënë me drejtësi dhe që ishte i detyrueshëm për zbatim nga palët në proces. Interesant është fakti se, në çdo rast, vendimi i dhënë ishte verbal dhe nuk karakterizohej nga forma shkresore.

Gjykimet, si rregull, bëheshin pa kundërshtim³⁹. Megjithatë në çdo rast, pala që shpallej fituese paguante diçka në favor pleqësisë⁴⁰.

4. Ekzekutimi i vendimit të kundërvajtjeve

Ashtu sikurse është bërë e njohur nga jurisprudenca dhe doktrina juridike, ekzekutimi i vendimit është një element thelbësor i shtetit të së drejtës dhe i vetë nocionit të gjykimit të drejtë⁴¹. Ekzekutimi është faza e fundit në një procesi gjyqësor. Ekzekutimi i vendimit konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejtë të mohuar dhe të fituar gjyqësisht. Ekzekutimi është momenti përcaktues që bën efektive vendimmartjen gjyqësore⁴².

Natyrshëm, në këtë punim, do të lindë pyetja sesi rregullohej dhe kryhej ekzekutimi i vendimit me natyrë administrative apo penale në rastin e kundërvajtjeve në Kanunin e Labërisë?

Ekzekutimi i vendimit për kundërvajtjet realizohej në dy mënyra kryesore, në mënyrë vullnetare apo nëpërmjet forcës shtrënguese.

Së pari, vullnetarisht, nënkuptonte ekzekutimin e detyrimit me vullnet të lirë nga pala e ngarkuar me një detyrim të tillë. Në cilësinë e të detyruarit, personit përgjegjës për ekzekutimin e një detyrimi në mënyrë vullnetare jo në çdo rast nënkuptohej personi që kishte kryer kundërvajtjen. Thënë kjo, pasi kundërvajtja mund të kryhej nga personi që kishte arritur një moshë të caktuar që parashikonte ligji për lindjen e përgjegjësisë apo ishte i aftë mendërisht të kuptonte rëndësinë dhe karakterin e veprimeve

39 Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 199.

40 Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 199.

41 Sadushi, S., *Gjykata administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 329.

42 Sadushi, S., *Gjykata administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 330.

të kryera prej tij⁴³. Në rastin kur personi ishte madhor dhe i përgjegjshëm ai ishte i detyruar të zbatonte në mënyrë vullnetare vendimin e dhënë nga Pleqësia për kundërvajtjen. Në rast të kundërt, ekzekutimi i vendimit bëhej i mundur në mënyrë vullnetare nga kryefamiljari i tij⁴⁴.

Kanuni për të bërë të mundur ekzekutimin e detyrimit në mënyrë vullnetare kishte parashikuar edhe një institucion, që njihej ndryshe si garanti i detyrimit apo *qefili*. Në rast të moszbatimit në mënyrë vullnetare norma kanunore parashikonte edhe lindjen e përgjegjësisë për garantin. Gjithësesi, nga leximi dhe analiza e normave kanunore arrijmë në përfundimin se, Kanuni i Labërisë nuk jepte në mënyrë të detajuar se çfarë do të kuptonim me garantues si dhe cila ishte masa e dënimit që do zbatohet ndaj tij në rast të mosrespektimit të ekzekutimit të detyrimit në mënyrë vullnetare nga pala.

Së dyti, ekzekutimi i vendimit zbatohet edhe nga kanosjerët (gjobëtarët), kur kishte kundërshti për të kryer vendimin nga palët me vullnet të lirë⁴⁵.

Kanosjerët apo çmuesit/gjobëtarët sikurse cilësoheshin ndryshe, ishin persona të caktuar nga Këshilli i pleqve. Ata kishin për detyrë të vlerësonin dhe të caktonin çmimin e dëmit në ara nga gjëja e gjallë⁴⁶.

Madje, kur vendimi nuk ekzekutohej me vullnetin e lirë të palëve, Këshilli i pleqve kishte të drejtën të ndëshkonte me shpërblimin e dëmit apo me gjobë edhe personin përgjegjës që siguronte zbatimin e vendimit në mënyrë vullnetare⁴⁷.

5. Kundërvajtja sipas legjislacionit bashkëkohor

Teoria e së drejtës penale jep kuptimin e figurës së përgjithshme të veprës penale, elementet që janë të domosdoshëm për ekzistencën e saj. Sipas shkencës së drejtës penale shqiptare, me vepër penale duhet kuptuar çdo veprim apo mosveprim shoqërisht i rrezikshëm, i kryer me

43 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 270.

44 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 270.

45 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 271.

46 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 57.

47 Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 271.

faj dhe i parashikuar shprehimisht si i tillë në ligj⁴⁸. Kodi penal në fuqi i ndan veprat penale në dy grupime kryesore në krime dhe kundërvajtje penale. Ndonëse nuk përcakohet shprehimisht në kod, kriteri bazë i kësaj ndarjeje të veprave penale është kriteri material, rrezikshmëria e tyre⁴⁹. Rrezikshmëria shoqërore është tipari social dhe elementi thelbësor material i veprës penale⁵⁰. Ajo ka karakter dinamik⁵¹. Kundërvajtjen penale e dallojnë nga krimi dy tipare të karakterit juridiko-formal që është shprehja “përbën kundërvajtje penale” e përdorur në dispozitën e pjesës së posaçme si dhe masa e dënimit me burgim, kufiri maksimal i së cilës është dy vjet. Ligji parashikon për kundërvajtjet vetëm dënimin me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet⁵². Ligji penal nuk parashikon në të vërtetë kritere shkencore në dallimin e kundërvajtjeve penale, në grupimin dhe rradhitjen e tyre, duke krijuar përsëritje të panevojshme për çdo vepër të shprehjes “përbën kundërvajtje penale” dhe vështirësi për gjetjen e dispozitave përkatëse nga zbatuesit e tyre⁵³. Kodi Penal bashkëkohor, ashtu sikurse, nuk jep kuptimin e veprës penale⁵⁴, po ashtu, nuk na tregon lidhur me një përcaktim të fundit se çfarë do të kuptojmë me kundërvajtje penale.

Në pjesën e posaçme të Kodit Penal kundërvajtjet penale dhe krimet

48 Muçi, Sh., *E drejta penale - pjesa e përgjithshme*, Botimet Dudaj universitare, Tiranë, 2007, f. 96.

49 Muçi, Sh., *E drejta penale - pjesa e përgjithshme*, Botimet Dudaj universitare, Tiranë, 2007, f. 101-102.

50 Elezi, I., & Kaçupi, S., & Haxhia, M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, (pjesa e përgjithshme)*, shtëpia botuese “Geer”, Tiranë, 2004, f.46.

51 Elezi, I., & Kaçupi, S., & Haxhia, M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, (pjesa e përgjithshme)*, shtëpia botuese “Geer”, Tiranë, 2004, f.46.

52 Muçi, Sh., *E drejta penale - pjesa e përgjithshme*, Botimet Dudaj universitare, Tiranë, 2007, f. 101-102.

53 Muçi, Sh., *E drejta penale - pjesa e përgjithshme*, Botimet Dudaj universitare, Tiranë, 2007, f. 101-102.

54 Muçi, Sh., *E drejta penale - pjesa e përgjithshme*, Botimet Dudaj universitare, Tiranë, 2007, f. 100.

janë të grupuara sipas marrëdhënieve juridike që cenohen nga kryerja e tyre. Ato i gjejmë ose si dispozitë e veçantë ose si paragraf të një dispozite. Ky është edhe një dallim me normat penale të vitit 1928 dhe 1977⁵⁵.

Në kuadrin e mbrojtjes së rendit shoqëror, të mbrojtjes së të drejtave natyrore të njeriut, të parandalimit dhe dënimit të autorëve të shkeljes së ligjeve, legjislacioni shqiptar, si pjesë përbërëse të tij, krahas kundërvajtjeve penale ka të sanksionuara dhe kundërvajtjet administrative⁵⁶. Kundërvajtjet administrative janë vepra me rrezikshmëri shoqërore dhe duke qenë të tilla, organet e administratës shtetërore kanë për detyrë të luftojnë për parandalimin zbulimin dhe dënimin e tyre.

Zanafillën e konceptit juridik të kundërvajtjeve administrative e gjejmë në legjislacionin tonë të pasqyruar në të cilin thuhet se : “Kundërvajtjet janë shkelje të rendit juridik të vendosur me dispozita juridike të organeve shtetërore, për të cilat nga shkaku që kanë një rrezikshmëri të vogël caktohen dënime administrative”⁵⁷⁵⁸. Për të kaluar më pas në qëndrimet e doktrinës sonë juridike që e përcaktonin kundërvajtjen si shkeljen e dispozitave të nxjerra nga organet shtetërore kompetente, për të cilat, për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të vogël, janë parashikuar dënime administrative⁵⁹, dhe për të ardhur në përfundimin më të plotë, në gjykimin tone, të ardhur deri më sot, nga profesor Ermir Dobjani, sipas së cilit: “kundërvajtjet konsiderohen si shkelje të dispozitave të nxjerra

55 Arbi, M., *Vështrim krahasues i kundërvajtjes penale*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Master shkencor në shkencat penale-Rasti i Shqipërisë”, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2011, f. 56.

56 Arbi, M., *Vështrim krahasues i kundërvajtjes penale*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Master shkencor në shkencat penale-Rasti i Shqipërisë”, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2011, f. 139.

57 Meksi, V., *Interpretimi i dekretit mbi kontravajtjet*, revista Drejtësia Popullore, Nr. 3, viti 1954, f.37.

58 Dobjani, E., *E drejta administrative I*, botim i ripunuar, shtypshkronja “Perlat Voshtina”, Tiranë, 2007, f. 335.

59 Papapavli, T., *Kundërvajtjet administrative dhe procedura e gjykimit të tyre*, revista Drejtësia Popullore, Nr. 5, viti 1963, f. 15.

nga organet shtetërore kompetente, e kryer me faj dhe nga persona të përgjegjshëm, për të cilën, për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të vogël, është caktuar dënim administrative⁶⁰.

Dallimi midis shkeljes administrative dhe veprës penale qëndron në faktin se, vepra penale formon krim duke qenë shoqërisht e rrezikshme, ndërsa, shkelja administrative ka vetëm karakter të kundërligjshëm. Kjo nuk nënkupton se shkelja administrative nuk ka paraqet rrezikshmëri shoqërore, por, kjo e fundit, nuk është e tillë si në rastin e krimeve. Prandaj, tipar përcaktues tek shkelja administrative nuk është rrezikshmëria shoqërore por kundërligjshmëria e saj⁶¹.

6. Përfundimet

Analiza historike e së drejtës zakonore shqiptare në tërësi dhe asaj të Labërisë në veçanti dëshmon për ekzistencën e një drejte autentike shqiptare të pavarur nga ajo e vendeve të tjera dhe si dhe për aftësitë dhe kapacitetet vetqeverisëse të vendit tonë⁶². Gjithashtu, ajo është një dëshmi e gjallë e vetdijes juridike të popullit tonë e trashëguar ndër shekuj.

Pavarësisht nga ndryshimet që mund të kenë formulimet, konstatojmë se, qëndrimi i sistemeve politike dhe i filozofisë së të drejtës ku janë mbështetur hartuesit e Kanunit të Labërisë dhe ligjvënësit sot është i njëjtë, për sa i takon kriterit dallues të krimit me kundërvajtjen penale. Kështu, shoqëria dhe sistemet politike të ndryshme i konsiderojnë kundërvajtjet vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët⁶³.

Kundërvajtjet janë shkeljet e rendit publik dhe të qetësisë publike, të përcaktuara me ligj ose me dispozitë tjetër, për të cilat parashikohen dënimet dhe masat mbrojtëse. Elementet e përgjithshëm të çdo

60 Dobjani, E., *E drejta administrative 3*, SHBLU, Tiranë, 1998, f. 112.

61 Baboçi, S., *Kundërvajtjet administrative dhe procedura e gjykimit të tyre*, revista Drejtësia Popullore, Nr. 2, viti 1983, f. 48.

62 Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 29.

63 Arbi, M., *Vështrim krahasues i kundërvajtjes penale*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Master shkencor në shkencat penale-Rasti i Shqipërisë”, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2011, f. 150.

kundërvajtjeje janë shkelja e normës juridike si dhe parashikimi i dënimit kundërvajtës dhe masës mbrojtëse në ligj ose në dispozitë tjetër⁶⁴.

Kanuni i Labërisë mjaftohej vetëm me përcaktimin e kuptimit të kundërvajtjes. Ai nuk sanksiononte të dhënat lidhur me llojet, klasifikimin e kundërvajtjeve në administrative a penale. Njëkohësisht nuk ekzistonte vendosja e tyre në një sistem më vete.

Kanuni i Labërisë parashikonte si dënime administrative për kundërvajtjet dënimin me gjobë⁶⁵.

Pleqësia ishte instituti i parashikuar nga kanuni për hetimin dhe gjykimin e kundërvajtjeve. Vendimi i dhënë ishte verbal dhe i formës së prerë.

Si rregull, gjykimet zhvilloheshin pa kundërshtim⁶⁶.

Bibliografia

Libra

- Begeja, S., *Kriminalistika*, Ribotim, shtypëshkronja “Perlat Voshtina”, Tiranë, 2007.
- Dobjani, E., *E drejta administrative 1*, botim i ripunuar, shtypëshkronja “Perlat Voshtina”, Tiranë, 2007.
- Dobjani, E., *E drejta administrative 3*, SHBLU, Tiranë, 1998, f. 112.
- Elezi, I., *E drejta zakonore penale e shqiptarëve*, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1983.
- Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002.
- Elezi, I., & Kaçupi, S., & Haxhia, M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, (pjesa e përgjithshme)*, shtëpia botuese “Geer”, Tiranë, 2004.
- Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006.

64 Stavileci, E., *E drejta administrative*, Fakulteti Juridik në Prishtinë, Prishtinë, 1981, f. 283.

65 Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 157.

66 Elezi, I., *E drejta zakonore e labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 199.

- Elezi, I., & Elezi, E., *Historia e së drejtës penale*, shtëpia botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2010.
- Grup autorësh, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri II*, shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë, 1997.
- Latifi, V., *Kriminalistika*, shtypëshkronja “Koha”, Prishtinë, 2011.
- Muçi, Sh., *E drejta penale - pjesa e përgjithshme*, Botimet Dudaj universitare, Tiranë, 2007.
- Sadushi, S., *Gjykata administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën*, Botimet Toena, Tiranë, 2014.
- Stavileci, E., *E drejta administrative*, Fakulteti Juridik në Prishtinë, Prishtinë, 1981.

Disertacione për mbrojtjen e gradës shkencore Master & Doktor

- Arbi, M., *Vështrim krahasues i kundërvajtjes penale*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Master shkencor në shkencat penale-Rasti i Shqipërisë”, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2011.
- Cana, J., *Insitucioni i Kuvendit sipas të drejtës zakonore labe*, tezë doktore, Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2012.
- Dobjani, E., *Kundërvajtjet administrative në Shqipëri*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1991.
- Jançe, K., *Aspekte të zhvillimit të qyteteve në mesjetë dhe statutet e Shkodrës si momunemnte të vërteta të Shqipërisë mesjetare*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2011.
- Mandro, A., *Organizimi shtetëror dhe e drejta në pashallëqet kryesore shqiptare*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1992.

- Turkeshi, E., *Mbrojtja juridike penale e mjedisit*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2014.

Revista

- Baboçi, S., Kundërvajtjet administrative dhe procedura e gjykimit të tyre, revista *Drejtësia Popullore*, Nr. 2, viti 1983.
- Meksi, V., Intepetimi i dekretit mbi kontravajtjet, revista *Drejtësia Popullore*, Nr. 3, viti 1954.
- Papapavli, T., Kundërvajtjet administrative dhe procedura e gjykimit të tyre, revista *Drejtësia Popullore*, Nr. 5, viti 1963.

DISA ASPEKTE TË INTERPRETIMIT KUSHTETUES

Dr. Ervin SULKO

Hyrje

Interpretimi kushtetues ka qenë dhe mbetet një nga temat më aktuale të së drejtës kushtetuese, për shkak se ai ka njohur me kalimin e viteve një evoluim të vazhdueshëm. Ky punim mori shkas pikërisht nga dinamizmi i interpretimit të Kushtetutës, si dhe nga tiparet dhe teknikat e reja të interpretimit që janë shfaqur kohët e fundit, të cilat përbëjnë edhe objektin e këtij studimi. Qëllimi i këtij punimi është t'i ofrojë studiuesve një kuadër të përgjithshëm mbi interpretimin kushtetues, të përshkrojë teoritë e interpretimit kushtetues që nga lindja e tyre e deri në ditët e sotme, duke u mbështetur tek teoritë më të rëndësishme që karakterizojnë doktrinën (shkollat) e interpretimit juridik në tërësi. Këtu mund të përmendim shkollën franceze, gjermane, amerikane etj.

Gjithashtu, një vend të rëndësishëm zë edhe trajtimi i ndërkombëtarizimit të interpretimit kushtetues, si një prirje e përgjithshme, e cila karakterizon pothuajse të gjitha gjykatat kushtetuese, kjo në sajë të procesit të globalizimit, integritimit evropian, të drejtës ndërkombëtare apo dhe asaj konventore në veçanti. Përmes këtij punimi synohet të analizohet qasja e Gjykatës Kushtetuese shqiptare mbi interpretimin kushtetues, teknikat e interpretimit kushtetues të përdorura. Qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në pozicionin e ligjvënësit negativ, e vendos atë në një pozicion disi të tërhequr kundrejt funksionit krijues që mund të vijë si rrjedhojë e veprimtarisë interpretuese. Në mbyllje, trajtohet interpretimi kushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese shqiptare, teknikat që janë përdorur prej saj, duke analizuar jurisprudencën kushtetuese në lidhje me interpretimin kushtetues.

1. Specificiteti i interpretimit kushtetues

Në të drejtën tonë pozitive nuk parashikohen në mënyrë të shprehur teknikat e interpretimit ligjor. Në fakt në dallim nga eksperiencat e tjera¹, mungojnë parashikimet normative që të sanksionojnë mjetet e interpretimit ligjor, të cilat të zbatohen nga gjyqtarët e çdo niveli. Është e vërtetë se gjyqtarët kanë për detyrë zbatimin e ligjit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konkrete, por që ligji si një akt i përgjithshëm dhe abstrakt, të zbatohet në rastin konkret, duhet edhe të interpretohet nga gjyqtari, i cili i jep kuptim dispozitës ligjore për rastin konkret. Ndaj dhe veprimtaria e interpretimit është e pandashme nga veprimtaria e zbatimit të ligjit. Teknikat e interpretimit ligjor janë ofruar nga doktrina dhe ndihmojnë punën e përditshme të gjyqtarëve në zbatimin/interpretimin e ligjit, këtu mund të përmendim, interpretimin gramatikor, literal, autentik, teleologjik, historik, evolutiv, sistematik, apo edhe përdorimi i analogjisë aty ku është e mundur si, analogjia *legis*, analogjia *juris* etj.

Çështja ndryshon nëse flasim për veprimtarinë e interpretimit kushtetues, pasi duhet të kemi parasysh se kjo veprimtaria paraqet disa veçori kundrejt interpretimit ligjor në tërësi. Natyrisht që kriteret e interpretimit ligjor të mësipërme mund të përdoren edhe për interpretimin kushtetues, por gjithmonë duke mbajtur parasysh specifikën e këtij të fundit.

Dispozitat kushtetuese nuk duhen kuptuar si “rregulla”, por ato kanë një përmbajtje më të gjerë dhe sigurisht që kjo ndikon në qasjen e interpretimit të tyre, në dallim nga interpretimi i rregullave të hollësishme. Megjithatë, duhet të pranojmë se kjo nuk është një karakteristikë e të gjitha dispozitave kushtetuese, por përgjithësisht është për ato parimore, pasi nuk mungojnë dispozita kushtetuese të cilat janë konkrete dhe menjëherë të zbatueshme. Këtë gjë e gjejmë të shprehur edhe në Kushtetutën tonë ku; *Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur*

1 P.sh Kodi Civil italian (1942), i cili parashikon në pjesën hyrëse të tij, neni 12 edhe disa kriteret e interpretimit ligjor, të cilat duhet të kihet parasysh nga gjyqtarët për zbatimin e ligjit. Nga ana tjetër, edhe Kodi ynë civil i vitit 1929 parashikonte dispozita të ngjashme në lidhje me interpretimin e ligjit.

*Kushtetuta parashikon ndryshe*². Zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave kushtetuese sidomos i atyre që sanksionojnë të drejtat dhe liritë themelore të personit, bëjnë të mundur një mbrojtje efektive të tyre. Kjo teori është përpunuar nga doktrina kushtetuese gjermane, e cila me nocionin *Drittwirkung*, nënkupton zbatimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës kundrejt individëve.

Siç janë shprehur edhe në doktrinën kushtetuese shqiptare, (K. Traja), “nuk ka kushtetutë me gjuhë krejt të qartë, ato shkruhen vetvetiu të tilla, me gjuhë të përgjithshme dhe abstrakte, me shprehje shumëvlerore, që mund t’i përgjigjen rrethanave gjithnjë konkrete të jetës”³.

Është kjo arsyeja që interpretimi literal, humbet përparësinë e tij, për të privilegjuar interpretimin sistematik, ky i fundit duhet kuptuar si një interpretim sistematik, jo vetëm brenda tekstit të Kushtetutës, por edhe në kombinim edhe me burime të tjera të rendit juridik, të cilat i japin kuptim dispozitës kushtetuese, kjo lloj teknike njihet në doktrinën kushtetuese ndërkombëtare si *duplex interpretatio*⁴. Përderisa dispozitat kushtetuese janë parimore dhe të përgjithshme, të cilat ngarkojnë subjekte të tjera p.sh ligjvënësin për zbatimin e parimit kushtetues, atëherë edhe në interpretimin e atyre dispozitave duhet të mbahet parasysh edhe rregullimi ligjor. Nga kjo rrjedh se interpretimi kushtetues është i dyfishtë dhe realizohet duke iu referuar jo vetëm dispozitës kushtetuese, por edhe ligjit që ka dalë në zbatim të saj.

Kushtetuta paraqitet specifike edhe sa i takon teknikave tipike të interpretimit kushtetues si ajo e balancimit ose proporcionalitetit tipike e gjykatave kushtetuese. Tek ne kjo teknikë zbatohet në bazë të nenit 17/1 të Kushtetues, me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut, *ky kufizim duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë*. Përmes kësaj dispozite Gjykata Kushtetuese ushtron testin e proporcionalitetit mbi ligjet e vendit, të cilat kufizojnë të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në Kushtetutë.

2 Neni 4/3, i Kushtetutës.

3 K.Traja, *Procesi i rregullt ligjor, aspekti substantiv*, botuar në “*Studime Juridike*”, nr. 1/2005, f. 69.

4 F.Modugno, *Sulla specificità dell’interpretazione costituzionale*, Editoriale Scientifica, Napoli, 2008, f.200.

Një veçori tjetër e interpretimit kushtetues është sa i takon subjekteve që duhet të bëjnë interpretimin kushtetues. Parimisht interpretimi dhe zbatimi i Kushtetutës duhet të bëhet nga të gjitha organet kushtetuese, secila në fushën e kompetencave që vetë Kushtetuta ia njih. Kështu çdo gjyqtar në veprimtarinë e zbatimit/interpretimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete duhet të zbatojë drejtpërdrejt Kushtetutën, aty ku kjo është e mundur. Natyra e Kushtetutës është e tillë që arrin tek çdo subjekt i rendit juridik, tek çdo organ kushtetues, tek çdo individ, të gjithë së bashku duhet të interpretojnë dhe zbatojnë atë.

Ajo që e bën specifik interpretimin kushtetues, ka të bëjë me subjektin e veçantë që rendi ynë kushtetues parashikon për ruajtjen e zbatimit të Kushtetutës nga të gjithë subjektet e rendit kushtetues, pikërisht Gjykatën Kushtetuese, si organ i posaçëm, e cila ka autoritetin e interpretimit përfundimtar të Kushtetutës. Duke qenë se, vendimet e saj janë të përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim⁵, interpretimi i bërë prej saj është përfundimtar dhe “fjala e fundit” sa i takon interpretimit të Kushtetutës i takon pikërisht asaj. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare, të formës së prerë dhe të detyrueshme për zbatim nga të gjitha organet apo institucionet e rendit juridik⁶. *Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që ju imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj[.....]*⁷. Duke u nisur edhe nga kjo jurisprudencë, vendimet e interpretimit të Gjykatës Kushtetuese kanë efekte juridike të përgjithshme *erga omnes* të afta të prodhojnë efekte juridike të detyrueshme përtej rastit konkret ku janë dhënë dhe që duhet të mbahen parasysht nga të gjitha institucionet në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, ato formojnë *res judicata* kushtetuese. Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata Kushtetuese⁸.

5 Neni 132/2, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare.

6 Vendimi nr. 15/2003 i Gjykatës Kushtetuese

7 Vendimi nr. 5/2001 i Gjykatës Kushtetuese.

8 B. Dedja, Gjykata Kushtetuese sipas sistemit juridik shqiptar, mbajtur në Konferencën e organizuar më dt. 21-23 shtator 2011, në Karakas-Venezuelë, botuar në www.gjk.gov.al, f.5.

1.1 Teoritë e interpretimit kushtetues dhe evoluimi i tyre

Është interesante të bëjmë një analizë diakronike në lidhje me evoluimin e teorive të interpretimit juridik në tërësi, e cila sigurisht që lidhet edhe me teoritë e interpretimit kushtetues në veçanti.

Teknika e parë e interpretimit vjen nga shkolla franceze njohur ndryshe edhe si *teoria konjitive ose njohëse*. Kjo metodologji e interpretimit juridik u zhvillua gjatë iluminizmit francez gjatë shek.XVIII-XIX, nga shkolla *l'Ecole de l'exégèse*, e cila në bazë të silogjizmave arrinte të interpretonte tekstin e shkruar. Ky interpretim, ishte në thelb një interpretim autentik i ligjit, sepse gjyqtari bënte një interpretim deklarativ të asaj çka shkruhej në tekstin e normës juridike. Në këtë pikë, interpretuesit e ligjit, në veçanti gjyqtarët nuk kishin shumë liri veprimi dhe ishin në mënyrë strikte të varuar nga ligji dhe nga ajo çfarë sanksionohej në tekstin e tij. Kjo erdhi si rrjedhojë e kontekstit historik të Francës, e cila në periudhën post-revolucionare karakterizohej nga një klimë mosbesimi tek gjyqtarët dhe nga forca absolute e ligjvënësit. Gjyqtarët duhet të ishin, *bouche de la loi* (goja e ligjit), pra duhet të zbatonin dhe aplikonin në mënyrë mekanike dhe strikte atë çfarë ligji parashikonte, ligji kishte vetëm një kuptim të vërtetë.

Kjo metodologji interpretimi presupozonte edhe qartësinë e tekstit ligjor, por edhe në rast se teksti kishte pika të errëta ose dyshime mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit, gjyqtarët duhej t'i drejtoheshin Parlamentit për të sqaruar kuptimin e tij, kjo njihej edhe me termin *référé législatif*⁹. Ligjvënësi kishte pushtetin absolut sa i takon veprimtarisë së prodhimit normativ dhe të zbatimit të ligjit, duke shmangur çdo lloj veprimtarie krijuese të gjyqtarëve¹⁰, ai bënte çdo interpretim autentik të ligjit.

9 Mekanizmi *référé législatif* u parashikua për herë të parë në nenin 21 të Kushtetutës franceze të vitit 1791, për më tepër shih L.G.Sciannella, *L'argomento dell'original intent nella giurisprudenza costituzionale in tema di forma di governo botuar në, Lavori preparatori ed original intent nella giurisprudenza della Corte costituzionale*, Atti del seminario svoltosi a Catania il 5 ottobre 2007, (a cura di) F.Giuffrè, I.Nicotra, Giappichelli, Torino, 2007, f. 47.

10 Po aty, f. 59.

E përafërt, por me ndryshime paraqitet shkolla gjermane e *pandetistikës*, e cila në dallim nga shkolla franceze e vendosi veprimtarinë interpretative të gjyqtarëve jo nën suazën e ligjvënësit, por ia la në dorë shkencës juridike. Në thelb të metodologjisë së interpretimit të kësaj shkolle ishin dogmat juridike, të cilat vendoseshin nën këndvështrimin historik dhe sistematik në një rend të caktuar juridik, në një sistem, nga i cili mund të përftoheshin në mënyrë deduktive normat juridike të rastit konkret.

Teoria e vlerësimit, sipas të cilës veprimtaria interpretuese fillon nga sistemi juridik për të kaluar më pas tek problemi për të zgjidhur. Veprimtaria interpretuese nuk duhet të bazohet vetëm në tekstin e ligjit, apo mbi bazën e veprimeve matematike deduktive mbi atë çfarë përftohet nga teksti i ligjit, por vlerësohet edhe subjektiviteti i interpretuesit. Një nga teoricienët më të njohur të kësaj doktrine është H. Kelzeni “Teoria e kulluar e së drejtës”, ku i njeh fuqi krijuese edhe gjyqtarit në dhënien e kuptimit të normave juridike, të cilat nuk kanë domosdoshmërisht vetëm një kuptim, por edhe më shumë kuptime, është vetë gjyqtari që zgjedh të zbatojë kuptimin e duhur në rastin konkret. Sipas një tjetër teoricieni interpretimi duhet të synojë jo vetëm aspektin konjitiv të normës pra anën deskriptive të saj, por pranohet edhe roli plotësues i interpretuesit, kjo në kuptimin e riformulimit të tekstit apo i funksionit krijues të tij¹¹.

Sipas teorisë së re të interpretimit, veprimtaria interpretative duhet të kryhet sipas një mënyre që mos të bazohet ekskluzivisht në tekstin e dispozitës, por duhet t’i referohet edhe kazusit, rastit konkret, ku ajo duhet të zbatohet. Madje, pika e nisjes nuk është më referenca normative, teksti i shkruar, siç ka qenë tradicionalisht për të gjitha teoritë e interpretimit, por është çështja konkrete prej të cilës duhet të nisemi për t’i dhënë kuptimin dispozitës¹². Kjo do të thotë se interpretimi i dispozitës, do t’i jepet ai kuptim, i cili bën të mundur zgjidhjen e problemit që shtrohet përpara gjyqtarit. Kjo teori shënon dhe kalimin e interpretimit nga “problemi” tek “sistemi”.

Dy janë faktorët që kanë ndikuar në themelimin e teorisë së re

11 L.Wittgenstein, *Philosophische Untersuchungen*, 1953.

12 G.Zagrebelsky, *La giustizia costituzionale*, Il Mulino, Bologna, 1988, f. 39.

hermeneutike, së pari koncepti mbi vlerën ose vlerat, nuk është më “absolut”, pasi ai pasqyrohet në tekstet kushtetuese në cilësinë e parimeve kushtetuese, ku këto të fundit mund të drejtpeshohen ose kufizohen kundrejt parimeve të tjera kushtetuese po aq të rëndësishme për rendin kushtetues ose më të rëndësishme. Në shoqëritë e sotme pluraliste asnjë vlerë nuk mund të pretendojë të jetë unike, absolute e padiskutueshme. Nuk ekziston vetëm një vlerë ose një grup vlerash homogjene, të cilat të mbështeten nga e gjithë shoqëria, që më pas të shërbenin edhe si njësi matëse për të përcaktuar se çfarë është e drejtë apo e gabuar, se çfarë është e vërtetë apo false. Ekzistojnë vlera të ndryshme, shpesh në kundërshti me njëra-tjetrën, të cilat meritojnë mbrojtje nga rendi juridik.

Kjo “doktrinë e parimeve” e zhvilluar në konstitucionalizmin amerikan me mbështetës R.Dworkin¹³, gjen mbështetje edhe në sistemet e *civil law*, dhe përbën teorinë e re të interpretimit. Sipas kësaj doktrine, koncepti i së vërtetës nuk shërben më për zgjidhjen e problemeve, ndaj dhe flitet më shumë, për gjetjen e ekuilibrit, proporcionalitetit, drejtpeshimit të vlerave dhe të parimeve për zgjidhjen e tyre. Nuk është më teksti pika e nisjes për vlerësimet e interpretuesit, por është problemi, rasti konkret, kazusi, ku dispozita ligjore duhet të zbatohet. Tashmë pranohet në teorinë e interpretimit se, dispozita ligjore nuk ka vetëm një kuptim, atëherë është detyrë e gjyqtarit t’i japë kuptim dispozitës ligjore sipas kazusit që paraqitet për zgjidhje. Pra është rasti konkret ai i cili përcakton kuptimin e normës. Ndërtohet kështu një rreth vicioz mes rastit konkret-interpretuesit-dispozitës ligjore.

Konstitucionalisti i famshëm amerikan propozon atë që njihet si interpretimi dhe leximi moral i tekstit kushtetues, *the moral reading of Constitution*¹⁴. Përmes interpretimit moral të Kushtetutës autori pohon se, edhe nëse një interpretim i tillë është drejtuar kundër zhvlerësimit të akteve legjislativë, e legjitimon një Gjykatë Kushtetuese dhe nuk e bën arbitrare kundrejt ligjvënësit. Interpretimi moral i Kushtetutës sipas Dworkin do të thotë të interpretosh klauzolat kushtetuese sipas parimeve

13 R.Dworkin *Taking the rights seriously, Law's Empire*, Harvard University Press, 1986.

14 R.Dworkin, *Freedom's Law. The Moral Reading of the American Constitution*, Oxford, Oxford University Press, 1996, f. 1.

morale abstrakte. Gjyqtari ka një rol të rëndësishëm në interpretimin e së drejtës sepse duhet të zbatojë konceptet dhe botëkuptimin e tij mbi të drejtën, duke u mbështetur në argument të natyrës morale për zgjidhjen e rasteve të vështira (*hard cases*).¹⁵Leximi moral i Kushtetutës do të thotë që gjyqtari kushtetues i jep atë interpretim vlerave dhe të drejtave të sanksionuara në Kushtetutë sipas kulturës dhe traditës së shoqërisë dhe zhvillimit historik.

1.2 Interpretimi originalist dhe interpretimi evolutiv

Ajo që mund të konsiderohet si një debat i përhershëm jo vetëm i konstitucionalizmit amerikan, por edhe atij evropian, është dyzimi mes dy teorive të interpretimit të kushtetutës ose mes interpretimit origjinal dhe atij evolutiv. Vendosja e interpretimit kushtetues përballë dy teorive, të cilat qëndrojnë në dy pole të ndryshme sa i takon interpretimit të Kushtetutës, ka ndikuar tek Gjykatat Kushtetuese si interpretuesit kryesorë të Kushtetutës, që t'i përdorin këto teknika interpretimi pak a shumë të dyja sipas rasteve.

Teoria e parë presupozon interpretimin e tekstit kushtetues sipas qëllimit që kanë pasur vetë autorët e saj në Asamblenë Kushtetuese. Dispozita kushtetuese duhet të interpretohet sipas qëllimit (*original intent ose original meaning*) të kushtetutbërësit dhe të themeluesve të Kushtetutës (*framers*), nën dritën e punimeve për hartimin e Kushtetutës¹⁶. Kjo teori ka për qëllim për të kufizuar diskrecionin e vendimmarrjes për brezat e ardhshëm, si dhe për të parandaluar vendime të “këqija të tyre”, për t'i qëndruar në këtë mënyrë besnik disa vlerave të mira, që Kushtetutbërësi i konsideron të rëndësishme¹⁷. Kjo mënyrë e interpretimit të Kushtetutës i përgjigjet në fakt edhe stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së Kushtetutës, dhe ky i fundit është një tipar i përbashkët thelbësor i konstitucionalizmit modern, i pranishëm jo vetëm në traditën kushtetuese

15 A.Barak, *The Judge in a Democracy*, Princeton University Press, 2006, f. 95.

16 P.Brest, *The Misconceived Quest for original understanding*, Boston University Law Review, 1980, f. 204.

17 J.M.Balkin, *Framework originalism and the living constitution*, Northwestern University, School of law, University Law Review, p.554.

franceze të Kushtetutave-akt, por edhe në traditën kushtetuese amerikane, që i konsideron Kushtetutën si pakt dhe kompromis¹⁸.

Interpretimi besnik i Kushtetutës sipas qëllimit fillestar të saj, në fakt nuk garanton jetëgjatësinë e një teksti kushtetues, i cili duhet të jetë i aftë t'u përgjigjet kërkesave të kohës dhe të shoqërive postmoderne shumë heterogjene nga pikëpamja e vlerave morale. Ky konsiderohet si një nga defektet kryesore të kësaj teorie, e cila “ngrin” ose “fotografon” rendin kushtetues në një moment historik të caktuar, por nga ana tjetër, mund t'i ndalojë gjeneratave të ardhshme leximin evolutiv të tekstit kushtetues. Kjo teori e orienton interpretuesin që të kërkojë kuptimin e dispozitës kushtetuese, kur kjo nuk bëhet e mundur nga teksti i saj, tek punimet e Asamblesë Kushtetuese, për të parë se cili ka qenë qëllimi i tyre për formulimin e një dispozite të caktuar, cili ka qenë vullneti i këtij organi kolegjal si autori i tekstit kushtetues¹⁹. Kjo bëhet edhe më e vështirë kur në vetë gjirin e Asamblesë nuk ka patur një qëndrim të njëzëshëm të anëtarëve të saj, madje mund të ketë patur edhe qëndrime të kundërta. Për këtë arsye, referimi tek punimet e projekt-kushtetutës, mund të konsiderohet si një mjet ndihmës i interpretimit kushtetues krahas atij literal dhe sistematik, por jo vendimtar.

Në këtë kontekst, gjen mbështetje në radhët e konstitucionalistëve edhe teoria e Kushtetutës së gjallë ose *living constitution*, sipas të cilës Kushtetuta e gjallë, ndryshon në kohë dhe i përshtatet rrethanave të reja, pa ndryshuar formalisht tekstin e saj²⁰. Kjo teori, lindi për herë të parë në konstitucionalizmin amerikan²¹. Është pikërisht kjo teori, e cila garanton jetëgjatësinë e një teksti kushtetues, e aftë të përballojë kërkesat e reja

18 G.Fontana, *Il referendum costituzionale nei processi di riforma della repubblica*, Editoriale Scientifica, Napoli 2012, f. 25.

19 F.Giuffrè, I.Nicotra, *Lavori preparatori ed original intent del legislatore Costituente nella giurisprudenza costituzionale*, botuar në, *Lavori preparatori ed original intent nella giurisprudenza della Corte costituzionale*, vep. cit.,f. 2.

20 D.A.Strauss, *The living Constitution*, Oxford, Oxford University Press, 2010, f.1.

21 Veçanërisht për këtë teori është folur për herë të parë nga autori Prof. H.Mc. Bain, *The Living Constitution*, Columbia University Law School, 1927.

të shoqërisë, të cilave Kushtetuta duhet t'i ofrojë mbrojtje. Përmes saj, Kushtetuës i sigurohet vazhdimësia e zbatimit të saj me kalimin e kohës, duke e bërë atë gjithmonë aktive në zgjidhjen e problemeve në një shoqëri demokratike pluraliste.

Sipas kësaj teorie, Kushtetuta duhet kuptuar si një organziëm i gjallë²², që jeton dhe implementohet në shoqëri sipas nevojave të saj. Me fjalë të tjera, ajo është një proces që ndërtohet, formohet dhe rritet me kalimin e kohës dhe me evolucionin e shoqërisë. Kjo bëhet edhe më konkrete kur kemi parasysh probleme të jetës së përditshme, të cilave duhet t'u jepet një zgjidhje sidomos përmes interpretimit kushtetues, në ato raste kur ka një zbrazëti ligjore që të rregullojë atë problem. P.sh të drejtat e reja, të cilat në fakt nuk mund të jenë parashikuar nga Kushtetuta në çastin e hartimit të saj, pasi nuk kanë ekzistuar, por që përmes Kushtetutës së gjallë mund të gjejnë mbrojtje. Gjithmonë e më shumë flitet për të drejtën e aksesit në internet, si një e drejtë “themelore” e njeriut, por që për momentin nuk është sanksionuar në ndonjë dokument ndërkombëtar, eutanasia, që për momentin nuk ka një rregullim ligjor të brendshëm, e drejta e privatësisë, e cila konsiderohet si një e drejtë relativisht e re etj.

Kjo teori na kujton edhe reflektimin e filozofit gjerman R.Smend se Kushtetuta është një ligj jo për një statujë, por i një realiteti të gjallë, i cili ka një proces²³ evolutiv.

Kushtetuta si një “*instrument i gjallë*” “*living instrument*” (duke përdorur edhe terminologjinë e Gjykatës së Strasburgut më këtë rast²⁴), do të thotë se kuptimi i dhënë dispozitave të saj dhe interpretimi i bërë, bëhet duke patur parasysh se si ajo “jeton” dhe implementohet në marrëdhëniet ndërmjet organeve kushtetuese. Sjellja e organeve kushtetuese si Presidenti i Republikës, Kuvendi apo vetë Gjykata Kushtetuese, si dhe zbatimi i dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me funksionet e tyre që vetë Kushtetuta ia atribuon, ndikojnë në interpretimin e Kushtetutës. Në teorinë e Kushtetutës së gjallë kontribuojnë, përveç teknikave të

22 W.H.Rehnquist, *Harvard Journal of Law & Public Policy*, Vol.29, f. 402.

23 G. Fontana, *Il referendum Costituzionale nei processi di riforma della repubblica*, Editoriale Scientifica, Napoli, 2013, f. 41.

24 Çështja Bayatian k. Armenisë, 27 tetor 2009, T. k. Mbretërisë së Bashkuar, 25 prill 1978.

interpretimit kushtetues edhe faktorë të tjerë si konventat kushtetuese, zakonet kushtetuese, jurispruduenca kushtetuese etj.

Nga ana tjetër, doktrina kushtetuese ka evidentuar rrugët e ndryshimit të Kushtetues përgjithësisht janë dy; rruga e parë klasike është ajo përmes procedurës së rishikimit të Kushtetutës, kjo rrugë është edhe rruga fiziologjike e ndryshimeve kushtetuese pasi ato vijnë në mënyrë formale, duke respektuar dhe zbatuar procedurën, ndërsa rruga e dytë, vjen përmes veprimtarisë interpretuese, ku në fakt kemi një ndryshim ose transformim të Kushtetutës, por pa ndryshuar formalisht dhe juridikisht tekstin e saj. Doktrina kushtetuese e klasifikon mënyrën e dytë si mënyra joformale dhe të “heshtura” të ndryshimeve kushtetuese²⁵. Rolin themelor të këtij procesi evoluimi dhe ndryshimeve kushtetuese e luan sigurisht jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila në veprimtarinë e saj është interpretuesja kryesore dhe më autoritare e Kushtetutës. Ajo është kontribuesja kryesore në formimin e së “drejtës së gjallë” kushtetuese.

Kësaj teorie nuk i mungojnë as kritikë e atyre që mund të mendojnë qoftë edhe hipotetikiqist që Kushtetuta e gjallë mund t'i kundërvihet Kushtetutës së shkruar, madje duke e zëvendësuar atë, duke tradhëtuar vetë qëllimin e kushtetutbërësit. Kjo kritikë, sipas S.Bartole, mund të ngrihet prej atyre, të cilët humbasin kufijtë e veprimtarisë interpretuese në të cilën pranohet botërisht që me anë të interpretimit bëhet një ndërhyrje krijuese mbi tekstin e shkruar, duke rinovuar kuptimin e një dispozite të caktuar, por kjo nuk mund të shkojë deri tek ndryshimi rrënjësor i kuptimit të dispozitës, pasi në këtë pikë nuk flitet më për interpretim, por për rishikimin e Kushtetutës. Veprimtaria e interpretimit kushtetues duhet të vihet përballë rishikimit të kushtetutës për të përcaktuar vijën ndarëse mes dy veprimtarive. Pra problemi nuk është për të dalluar se sa me anë të interpretimit jemi larguar nga teksti i shkruar, por për të kontrolluar nëse ky interpretim është dhënë si alternativë e rishikimit kushtetues apo jo²⁶.

Natyrisht kjo lidhet me fenomenin e abuzimit të veprimtarisë interpretuese, e cila në mënyrë të “simuluar”, nuk ndjek rrugën e ndryshimit të Kushtetutës përmes procesit të rishikimit të Kushtetutës,

25 G.Fontana, *Il referendum costituzionale nei processi di riforma*, vep.cit., f. 39.

26 S.Bartole, *La Costituzione è di tutti*, Il Mulino, Bologna, 2012, f. 169.

por në vend të saj përdor rrugën e interpretimit kushtetues.

Doktrina e Kushtetutës aktive ose e Kushtetutës së gjallë, atakohet edhe për disa arsye të tjera; *Thuhet se shkëputja nga origjina nënkupton rritjen e autoritetit diskrecional; autoriteti dikrecional është i barazvlefshëm me vlerësimin politik, vlerësimi politik është i papajtueshëm me natyrën juridike të kontrollit gjyqësor dhe kushtetues të drejtësisë dhe cenon parimin e ndarjes së pushteteve minon legjitimitimin e drejtësisë kushtetuese. Jo vetëm për të ruajtur parimin e ndarjes së pushteteve; jo vetëm për të ruajtur natyrën gjyqësore të drejtësisë kushtetuese, por edhe për të mbrojtur bazën e ligjshmërisë, doktrina e kushtetutës aktive duhet të hidhet poshtë, ndonëse është imponuar me forcë në veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese*²⁷.

Tek teoria e interpretimit evolutiv është zhvilluar teknika e re e interpretimit bashkëkohor, e cila gjen përfaqësimin e saj tek filozofi gjerman H.G.Gadamer²⁸, i cili vë në dukje se metodologjia e interpretimit varet më shumë nga subjektiviteti i interpretuesit sesa nga objekti i interpretuar dhe përmbajtja e tij. Teksti juridik, duhet të interpretohet në mënyrë që të na bëjë të vetëdijshëm disa gjëra, të cilat kanë mbetur në nivelin e të pandërgjegjshmes së autorit të tekstit, dhe këtë duhet ta bëjë interpretuesi, i cili duhet të jetë i aftë të dallojë historinë e objektit dhe subjektit të interpretimit. Gadamer arrin të dallojë qartë subjektivitetin e interpretuesit nga ai i autorit të tekstit. Ajo që e dallon mendimin Gadamerian është distancimi nga koha e shkrimit të tekstit. Ndërsa teoritë e vjetra hermeneutike i referoheshin qëllimit të autorit për të kuptuar tekstin, Gadamer përmes distancimit kohor arrin të ndajë autorin nga interpretuesi²⁹. Teoria e re e interpretimit nuk ka të bëjë vetëm me përshtatjen e tekstit me kalimin e kohës, por të lexosh tekstin nën dritën e asaj që distancimi kohor ose historik ka lejuar. Kuptohet se mendimi

27 Marrë nga fjalimi i Prof. Gustavo Zagrebelsky, mbajtur në ceremoninë e 50-vjetorit të krijimit të Gjykatës Kushtetuese italiane, i cituar në A. Anastasi, *E Drejta kushtetuese e krahasuar*, vep.cit., f. 43.

28 T.Guarnier, *Interpretazione costituzionale e diritto giurisprudenziale*, specificità e problemi dell'interpretazione costituzionale nell'ordinamento integrato, vep.cit., f. 120.

29 Po aty, f. 122.

Gadamerian ka një qasje evolutive në interpretimin kushtetues, por me ndryshimin se testi kohor është elementi kyç i zbulimit të kuptimit të tekstit.

1.1 Ndërkombëtarizimi i interpretimit kushtetues

Sot kur flasim për interpretimin e Kushtetutës padyshim që Gjykata Kushtetuese është organi i posaçëm kushtetues, i cili ka autoritetin e interpretimit përfundimtar të saj. Nga kjo rrjedh se interpretimi i dispozitës kushtetuese sipas kuptimit të dhënë prej saj është i detyrueshëm për zbatim jo vetëm nga gjykatat e çdo niveli, por edhe për të gjitha organet shtetërore. Gjykata Kushtetuese ka pranuar fuqinë juridike *erga omnes* të vendimeve të saj; *Pikërisht këto vendime të Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë përfundimtare, të formës së prerë dhe të detyrueshme për zbatim, nuk janë mbajtur parasysh nga Kuvendi me rastin e ndryshimit që i ka bërë nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale*³⁰. Sa i takon interpretimit përfundimtar të Kushtetutës ajo gëzon një pozicion ekskluziv kundrejt të gjitha organeve të tjera shtetërore. Ky është një qëndrim konstant i vetë Gjykatës Kushtetuese, por sot më shumë se kurrë mendoj se ka nevojë të ridimensionohet dhe të rishihet autoriteti i vendimeve të interpretimit sidomos në kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në shkallë evropiane.

Në kontinentin evropian jemi përpara fenomenit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut me shumë nivele. Për mbrojtjen e tyre vepron njëkohësisht disa rende juridike, si rendi juridik kombëtar, ai i Bashkimit Evropian dhe sistemi i Konventës Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Për të trija këto sisteme vepron një organ gjyqësor suprem si hallka kryesore dhe e fundit brenda sistemit të tyre për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Gjykata Kushtetuese për rendet kombëtare, Gjykata e Drejtësisë e BE-së dhe Gjykata e Strasburgut në sistemin e Konventës Evropiane. Skenari mbi të ardhmen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Evropë mbetet mjaft dinamik dhe nuk ka përfunduar, sidomos me parashikimin në nenin 6 TFBE, mbi aderimin e Bashkimit Evropian në

30 Vendimi nr. 15/2003 i Gjykatës Kushtetuese.

KEDNJ³¹.

Në lidhje me Gjykatën e Strasburgut, mund të themi se përmes nenit 17/2 të Kushtetutës KEDNJ-ë zë një vend të posaçëm në rendin tonë kushtetues dhe thirret drejtpërdrejt nga Kushtetuta përsa i përket kufizimit të të drejtave të njeriut. Gjithashtu vetë kjo dispozitë është një klauzolë kushtetuese e natyrës hermeneutike, e cila lejon Gjykatën Kushtetuese shqiptare që të interpretojë të drejtat dhe lirtë themelore të parashikuara nga Kushtetuta nën dritën e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut³². Kuptohet se Gjykata Kushtetuese nuk është e vetme në interpretimin e dispozitave kushtetuese mbi të drejtat e njeriut, por është vetë Kushtetuta që i imponon një interpretim të tyre në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Mjafton të përmendim këtu rastin e interpretimit të nenit 21 të Kushtetutës “të drejtën për jetën” sipas frymës së KEDNJ-së dhe jurisprudencës së Strasburgut³³.

Nga ana tjetër, kjo “varësi” e Gjykatës Kushtetuese bëhet edhe më e dukshme kur për një dispozitë kushtetuese të caktuar ajo e ka interpretuar në një mënyrë të ndryshme nga interpretimi i Gjykatës së Strasburgut. Si p.sh për interpretimin e nenit 42 mbi procesin e rregullt ligjor, ku përbënte një jurisprudencë të konsoliduar fakti se dispozita në fjalë nuk përfshinte procesin ekzekutiv, por menjëherë pas vendimit të Gjykatës së Strasburgut rasti *Qufaj kundër Shqipërisë*, 2000, e cila konsideroi procesin ekzekutiv si pjesë të procesit të rregullt ligjor, vetë Gjykata Kushtetuese shqiptare ndryshoi në mënyrë radikale qëndrimin, thënë në gjuhën e

31 Edhe pse formalisht një gjë e tillë u sanksionua në nenin 6 të TFBE përsëri procesi i aderimit të BE-së në KEDNJ-ë mbetet një proces mjaft kompleks dhe së fundmi duket se është bllokuar nga opinioni negativ i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë n. 2/2013, e cila u vu në lëvizje me kërkesë të Komisionit Evropian për konsultim mbi projekt-marrëveshjen e aderimit. Për më tepër shih; V.Zagrebelky, *UE e il controllo esterno della protezione dei diritti e delle libertà fondamentali in Europa*. La barriera elevata dalla Corte di Giustizia, publikuar në www.sidi-isil.org.

32 S.Sadushi, *Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në frymën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, botuar në, E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, n. 11/2003, f. 28.

33 Vendimi nr. 65/1999 i Gjykatës Kushtetuese.

vendeve të precedentëve gjyqësorë *distinguishing*, duke konsideruar edhe procesin ekzekutiv si pjesë të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe duke e interpretuar këtë dispozitë në frymën e jurisprudencës së GJEDNJ-së. Duhet të evidentojmë se “fjala e fundit” sa i takon interpretimit të dispozitave kushtetuese mbi të drejtat e njeriut nuk i takon Gjykatës Kushtetuese shqiptare, por GJENDJ-së, bazuar kjo në kuadrin kushtetues që ka rregulluar marrëdhëniet me sistemin e Strasburgut e konfirmuar edhe nga kazuistika e lartpërmendur.

Sa i takon influencës së akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë në interpretimin kushtetues, nënvizojmë se nuk kanë munguar rastet ku Gjykata Kushtetuese u është referuar pikërisht marrëveshjeve ndërkombëtare për interpretimin e dispozitave të caktuara kushtetuese. Kështu në rastin e interpretimit të nenit 25 të Kushtetutës mbi “torturën”, ajo i referohet jo vetëm Kushtetutës dhe Konventës Evropiane, por edhe Konventës kundër torturës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së 1984³⁴. Gjithashtu, edhe për interpretimin përfundimtar të nenit 13 të Kushtetutës, sa i takon parimit të decentralizimit të pushtetit e të autonomisë vendore, Gjykata Kushtetuese u bazua edhe në standardet që sanksionohen nga Karta Evropiane e Autonomisë Vendore³⁵ etj.

Gjithashtu, paraqesin ndikim në interpretimin kushtetues edhe jurisprudenca e gjykatave kushtetuese të huaja, të cilat Gjykata Kushtetuese shqiptare i thërret për të mbështetur dhe argumentuar qëndrimin e saj për një çështje të caktuar. Mjafton të përmendim rastin e rihapjes së procesit penal pas konstatimit të shkeljes së Konventës Evropiane, ku Gjykata Kushtetuese shqiptare iu referua Gjykatës Kushtetuese italiane duke mbajtur të njëjtin qëndrim me të për rihapje të procesit penal³⁶, interpretimin e nenit 123 të Kushtetutës mbi kufizimin e transferimit të kompetencave tek një organizate ndërkombëtare (Statutit të Romës) Gjykata Kushtetuese i referohet jurisprudencës kushtetuese gjermane dhe

34 Vendimi nr. 3/2004 i Gjykatës Kushtetuese.

35 Vendimi nr. 29/2006 i Gjykatës Kushtetuese.

36 Vendimi nr. 20/2011 i Gjykatës Kushtetuese shqiptare dhe vendimi nr. 113/2011 i Gjykatës Kushtetuese italiane.

franceze³⁷, i referohet jurisprudencës kushtetuese gjermane, austriake dhe italiane sa i takon rastit të konstatimit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit dhe interpretimit të nenit 70 paragrafi 3 dhe 4 të Kushtetutës³⁸, referimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Letonisë, sa i takon parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve³⁹, i referohet Gjykatës Kushtetuese italiane për interpretimin e nocionit të së “drejtës së gjallë”⁴⁰, së fundmi referimi në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese gjermane sa i takon interpretimit të nenit 108 të Kushtetutës me rastin e kontrollit kushtetues të ligjit për reformën administrativo-territoriale⁴¹ etj.

Sa i takon interpretimit të dispozitave kushtetuese që sanksionojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, teoria e së drejtës natyrore na ka mësuar se këto të drejta, janë të mishëruara me lindjen e njeriut, ato nuk mund të preken as mund të cenohen a tjetërsohen, nga e drejta pozitive. Universalizimi i të drejtave të Njeriut, bën që për interpretimin e tyre, Gjykata Kushtetuese t’i referohet organeve të tjera homologe. ⁴²G. Zagrebelsky, është shprehur se në këto raste po flasim jo për një diktaturë universale të të drejtave të njeriut, por për një instrument që na mundëson të kuptojmë kushtetutat tona kombëtare, nëpërmjet sfondit nga ato vijnë, i cili i jep atyre një kuptim të saktë në një moment të caktuar historik. Metodologjia studimore krahasuese e përdorur nga Gjykatat Kushtetuese si një instrument interpretimi për të bërë interpretimin e dispozitave të brendshme kushtetuese, duke iu referuar vendimeve të gjykatave kushtetuese të huaja, nuk i jep këtyre të fundit fuqi juridike detyruese, por këto ndikojnë në interpretimin kushtetues duke patur vetëm një vlerë, siç e ka cilësuar A.Pizzorusso *soft law*⁴³. Natyrisht që fenomeni i referimit të vendimit të gjykatave kushtetuese të huaja bëhet në ato vende që kanë

37 Vendimi nr. 186/2002 i Gjykatës Kushtetuese.

38 Vendimi nr. 442011 i Gjykatës Kushtetuese.

39 Vendimi nr. 18/2003 i Gjykatës Kushtetuese.

40 Vendimi nr. 6/2012 i Gjykatës Kushtetuese.

41 Vendimi nr. 19/2015 i Gjykatës Kushtetuese.

42 A.Anastasi, *E Drejta kushtetuese e krahasuar*, Dajti, Tiranë, 2009, f. 41.

43 A.Pizzorusso, *La produzione normativa nei tempi di globalizzazione*, botuar në www.associazionedeicostituzionalisti.it.

si regjim të tyre demokracinë liberale dhe që ndajnë e mbrojnë të njëjtat vlera dhe kanë në thelb mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, duke krijuar në këtë mënyrë një *ius commune* në fushën e të drejtave themelore⁴⁴.

Fenomeni i thirrjes së vendimeve të Gjykatave të tjera homologe evropiane, në kontekstin e integritimit evropian, po kontribuon në atë që së fundmi doktrina kushtetuese gjermane e cilëson si krijimi i së drejtës publike evropiane përmes procesit të unifikimit të sistemeve të drejtësisë kushtetuese në Evropë⁴⁵, por që autorë të tjerë e konsiderojnë edhe si krijimi i së drejtës kushtetuese evropiane.

Favorizojnë qarkullimin dhe njohjen e jurisprudencave edhe veprimtaritë e karakterit të së drejtës kushtetuese të krahasuar që organizohen nga Komisioni i Venecias përmes seminareve studimore, por edhe me anë të bazës së të dhënave si *Bulletin on Constitutional Case-Law*, i cili që prej vitit 1993 publikon përmbledhje të vendimeve më të rëndësishme në gjuhën angleze të më shumë se 60 gjykatash kushtetuese dhe gjykatash të larta, me qëllim për të shkëmbyer informacionin ndërmjet gjykatave, si dhe për të ndihmuar gjykatat që të zgjidhin çështje të vështira. Një tjetër bazë të dhënash mjaft e rëndësishme është edhe *Info Base on Constitutional Case-Law CODICES*, e cila përmban rreth 7000 vendime në anglisht dhe frëngjisht, duke ndihmuar së tepërmi juristët në studimet krahasuese⁴⁶.

Në analizë të fundit, fenomeni i qarkullimit të jurisprudencave i ka dhënë jetë krijimit të një nocioni të ri të së drejtës njohur si e drejta trans-kombëtare ose ndërkuftare. Për ta shpjeguar këtë fenomen duhet t'i referohemi teorive të organizatave ndërkombëtare. E drejta transkombëtare dallon nga e drejta ndërkombëtare, pasi ajo nuk krijohet mbi bazën e traktateve apo të organizatave ndërkombëtare ku shtetet sovraane janë anëtare, por e kundërta çdo shtet ruan individualitetin e

44 R.Conti, *I giudici e il biodiritto*, Aracne, Roma 2014, f.160.

45 Armin von Bogdandy, Christoph Grabenwarter, Peter M. Huber, *Il diritto costituzionale nel diritto pubblico europeo. L'esempio della rete istituzionalizzata della giustizia costituzionale*, publikuar në; www.aic.it, nr. 4/2015, f. 4.

46 Po aty, f. 6.

tij dhe nuk është pjesë e një organizate ndërkombëtare, por entitete të caktuara si gjykatat kushtetuese të këtyre vendeve komunikojnë me njëra tjetrën, duke i dhënë jetë krijimit të një të drejte transkombëtare, që vepron brenda juridiksionit të vetë gjykatave kushtetuese kombëtare.

1.1 Interpretimi i Kushtetutës sipas Gjykatës Kushtetuese

Pas këtij kuadri të përgjithshëm të interpretimit kushtetues dhe teorive që e karakterizojnë atë, është e domosdoshme të hedhim një vështrim të përgjithshëm mbi qasjen që ka Gjykata Kushtetuese në interpretimin e Kushtetutës. Duhet thënë se në potencë interpretimi i Kushtetutës është në kompetencë të çdo organi kushtetues, secili në fushën e atribuimeve kushtetuese bën interpretimin e dispozitave kushtetuese. Ky është një pohim i njohur edhe nga vetë Gjykata Kushtetuese; *Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë janë interpretuesit e parë të normës kushtetuese prandaj, bazuar në parimin e luajalitetit kushtetues, duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e kritereve ligjore në përputhje me kërkesën kushtetuese për kualifikim të lartë, për të siguruar një përbërje cilësore të kësaj Gjykate*⁴⁷.

Nga ana tjetër, përderisa është njohur edhe natyra normative e vetë Kushtetutës, si dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i saj, aty ku është e mundur, interpretimi i Kushtetutës hyn edhe në juridiksionin e sistemit gjyqësor të zakonshëm. Kështu, nuk kanë munguar rastet kur në praktikën gjyqësore, janë zbatuar dhe interpretuar dispozitat kushtetuese sidomos në fushën e juridiksionit fillestar të Gjykatës së Lartë apo edhe nga gjykatat e shkallëve më të ulëta⁴⁸.

Duhet të evidentojmë se interpretimin e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e bën jo vetëm në interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, si një e drejtë ekskluzive e saj, por sa herë që ajo ushtron kontrollin

47 Vendimi nr. 24/2011 i Gjykatës Kushtetuese.

48 Për më tepër shih vendimin nr. 3011/2012 i Gjykatës së Apelit, Tiranë, ku ndër të tjera ajo interpreton dhe zbaton nenin 73/1 “ të Kushtetutës në lidhje me përgjegjësinë e deputetit për mendimet e shprehura, si dhe nenin 22 “mbi lirinë e shprehjes”, madje duke iu referuar në interpretimin që u bënë dispozitave kushtetuese edhe jurisprudencës kushtetuese gjermane.

kushtetues, pasi për të vërtetuar kushtetutshmërinë ose jo të një ligji, ajo duhet ta ballafaqojë atë me dispozitat kushtetuese, ku edhe duhet t'i interpretojë këto të fundit. Nga ana tjetër, interpretimi i Kushtetutës bëhet më i dukshëm kur ajo investohet nga organet kushtetuese për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Fillimisht Gjykata Kushtetuese ka njohur kompetencën e saj të interpretimit kushtetues (neni 124 i Kushtetutës), edhe në rastet kur kërkesa për interpretimin e një dispozite të Kushtetutës, nuk lidhej me ekzistencën e një mosmarrëveshjeje konkrete. Kërkesa për interpretimin e Kushtetutës lidheshin vetëm me interpretimin e saj, qartësimin e përmbajtjes së dispozitës kushtetuese, por jo në lidhje me “keqzbatimin apo keqinterpretimin” e saj nga ana e organeve të ndryshme⁴⁹.

Më pas Gjykata Kushtetuese do të ndryshojë qëndrimin e saj⁵⁰, duke filluar nga vendimi nr.18/20003, në lidhje me juridiksionin kushtetues të interpretimit përfundimtar të Kushtetutës, duke mos pranuar kërkesa, të cilat kanë për objekt vetëm pyetje në lidhje me qartësimin dhe kuptimin e dispozitës kushtetuese, dhe që nuk lidhen me një situatë apo gjendje të zbatimit të saj nga ana e institucioneve përgjegjëse. Tashmë, përbën jurisprudencë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese se interpretimi i Kushtetutës është një gjykim i natyrës konkrete dhe lidhet me mënyrën se si një dispozitë kushtetuese është zbatuar në rastin konkret dhe ka krijuar një “ngërç” në lidhje me institucionet që e kanë zbatuar atë. Ky lloj gjykimi është një gjykim i tipit konkret dhe jo abstrakt.

Autoritetin e interpretimit përfundimtar të Kushtetutës Gjykata Kushtetuese e ka shprehur qartë tek koncepti i *res judicata* kushtetuese; *në aspektin formal e procedural, gjë e gjykuar nënkupton përfundimin, në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit. Ky parim është i zbatueshëm, jo vetëm ndaj palëve në gjykim, por edhe ndaj të gjitha autoriteteve publike brenda juridiksionit që janë të interesuara ose të përfshira në përmbajtjen e vendimit të gjykatës*⁵¹. Këtu kuptohen qartë efektet juridike

49 S.Sadushi, Drejtësia Kushtetuese, Toena, Tiranë, 2012, f. 206.

50 Po aty, f. 207.

51 Vendimi nr.29/2006 i Gjykatës Kushtetuese.

ultra partes të vendimeve të saj.

Një nga kriteret e interpretimit të Kushtetutës, i cili përbën edhe një jurisprudencë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese është interpretimi sistematik ose interpretimi i dispozitave kushtetuese i bërë jo vetëm në harmoni me dispozitat brenda një pjese të caktuar të Kushtetutës, por me të gjitha dispozitat e saj; *Gjykata rithekson se çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo, për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik.*⁵². Ky instrument interpretimi në fakt është huazuar nga Gjykata e Strasburgut, e cila prej kohësh zbaton interpretimin harmonik të dispozitave të KEDNJ-së në pajtim me të gjithë tekstin e Konventës⁵³.

Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese janë përdorur më së shumti interpretimi gramatikor-literal dhe interpretimi historik. Kështu në interpretimin e nenit 77/2 i Kushtetutës në lidhje me çështjen e ngritjes së komisioneve hetimore parlamentare dhe posaçërisht i shprehjes “çështje e veçantë”, ajo analizon aspektin gjuhësor të saj⁵⁴, po ashtu ajo i bën një interpretim literal nenit 125/1 dhe 136/1 të Kushtetutës dhe veçanërisht termit “pëlqim”, duke u bazuar në fjalorin e shqipes së sotme⁵⁵. Me rastin e interpretimit të nenit 101 të Kushtetutës në lidhje aktet normative me fuqinë e ligjit, Gjykata Kushtetuese i bën një interpretim gramatikor kësaj dispozite kushtetuese për të evidentuar se nevoja dhe urgjenca janë elementët thelbësorë që duhet të jenë bashkërisht të pranishëm për nxjerrjen e këtyre akteve, duke u ndalur tek lidhëza “dhe”, e cila në çdo rast kërkon praninë e njëkohshme të të dy elementëve, në dallim nga rastet e tjera kur në dispozitën ligjore janë përdorur lidhëset “ose” “apo”⁵⁶.

Sa i takon interpretimit historik ose interpretimit sipas qëllimit fillestar që ka pasur kushtetutbërësi në çastin e hartimit të Kushtetutës, i ashtuquajtur *original intent*, mund të përmendim këtu po të njëjtin

52 Vendimi nr.2/2005 i Gjykatës Kushtetuese.

53 Çështja *Folgero kundër Norvegjisë*, 2007, *Scordino kundër Italisë*, 2006 etj.

54 Vendimi nr.18/2003 i Gjykatës Kushtetuese.

55 Vendimi nr.2/2005 i Gjykatës Kushtetuese.

56 Vendimi nr.24/2006 i Gjykatës Kushtetuese.

rast të interpretimit të termit *pëlqim*, ku Gjykata Kushtetuese, krahas interpretimit gjuhësor bën edhe interpretimin teleologjik të dispozitave kushtetuese, duke iu referuar edhe qëllimit të hartuesve të Kushtetutës, *qëllimi i hartuesve të Kushtetutës, ka qenë që emërimi i gjyqtarëve të mos mbetet vetëm në kompetencën e një organi[.....]*⁵⁷; Në interpretimin e nenit 2, pika 1 të Kushtetutës, ku *populli e ushtron sovranitetin e tij nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt* ajo i referohet qëllimit të kushtetutbërësit, i cili ka shprehur një preferencë të qartë në favor të demokracisë përfaqësuese⁵⁸. Një interpretim teleologjik/sistematik është bërë gjithashtu edhe me rastin e interpretimit të pozitës kushtetuese të Konferencës Gjyqësore Kombëtare⁵⁹.

Sa i takon interpretimit evolutiv ose teorisë së Kushtetutës së gjallë, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese nuk haset një përdorim i gjerë i kësaj teorie, por në të vërtetë ajo është ndalur edhe mbi këtë teori, duke dhënë edhe një përgjigje debatit kushtetues që mbetet i ndarë në dy fraksione mes përkrahësve të teorisë së interpretimit historik dhe atyre të interpretimit evolutiv; *Në këtë kuptim mund të themi se Gjykata ka dy funksione themeltare: atë shtytës-evolutiv të përshkruar më sipër; i cili shpesh është rrjedhojë e vlerës që kanë vendimet e GJEDNJ-së, dhe faktit se Gjykata mund të përdorë në mbështetje të arsytimeve të veta qëndrimet që kanë mbajtur Gjykatat homologe europiane dhe më gjerë dhe, nga ana tjetër; funksionin mbrojtës-konservativ, duke garantuar pandryshueshmërinë e mbrojtjes kushtetuese për ato vlera që konsiderohen si kryesore nga populli i Republikës së Shqipërisë, vullnetin e të cilit interpreton Gjykata Kushtetuese. Të dyja këto funksione janë njëherazi të rëndësishme dhe të barasvlefshme*⁶⁰.

Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese në veprimtarinë e saj interpretuese, ka ruajtur pozitën e saj kushtetuese si ligjvënës negativ, sipas kuptimit të dhënë prej Kelzenit, përveç ndonjë rasti të izoluar, ku

57 Vendim i Gjykatës Kushtetuese i cituar më lart.

58 Vendimi nr.25/2009 i Gjykatës Kushtetuese.

59 Vendimi nr.25/2008 i Gjykatës Kushtetuese.

60 Vendimi nr.20/2011 i Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese u kthye në ligjvënës pozitiv⁶¹. Tashmë përbën një jurisprudencë të konsoliduar të saj që, interpretimi kushtetues ka vend vetëm për një normë ekzistuese, dhe se ajo nuk merr përsipër rolin krijues të një norme që mungon. *Nëpërmjet interpretimit, Gjykata ka parasysh të mos zhvendoset në pozicionin e një ligjvënësi pozitiv që krijon norma të reja kushtetuese, por të japë kuptimin e vërtetë që përmban vetë dispozita*⁶². Ky qëndrim është shprehur më qartë në rastin kur Gjykata Kushtetuese u investua për të bërë interpretimin përfundimtar të neneve 125/2 dhe 136/5 të Kushtetutës, në lidhje me kushtet e emërimit për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese konstaton se; *në kushtet kur në Kushtetutë, ose edhe në ligjet e tjera, elementet e mësipërme, të parashtruara nga kërkuesit, nuk gjejnë rregullim të hollësishëm, këto elemente nuk mund të plotësohen nëpërmjet vendimit interpretues të Gjykatës. Interpretimi ka për qëllim t'i japë normës kushtetuese kuptimin e drejtë të saj dhe nuk ka për qëllim plotësimin e boshllëqeve kushtetuese/ligjore, sepse përndryshe Gjykata do të vihej në pozicionin e gabuar të krijuesit të normës juridike*⁶³.

Për Gjykatën Kushtetuese, ndoshta kjo është edhe “vija e kuqe” që ndan veprimtarinë interpretuese nga funksioni i ligjvënësit pozitiv. Është e vërtetë se çdo veprimtari interpretuese, parimisht, shoqërohet edhe me një kuptim të ri (krijues), që i jepet një dispozite të caktuar, por kjo nuk mund të shkojë deri në pikën e krijimit të një norme të re me anë të veprimtarisë interpretuese. Nga kjo pikëpamje, Gjykata Kushtetuese ka ruajtur në mënyrë strikte pozicionin e saj kushtetues si një ligjvënës negativ, dhe ka respektuar kurdoherë diskrecionin e ligjvënësit aty ku norma mungon. Madje, sipas mendimit tim, ajo është mjaft e tërhequr, nëse do ta krahasonim me Gjykatat e tjera kushtetuese, të cilat kanë për objekt të kontrollit të tyre kushtetues edhe ometimet e ligjvënësit, pra që guxojnë të “normojnë” atë hapësirë ligjore që ligjvënësi ka ometuar ta

61 Bëhet fjalë në rastin kur në vendimin nr. 6/1992, Gjykata Kushtetuese ndryshoi vetë një paragraf të Ligjit nr.7575, dt.29.6.1992 “*Për ndryshimin e nenit 283 të Kodit Civil*”, shih; L.Omari, *Shteti i së drejtës*, Lilo, Tiranë, 2002, f. 271.

62 Vendimi nr.18/2003 i Gjykatës Kushtetuese.

63 Vendimi nr.24/2011 i Gjykatës Kushtetuese.

parashikojë. Kontrolli kushtetues i ometimeve legjislativ është zhvilluar progresivisht gjatë dekadave të fundit nga shumë gjykata kushtetuese të huaja, ky fenomen sipas doktrinës kushtetuese ka kontribuar në zhvillimin e tendencave të reja në drejtësinë kushtetuese, duke i shndërruar gjykatat kushtetuese në një lloj asistenti të ligjvënësit⁶⁴.

Gjithashtu, në shoqëritë postmoderne vihet re një aktivizëm i gjyqësorit, sidomos për t'i dhënë zgjidhje problemeve të përditshme që me kuadrin legjislativ në fuqi, nuk mund të zgjidhen, dhe ndërhyrja e gjykatave në zgjidhjen e problemit dhe gjetjes së një zgjidhjeje, ka bërë të mundur që përmes interpretimit gjyqësor të shkohet pothuajse në funksionin krijues të gjyqtarit, për t'i dhënë një zgjidhje problemit. Në këtë tendencë të përgjithshme të gjyqësorit në rrafshin ndërkombëtar, duket se Gjykata Kushtetuese shqiptare, është mjaft e tërhequr, duke ruajtur pozicionin Kelzenian të ligjvënësit negativ.

KONKLUZIONE

Gjatë këtij punimi evidentuam se si interpretimi kushtetues paraqet disa veçori kundrejt interpretimit ligjor në tërësi, për vetë natyrën e veçantë të aktit që interpretohet, por mbi të gjitha për nga mënyra e formulimit të dispozitave kushtetuese, të cilat janë, të përgjithshme, parimore, të cilat lejojnë një liri interpretimi më të gjerë se dispozitat ligjore.

Për të shpjeguar teknikat e interpretimit ligjor/kushtetues u bazuam tek teoritë e interpretimit që u zhvilluan nga shkolla të ndryshme juridike, si shkolla franceze, e cila themeloi teorinë e parë të interpretimit si teoria konjitive, ku gjyqtarit si interpretues i normës juridike, i njihej e drejta të zbatonte në mënyrë mekanike normën juridike, pa patur pothuajse asnjë liri interpretimi të saj, i vetmi interpretim që njihej ishte ai autentik që i përkiste ekskluzivisht ligjvënësit dhe se ligji kishte vetëm një kuptim.

Me teorinë e re hermeneutike kemi një inversion të pikës së nisjes së arsyetimit për të kryer interpretimin e dispozitës ligjore ose kushtetuese,

64 S.Berberi, *Ligjvënësi dhe kontrolli kushtetues*, botuar në Revistën “Avokatia” nr. 14/2015, f.3.

është rasti konkret, që interpretuesi duhet t'i japë zgjidhje, ndaj dhe interpretimi i normës bëhet në funksion të zgjidhjes së tij. Kjo teori shënon edhe kalimin nga “sistemi” tek “problemi” si pikë nisje për zgjidhjen e rastit konkret. Një ndër debatet që ballafaqohet konstitucionalizmi modern ka të bëjë mbi interpretimin e Kushtetutës sipas teorisë historike ose *original intent*, duke iu referuar punimeve kushtetuese, autorit të tekstit, apo sipas teorisë evolutive ose *living constitution*, e cila konsiston në faktin se Kushtetuta duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që t'i ofrojë mbrojtje edhe nevojave sociale, të cilat shfaqen me kohën e nuk ishin parashikuar në tekstin e saj në kohën e hartimit të Kushtetutës.

Interpretimi kushtetues ka marrë kohët e fundit edhe një karakter ndërkombëtar. Në veçanti interpretimi i bërë nga Gjykata Kushtetuese ndikohet më së shumti nga qëndrimet e gjykatave kushtetuese homologe të huaja, si dhe nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, kjo edhe në sajë të pozitës së privilegjuar që kanë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në rendin tonë kushtetues, sidomos vendi dhe roli i Gjykatës së Strasburgut dhe Konventës Evropiane.

Në mbyllje trajtuam interpretimin kushtetues të bërë nga Gjykata Kushtetuese, duke u mbështetur në jurisprudencën e saj. Sipas jurisprudencës konstante të saj, interpretimi kushtetues ka vend vetëm për një normë ekzistuese, përndryshe Gjykata Kushtetuese do të kthehej në një ligjvënës pozitiv.

Siç edhe e kemi evidentuar më lart, çdo veprimtari interpretative shoqërohet me krijimin e një kuptimi të ri për një dispozitë të dhënë, sepse vetë interpretuesi ka një funksion krijues, por kjo nuk do të thotë se interpretuesi është shndërruar në një ligjvënës pozitiv. Ajo që është e rëndësishme, për të gjetur kufijtë e veprimtarisë interpretuese, nuk lidhet se në ç'masë jemi larguar nga teksti i shkruar, por për të parë se si interpretimi i bërë është përdorur si një alternativë e ndryshimit të dispozitës kushtetuese apo jo. Kjo është në fakt, vija ndarëse mes veprimtarisë interpretuese dhe krijimit të një norme të re.

Sipas këtij qëndrimi, Gjykata Kushtetuese, paraqitet si një organ i kontrollit kushtetues mjaft i tërhequr, krahasuar me gjykatat e tjera kushtetuese. Ajo i qëndron strikt modelit Kelzenian të gjyqtarit kushtetues. Nuk duhet të harrojmë se në kuadrin ndërkombëtar vihet re një aktivizim

i gjyqtarëve sidomos i atyre kushtetues, të cilët të ndodhur shpesh herë përpara çështjeve dhe problemeve që i shtrohen për zgjidhje, sidomos ato me natyrë politike e morale, guxojnë të bëjnë një interpretim elastik të dispozitave kushtetuese e ligjore, ku pa ndërhyrjen e tyre shumë probleme nuk do të zgjidheshin nga legjislacioni ekzistues. Ky qëndrim, bëhet edhe më dukshëm, nëse kemi parasysh kontrollin kushtetues të ometimeve legjislative, ku pas Kushtetutës së vitit 1998, nuk është ushtruar prej saj. Ka gjykata kushtetuese, të cilat shtrijnë kontrollin kushtetues si në rastin kur ligjvënësi ka ometuar të parashikojë diçka, ashtu edhe në rastin kur ka parashikuar diçka që kushtetutshmërisht nuk duhej ta parashikonte, si p.sh Gjykata Kushtetuese italiane. Ndaj do të rekomandohej një rol më aktiv i saj, sidomos në kontekstin e shoqërive të sotme, ku nevojat sociale janë të pafundme dhe ligjvënësi e ka të pamundur t'i rregullojë ato në mënyrë shteruese me ligj.

BIBLIOGRAFIA

1. L.Omari, *Shteti i së drejtës*, Lilo, Tiranë, 2002.
2. A.Anastasi, *E Drejta kushtetuese e krahasuar*, Dajti, Tiranë, 2009.
3. S.Sadushi, *Drejtësia Kushtetuese në zhvillim*, Toena, Tiranë, 2012.
4. S.Sadushi, *Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në frymën e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut*, botuar te Revista, E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, n. 11/2003.
5. K.Traja, *Procesi i rregullt ligjor, aspekti substantiv*, botuar te Revista “Studime Juridike”, nr. 1/2005.
6. B. Dedja, *Gjykata Kushtetuese sipas sistemit juridik shqiptar*, mbajtur në Konferencën e organizuar më dt. 21-23 shtator 2011, në Karakas-Venezuelë, botuar në www.gjk.gov.al.
7. S.Berberi, *Ligjvënësi dhe kontrolli kushtetues*, botuar te Revista “Avokatia” nr. 14/2015.
8. R.Dworkin *Taking the rights seriously, Law’s Empire*, Harvard University Press, 1986.

9. R.Dworkin, *Freedom's Law. The Moral Reading of the American Constitution*, Oxford, Oxford University Press, 1996.
10. A.Barak, *The Judge in a Democracy*, Princeton University Press, 2006
11. P.Brest, *The Misconceived Quest for original understanding*, Boston University Law Review, 1980.
12. J.M.Balkin, *Framework originalism and the living constitution*, Northwestern University, School of law, University Law Review.
13. D.A.Strauss, *The living Constitution*, Oxford, Oxford University Press, 2010.
14. H.Mc.Bain, *The Living Constitution*, Columbia University Law School, 1927.
15. W.H.Rehnquist, *Harvard Journal of Law & Public Policy*, Vol.29.
16. L.Wittgenstein, *Philosophische Untersuchungen*, 1953.
17. Armin von Bogdandy, Christoph Grabenwarter, Peter M. Huber, *Il diritto costituzionale nel diritto pubblico europeo. L'esempio della rete istituzionalizzata della giustizia costituzionale*, botuar te Revista AIC, nr. 4/2015, publikuar në; www.aic.it.
18. A.Pizzorusso, *La produzione normativa nei tempi di globalizzazione*, botuar në faqen www.associazionedeicostituzionalisti.it.
19. S.Bartole, *La Costituzione è di tutti*, Il Mulino, Bologna, 2012.
20. G.Fontana, *Il referendum costituzionale nei processi di riforma della repubblica*, Editoriale Scientifica, Napoli, 2012.
21. G.Zagrebelsky, *La giustizia costituzionale*, Il Mulino, Bologna, 1988.
22. V.Zagrebelsky, *UE e il controllo esterno della protezione dei diritti e delle libertà fondamentali in Europa. La barriera elevata dalla Corte di Giustizia*, publikuar në www.sidi-isil.org.
23. F.Modugno, *Sulla specificità dell'interpretazione costituzionale*, Editoriale Scientifica, Napoli, 2008.
24. T.Guarnier, *Interpretazione costituzionale e diritto giurisprudenziale, specificità e problemi dell'interpretazione costituzionale nell'ordinamento integrato*, Editoriale Scientifica, Napoli, 2014.

25. L.G.Sciannella, *L'argomento dell'original intent nella giurisprudenza costituzionale in tema di forma di governo* botuar në, *Lavori preparatori ed original intent nella giurisprudenza della Corte costituzionale, Atti del seminario svoltosi a Catania il 5 ottobre 2007*, (a cura di) F.Giuffrè, I.Nicotra, Giappichelli, Torino, 2007.
26. F.Giuffrè, I.Nicotra, *Lavori preparatori ed original intent del legislatore Costituente nella giurisprudenza costituzionale*, botuar në, *Lavori preparatori ed original intent nella giurisprudenza della Corte costituzionale. Atti del seminario svoltosi a Catania il 5 ottobre 2007*, (a cura di) F.Giuffrè, I.Nicotra, Giappichelli, Torino, 2007.
27. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998).
28. Kodi Civil italian (1942)
29. Vendimi nr. 6/1992, i Gjykatës Kushtetuese.
30. Vendimi nr. 65/1999 i Gjykatës Kushtetuese.
31. Vendimi nr. 5/2001 i Gjykatës Kushtetuese.
32. Vendimi nr. 186/2002 i Gjykatës Kushtetuese.
33. Vendimi nr. 15/2003 i Gjykatës Kushtetuese.
34. Vendimi nr.18/2003 i Gjykatës Kushtetuese.
35. Vendimi nr. 3/2004 i Gjykatës Kushtetuese.
36. Vendimi nr.2/2005 i Gjykatës Kushtetuese.
37. Vendimi nr.24/2006 i Gjykatës Kushtetuese.
38. Vendimi nr. 29/2006 i Gjykatës Kushtetuese.
39. Vendimi nr.25/2008 i Gjykatës Kushtetuese.
40. Vendimi nr.25/2009 i Gjykatës Kushtetuese.
41. Vendimi nr.1/2011 i Gjykatës Kushtetuese.
42. Vendimi nr. 20/2011 i Gjykatës Kushtetuese.
43. Vendimi nr. 24/2011 i Gjykatës Kushtetuese.
44. Vendimi nr. 442011 i Gjykatës Kushtetuese.
45. Vendimi nr. 6/2012 i Gjykatës Kushtetuese.
46. Vendimi nr. 19/2015 i Gjykatës Kushtetuese.
47. Vendimin nr. 3011/2012 i Gjykatës së Apelit, Tiranë.
48. Vendimi nr. 113/2011 i Gjykatës Kushtetuese italiane.
49. Çështja *Folgero kundër Norvegjisë*, (2007) e Gjykatës së Strasburgut.
50. Çështja *Scordino kundër Italisë*, (2006) e Gjykatës së Strasburgut.

CËNIMI I PARIMIT *PACTA SUNT SERVANDA* NË KUADËR TË KONTRATËS SPORTIVE

(Rastet Matuzalem dhe Ariosa)

Dr. Saimir SHATKU & Ph.d.c.Erdi KUKA

Hyrje

Marrëdhëniet e punës në botën e sportit, ashtu edhe si në çdo industri tjetër bien në rregullimin e legjislacionit të punës të Shqipërisë, megjithë implikimet e veçantive që sporti mbart. Edhe pse marrëdhëniet e punës mes lojtarëve dhe klubeve në vendin tonë rregullohen në praktikë nga një kontratë standarte të parashikuar nga një rregullore e Federatës Shqiptare të Futbollit, kjo kontratë është e vlefshme nga pikëpamja juridike për sa kohë zbaton parimet themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe Kodi i Punës në veçanti. Në këtë fazë është e rëndësishme të trajtohet çështja e zgjidhjeve të njëanshme e të menjëhershme të kontratës, kryesisht për rastet kur kjo zgjidhje është pa shkak të ligjshëm apo të justifikuar. Kjo pasi në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkaqe të justifikuara si Kodi Punës ashtu edhe kontrata standarte e lojtarit e parashikuar nga rregulloret e përvitshme të FSHF-së, janë në sinkron me njëri tjetrin dhe i parashikojnë qartësisht momentet që mund të bëhen shkak për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës.

Ndërkohë, për sa i përket rastit të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratë, kontrata standarte nuk parashikon pasojat juridike që mund t'i vinë palëve si shkak i shkeljes së parimit *pacta sunt servanda*. Kështu që, në praktikën gjyqësore shqiptare Gjykata në një rast të tillë do t'i referohet drejtpërdrejtë dispozitave të Kodit të Punës, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në fjalë.¹ Kodi i Punës e rregullon këtë

1 Çela, K., E Drejtë e Punës, Botimet ILAR, Botimi XIII, Tiranë, 2015, fq.191.

çështje në nenet 155 (zgjidhja e menjëhershme nga punëdhënësi) dhe 156 (zgjidhja e menjëhershme nga punëmarrësi). Duke iu referuar nenit 155, në rastet kur punëdhënësi e zgjidh kontratën në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara, në pikën tre të këtij neni parashikohet se Gjykata vendos që punëdhënësi duhet të dëmshpërblejë punëmarrësin në një vlerë jo më shumë se paga e një viti pune.² Ndërsa, në rastin tjetër kur është punëmarrësi ai që zgjidh kontratën në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara, neni 156 në pikën një të tij parashikon se punëmarrësi duhet të përgjigjet financiarisht ndaj punëdhënësit në një vlerë jo më shumë se paga e një jave dhe duhet të përgjigjet edhe për dëmin shtesë që është diferenca midis dëmit dhe pagës së një jave.³

Deri këtu gjithçka duket e qartë, nëse punëdhënësi zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme, të menjëhershme e pa shkaqe të justifikuara ai do të detyrohet të dëmshpërblejë punëmarrësin me një pagë të një viti punë dhe në rastin e kundërt punëmarrësi ka detyrimin të e një jave rrogë ndaj punëdhënësit dhe dëmin e shkaktuar, që do të llogaritet rast past rasti dhe që do të përkojë me diferencën mes dëmit real dhe pagës së një jave. Problemi, lind në rastet kur mosmarrëveshjet e kësaj natyre mes sportistëve dhe klubeve përfundojnë para komisionit disiplinor të FIFA-s apo Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, të cilat si objekt parësor të veprimtarisë së tyre kanë botën e sportit dhe jo posaçërisht mosmarrëveshjet që lindin në marrëdhëniet juridike mes personave.

Kështu, në kuadër të kësaj pike më poshtë do të trajtohen dy raste të sjella para GjAS-it, njëri kur punëmarrësi zgjidh pa shkaqe të justifikuara kontratën dhe tjetri kur është punëdhënësi ai që e zgjidh kontratën në po të njëjtat kushte. Ajo që vihet re është se në rastin e parë, kur është punëmarrësi ai që shkel detyrimet e kontratës, këto organe juridike mbi gjithçka vendosin parimin *pacta sunt servanda* dhe dënimet për punëmarrësit janë mjaft të ashpra, aq sa shpesh ata e kanë të pamundur t'i përgjigjen shifrave të tilla. Ndërsa në rastin tjetër, kur është punëdhënësi shkelës dhe punëmarrësi palë e dëmtuar, këto organe referojnë tek normat

2 LIGJ Nr.7961, datë 12.7.1995 (i përditësuar), *Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Dhjetor 2014, neni 155 (3).

3 Ibid. neni 156 (1).

kombëtare përkatëse për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve që lindin në kuadër të marrëdhënies së punës, duke dhënë vendime të arsyeshme dhe proporcionale. Rastet që do të trajtojmë më poshtë i shprehin më së miri këto vërejtje. Rasti i parë është FIFA v. Matuzalem, një futbollist shtetas italian, i cili prish kontratën me klubin ukrainas të Shaktior Donieckut (Shakhtar Donetsk) dhe rasti tjetër pra Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, një futbollist nga Paraguai i quajtur Sebastian Ariosa kundër klubit të tij Club Olimpia si palë e paditur.

FIFA kundër Matuzalem.⁴

Kjo çështje ka veç përmbajtjes së saj dhe relevancës ndaj momentit të prishjes së njëanshme të kontratës ka një rëndësi historike, pasi është hera e parë që një vendim i Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv rrëzohet nga Tribunali Federal i Zvicrës me arsyetimin se shkel “parime themelore të së drejtës“, të ashtuquajturën “thelbin e rendit publik“. Kjo është dhe hera e parë që një vendim i GjAS-it është rrëzuar mbi bazë të ligjit material dhe jo procedural.

Faktet e çështjes

Kjo çështje ka të bëjë me një futbollist me origjinë braziliane, por shtetas italian i quajtur Francelino Matuzalem da Silva (“Matuzalem“), i cili ka luajtur me një sërë klubesh të njohura evropiane si Lazio, Real Zaragoza, Shakhtar Donetsk etj. Në qershor të 2004 ai hyri në një marrëdhënie punësimi me klubin ukrainas FC Shakhtar Donetsk. Ishte një kontratë me afat të përcaktuar prej 5 vitesh, e cila hyri në fuqi në 1 korrik 2004 deri më 1 korrik 2009. Në 2 korrik të 2007 (dmth një ditë pasi mbaroi periudha e mbrojtur), Matuzalem zgjidhi në mënyrë njëanshme e të menjëhershme kontratën për të luajtur për klubin spanjoll Real Zaragoza SAD. Nuk ka dyshim që ai në mënyrë të njëanshme dhe të parakohshme zgjidhi kontratën e punës pa një shkak të justifikuar.

Shaktiori (Shakhtar) nisi procedurat pranë Dhomës së FIFA-s për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve (“FIFA DZM“), e cila vendosi që Shaktiori

4 Vendim i Tribunalit Federal të Zvicrës, 4A_558/2011 i 27 marsit 2012.

të dëshmëpërblehej në masën 6.8 milion Euro.⁵ Ky vendim u apelua përpara GjAS-it nga të dyja palët. Në 19 maj 2009, GjAS mori vendimin ku Matuzalem urdhërohej t'i paguante Shaktiorit 11 858 934 Euro plus 5% interesa të mbledhura që nga 5 korriku i 2007-s.⁶ Matuzalem dhe Real Zaragoza u konsideruan si bashkarisht dhe individualisht përgjegjës për shumën në fjalë. Ky vendim i GjAS-it u bë i njohur si “çështja Matuzalem” dhe shumë komente janë bërë për të, pasi ishte hera e parë që GjAS, kur përllogariti kërkesën për dëmet, mori në konsideratë jo vetëm vlerën e mbetur të pagave në kontratë (siç ishte zbatuar edhe në çështjen Webster⁷), por gjithashtu edhe humbja e përfitimit nga vlera e Matuzalemit, psh të ardhura që mund t'i vinin klubit nga lojtari si mundësitë për transferimin e kartonit të tij etj. Shumë komentues pretenduan që GjAS e përdori Matuzalemin për ta bërë shembull në botën e futbollit që kontrata duhet respektuar. Kolegji gjyqësor i GjAS-it arsyetoi se qëllimi i nenit 17 të Rregulloreve të FIFA-s mbi Statusin dhe Transferimet e Lojtarëve (që trajton pasojat e zgjidhjes së kontratës pa shkak të ligjshëm) është:

“[...]parimisht nuk ka gjë tjetër për të siguruar stabilitetin kontraktual, dmth për të shtrënguar parimin pacta sunt servanda në botën e futbollit ndërkombëtar, duke vepruar si një parandalues ndaj prishjeve e përfundimeve të njëanshme të kontratës, qofshin shkelje nga klubi apo lojtari[...]”⁸

Kolegji më tej deklaroi se:

“Efekti parandalues i Nenit 17 të Rregullores së FIFA-s duhet të arrihet përmes rrezikut të pashmangshëm për një palë që të pësojë sanksione disiplinore, nëse përmbushen disa kushte dhe, në çdo rast, rreziku për të paguar një kompensim për dëmet të shkaktuara nga prishja apo zgjidhja e pajustificuar. Me fjalë të tjera, si lojtarët dhe klubet paralajmërohen: nëse

5 Vendim i Dhomës së Zgjidhjeve të Mosmarrëveshje të FIFA, i datës 2 nëntor 2007.

6 GjAS 2008/A/1519-1520.

7 GjAS 2007/A/1298; 2007/A/1300.

8 GjAS 2008/A/1519-1520, paragrafi nr. 80.

dikush prish apo përfundon kontratën pa një shkak të ligjshëm, do të ketë një kompensim financiar, dhe ky kompensim do të llogaritet në përputhje me të gjitha ato elemente të nenit 17 të Rregulloreve të FIFA-s që janë të zbatueshme për çështjen në fjalë, përfshirë të gjithë kriteret jo-ekskluzivë të listuar në paragrafin 1 të nenit të mësipërm, bazuar në rrethanat e posaçme të çdo çështje, që Kolegji do ta konsiderojë të përshtatshme për ta zbatuar.⁹ Tribunali Federal i Zvicrës e la në fuqi këtë vendim në 2010.¹⁰

Meqënëse as Real Zaragoza e as Matuzalemi e kishin të pamundur të paguanin shumën e rreth 12 milion Eurove, Komiteti Disiplinor i FIFA-s i njoftoi ata më 14 korrik të 2010 se (i) ndaj tyre do të niste një procedim disiplinor dhe se (ii) do të zbatoheshin sanksionet përkatëse në përputhje me nenin 64 të Kodit Disiplinor të FIFA-s. Më 31 gusht të 2010 Komiteti Disiplinor i FIFA-s vendosi që:

‘[...]

3. *Lojtari Matuzalem Francelino da Silva dhe klubi Real Zaragoza SAD i jepet një afat përfundimtar tolerimi prej 90 ditësh nga data e njoftimit të këtij vendimi për t'i shlyer debinë e tyre kreditorit.*

4. *Nëse brenda këtij afati debia nuk është paguar, kreditori mund të kërkojë me shkrim nga FIFA që një përjashtim nga pjesëmarrja në çdo veprimtari futbollistike të sanksionohet për lojtarin Matuzalem Francelino da Silva dhe/ose ekipit të parë të klubit Real Zaragoza SAD t'i zbriten (6) pikë në ligën kombëtare që ai garon. Sapo kreditori të ketë paraqitur këtë apo këto kërkesa, lojtari Matuzalem Francelino da Silva do të sanksionohet me përjashtim nga pjesëmarrja në çdo veprimtari futbollistike dhe/ose ekipit të parë të klubit Real Zaragoza SAD t'i zbriten automatikisht (6) pikë në ligën kombëtare që ai garon pa nevojën që të merret një vendim tjetër nga Komiteti Disiplinor i FIFA-s. [...] ky përjashtim do të qendrojë në fuqi derisa e gjithë shuma e papaguar të shlyhet plotësisht [...]*

9 GjAS 2008/A/1519-1520, paragrafi nr. 82.

10 Vendim i Tribunalit Federal të Zvicrës, 4A_320/2009 i 2 qershorit 2010.

Më 1 shtator 2010, Zaragoza i transferoi 500 000 Euro Shaktiorit. Pagesa të mëtejshme nuk u bënë as nga Matuzalemi e as nga Zaragoza. Si Zaragoza ashtu edhe Matuzalemi apeluan vendimin para GjAS. Më 29 qershor 2011, GjAS i njoftoi palët se i ka rrëzuar të dy apelimet dhe miratoi vendimin e Komitetit Disiplinor të FIFA-s.¹¹ Matuzalemi e apeloj këtë vendim të GjAS-it para Tribunalit Federal të Zvicrës. Në vendimin historik të përmendur edhe në fillim të shtjellimit të kësaj çështjeje të mbajtur më 27 mars 2012, Tribunali Federal i Zvicrës e rrëzoi vendimin e GjAS-it, duke arsyetuar se dhunon parime themelore të së drejtës (rendi publik). Kjo është hera e parë që Tribunali Federal i Zvicrës ka rrëzuar një vendim të GjAS-it bazuar në thelbin e rendit publik dhe jo thjesht mbi gabime procedurale.

Tribinali Federal e përmbledh arsyetimin e tij si më poshtë:

*“Kërcënimi i një përjashtimi të pakufishëm profesional bazuar në nenin 64 (4) të Kodit Disiplinor të FIFA-s përbën një kufizim të dukshëm dhe të rëndë të të drejtave private të lojtarit dhe shpërfill kufijtë themelore të zotimeve ligjore siç parashikohet në nenin 27 (2) të Kodit Civil (zvicëran). Nëse do të dështonte shlyerja e detyrimit, vendimi nën apel do të çonte jo vetëm në atë që lojtari do të ishte subjekt i arbitraritetit të punëdhënësit të mëparshëm të tij, por gjithashtu në kufizimin e lirisë së tij ekonomike më të tillë ashpërsi që bazat e ekzistencës së tij ekonomike rrezikohen pa asnjë justifikim të mundshëm nga ndonjë interes mbizotërues të FIFA-s apo anëtarëve të saj. Në vështrim të ndëshkimit që përfshin, vendimi i GjAS-it i 29 qershorit 2011 përmban një dhunim të dukshëm dhe të rëndë të privatësisë dhe është në kundërshtim me rendin publik“.*¹²

Shohim pra, që në këtë rast Komiteti Disiplinor i FIFA-s ashtu edhe GjAS në mbështetje të vendimit të këtij Komiteti, nuk kanë mbajtur qendrim të pastër juridik ndaj çështjes në fjalë, duke vendosur para parimeve themelore të së drejtës, respektimit të të drejtave dhe lirive

11 GjAS 2010/A/2261 Real Zaragoza SAD v/ FIFA dhe GjAS 2010/A/2263 Matuzalem Francellino da Silva v/ FIFA.

12 Vendim i Tribunali Federal të Zvicrës 4A_558/2011 në pikën 4.3.5.

themelore të njeriut, interesat politikë të FIFA-s, ku vendimi më shumë sesa synonte të zgjidhte në mënyrë të drejtë mosmarrëveshjen kishte për qëllim të bënte një shembull për të parandaluar përsëritjen e rasteve të tjera në të ardhmen. Ishte vetëm Tribunali Federal i Zvicrës, që në rastin konkret kishte rol të pastër kushtetues, ai i cili përmes lupës kushtetuese arriti të determinojë se interesi i individit në këtë rast, respektimi i një të drejte themelore të tij që përkon me klauzolën e rendit publik, prevalojnë mbi interesat politike të FIFA-s për të shtrirë influencën e saj edhe në çështje të ndjeshme si marrëdhënia kontraktore e punës mes lojtarit punëmarrës dhe klubit punëdhënës.

Analizë e vendimeve të GjAS në çështjet Ariosa kundër Club Olimpia¹³ dhe Club Olimpia kundër Ariosa¹⁴.

Një paraqitje e shkurtër e fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen:

Sebastian Ariosa është një lojtar uruguajan që kishte lidhur një kontratë pune me Club Olimpia, të Paraguajit, për periudhën 17.01.2011 në 31.12.2015. Në maj të vitit 2013 ky lojtar u diagnostikua me kancer, dhe klubi e lejoi të kthehet në vendin e tij për të ndjekur trajtimin adekuat. Në qershor të vitit 2013 palët lidhën një marrëveshje, ku klubi njihte se i kishte 121,000 USD (tetë muaj paga). Në dhjetor të vitit 2013, ndërsa lojtari iu nënshtrua trajtimeve me kimioterapi, klubi e pezulloi kontratën, gjoja se lojtari nuk ishte në gjendje të kryente detyrimin e tij për të luajtur. Pas korrespondencës mes dy palëve lojtari e refuzoi këtë pozicion dhe ndërpreu kontratën në 08.01.2013. Pesë ditë më vonë klubi refuzoi ndërprerjen dhe kërkoi praninë e lojtarit në klub në mënyrë që të rifillonte stërvitjen. Gjithashtu e informoi lojtarin se dy paga mujore janë depozituar me Federatën e Paraguait, ku kërkohet lëshimi i një fature nga lojtari, të cilin lojtari nuk ishte në gjendje të bënte, pasi ishte punonjës dhe jo kompani. Në shkurt të vitit 2014, lojtari paraqiti një kërkesë para Dhomës së Zgjidhjeve të Mosmarrëveshjeve të FIFA-s (këtej e tutje DZM e FIFA-s). Në përgjithësi, ajo që sjell ky vendim, përveç rregullimeve përkatëse, është një sens i përbashkët: diçka shumë e thjeshtë, por shumë

13 TAS 2015/A/3871 Ariosa c. Club Olimpia.

14 TAS 2015/A/3882 Club Olimpia c. Ariosa.

e rëndësishme dhe në dukje e pamjaftueshme në shumë raste.

Shkelja e përsëritur e kontratës nga klubi në këtë rast ishte shumë e qartë edhe më parë se lojtari të sëmurej bazuar në dhënien e vonuar të pagave për shumë muaj dhe mungesa e dispozitave mbi sigurimet shoqërore apo sigurime të tjera. Pezullimi i mëvonshëm i kontratës nga klubi për shkak se lojtari do t'i nënshtrohej kimioterapisë për të trajtuar kancerin e tij ishte shkelja përfundimtare dhe flagrante e kësaj çështjeje.

Pra, në 20.08.2014, pasi lojtari paraqiti një kërkesë padi kundër klubit, DZM e FIFA-s vendosi në favor të lojtarit, duke pranuar se klubi kishte shkelur kontratën pa arsye të ligjshme, duke i dhënë lojtarit të drejtën për pagesën jo vetëm të pagave të prapambetura, por edhe të kompensimit për vlerën e mbetur të kontratës, plus një interes 5%. DZM-ja kuptoi se rregulloret e FIFA-s duhej të mbizotërojnë mbi çdo rregullore kombëtare të rënë dakord nga palët, në mënyrë që të kemi një grup standard rregullash.

DZM-ja theksoi se një sëmundje nuk është shkak i ligjshëm për të ndaluar pagimin e pagave për lojtarin apo edhe më keq, për zgjidhjen e kontratës ose pezullimin e efekteve të saj. DZM-ja deklaroi se është përgjegjësia e klubit për të siguruar se lojtari vazhdon të marrë pagën e tij, e cila gjithashtu mund të merret përmes sigurimit.

Megjithatë, DZM-ja hodhi poshtë pretendimet për dëm moral, për specifikat e sportit dhe për shpenzimet mjekësore, duke theksuar se këto nuk janë provuar sa duhet. Gjithashtu hodhi poshtë bonusin e pjesëmarrjes në Kupën e Libertadores 2013, pasi që lojtari nuk kishte marrë pjesë në asnjë nga ndeshjet e kësaj kupe, dhe kërkesën e pagimit të muajit të trembëdhjetë, duke deklaruar se nuk kishte bazë kontraktuale. Arsyet e vendimit iu njoftuan të dyja palëve në 16.12.2014, dhe të dyja palët e apelian.

Klubi kërkoi, ndër të tjera, që vendimi i DZM-së të rrëzohet; të refuzohet kërkesa e lojtarit si jo në përputhje me ligjin e Paraguit dhe kompensimi të fiksohet në një vlerë jo më shumë se 42.500 USD, bazuar në nenin 25 të ligjit 88/91, me zbritjes e shumës së harxhuar nga Olimpia për të zëvendësuar lojtarin. Lojtari, nga ana tjetër, kërkoi ndër të tjera, që vendimi të rrëzohet pjesërisht për pjesët jo të pranuar, dhe kërkoi sërish dëmshpërblim moral, dëmshpërblim për specifikat e sportit,

muajin e trembëdhjetë për të gjithë kontratën dhe bonuset për Kupën e Libertadores të 2013.

Gjetjet e GjAS-it

Ligji i zbatueshëm:

Kolegji GjAS-it përcaktoi një tërësi ligjesh të zbatueshme, duke ndjekur hierarkinë e treguar nga neni R 58 i Kodit të GjAS: të parat rregulloret e FIFA-s, dhe si alternativë ligjin zviceran.

Meqë ligji zviceran njeht lirinë kontraktuale, ligji i zgjedhur nga palët mund të merret parasysh. Në këtë rast, palët zgjodhën ligjin Paraguaiian, dhe për aq kohë sa nuk është në kundërshtim me ligjin e detyrueshëm zviceran, kjo duhet të zbatohet.

1. Rregulloret e FIFA mbi të drejtën kombëtare

Olimpia kërkoi uljen e kompensimit të dhënë për vlerën e mbetur të kontratës, vetëm në shpërblimin e mbetur për vitin që përfundoi. Sipas ligjit Paraguaiian kërkesa e klubit nënkupton se lojtari do të marrë dy muaj e gjysmë pagë, në krahasim me dy vjet të plota. Kolegji analizoi se ligji Paraguaiian parashikon një kompensim të vlerës së mbetur të kontratës për vitin korrent, ndërsa neni 17 i Rregullores për Statusin dhe Transferimet e Lojtarëve (RSTL) e FIFA-s i referohet një kompensim për vlerën e pjesës së mbetur të kontratës. Meqë në fillim duhet të zbatohen rregulloret FIFA-s, në kuadër të hierarkisë së përshkruar në nenin R58 të Kodit, duhet të jepet kompensimi në vlerën e pjesës së mbetur të kontratës. Kjo konfirmoi vendimin e DZM-së.

2. Shpenzimet për zëvendësimin e lojtarit nuk mund të zbriten.

Olimpia kërkoi zbritjen e shumës së shpenzuar me zëvendësimin e lojtarit: 240000 USD që iu desh të paguante për zëvendësimin e lojtarit. Kolegji vërejtë se kjo kërkesë nuk ka asnjë bazë ligjore, ajo qendron vetëm në përshkrimin e një kostoje që Olimpia paraqiti. Kërkesa nuk ka mbështetje ligjore, dhe për këtë arsye ajo u refuzua. Ky është një aspekt shumë i rëndësishëm: nuk ka asnjë përgjegjësi lojtari për „nevojën“ e Olimpia-s për të kontraktuar një lojtar tjetër, kështu që nuk mund të jetë barrë e lojtarit.

3. Kompensimet e dhëna nga ligji i detyrueshëm kombëtar zbatohen, edhe në qoftë se nuk janë përfshirë në kontratë.

E drejta për pagën e trembëdhjetë është e parashikuar në ligjin e Paraguait dhe është detyrim ligjor. Neni 17 i RSTL e FIFA-s thekson se një nga kriteret që merren parasysh për të përcaktuar shumën e kompensimit është ligji kombëtar.

DZM-ja e mohoi këtë të drejtë, pasi ajo nuk ishte rënë dakord në kontratë. Megjithatë, GjAS kuptoi se, siç u shpjegua më lart, ligji i zbatueshëm për këtë kontratë është i shumëfishtë, duke përfshirë edhe të drejtën kombëtare. Për më tepër, vetë kontrata përcakton ligjin 88/91 si ligjin e zbatueshëm. Pra, për të vendosur nëse paga e trembëdhjetë duhet të jepet, Kolegji analizoi nëse ligji kombëtar është i detyrueshëm apo jo dhe nëse kishte ndonjë pjesë të kontratës që tregon qëllimin e palëve për të përfshirë pagën e trembëdhjetë brenda shpërblimit të rënë dakord.

Kolegji konkludoi se nëse nuk ka një marrëveshje që shpreh të kundërtën, të drejtat që rrjedhin nga ligji vendor dhe kontrata janë kumulative, jo përjashtuese. Për më tepër, kjo e drejtë buron nga legjislacioni i detyrueshëm i punës, dhe nuk është e nevojshme të përfshihet ose të destinohet për t'ë përfshirë në setin e shpërblimit të kontratës. Duke marrë parasysh gjithë këtë, muaji i trembëdhjetë është dhënë për të gjithë periudhën e kontratës, pasi që ajo kurrë nuk është paguar.

Lojtari është një punëtor, kështu që ligji i detyrueshëm i punës duhet të zbatohet për të siç zbatohet edhe për çdo punëtor tjetër. Ligji dhe kontrata duhet të shihen si kumulative në një interpretim *indubio pro operario*. *Pse ligji kombëtar zbatohet këtu dhe jo në kërkesën e Olimpia-s për një kompensim të reduktuar sipas të njëjtit ligj? Sepse FIFA nuk e rregullon pagën e muajit të trembëdhjetë, ndërkohë që e rregullon kompensimin në rast shkelje të kontratës.*

4. Përmbajtja e klauzolës është thelbësore për të gjykuar nëse ka vend për bonuse.

Kolegji theksoi se kushti i përcaktuar në kontratë për pagesën shpërblimeve shtesë (bonuset), ishte që kontrata të jetë ende në fuqi, dhe jo, siç DZM-ja gabimisht e konsideroi, pjesëmarrja e lojtarit në ndeshje.

Prandaj, meqë kontrata ende nuk ishte ndërprerë kur ekipi mori pjesë në Kupën e Libertadores të vitit 2013, dhe edhe pse lojtari nuk ka marrë pjesë në asnjë nga ato ndeshje, kishte vend për bonuset.

5. Dëmet morale: sjellje të jashtëzakonshme dhe të rënda.

Kolegji së pari analizoi se edhe pse dëmi moral nuk rregullohet nga RSTL e FIFA-s, ligji zviceran dhe i Paraguait e rregullojnë atë, dhe ata janë të zbatueshëm për shkak të marrëveshjes së palëve dhe nenit R58 të Kodit të GjAS-it, siç është sqaruar më lart.

Kolegji arsyetoi në lidhje me natyrën e këtij dëmi, se e drejta për të marrë një kompensim për dëm moral, nuk ka natyrë ndëshkuese, por kompensuese: është pjesë e detyrimit për të riparuar dëmin e shkaktuar. Megjithatë, Kolegji alarmon rrezikun e abuzimit me këtë mundësi, dhe prandaj ai thekson se duhet të jetë e qartë se sjellja e klubit ishte edhe e jashtëzakonshme (se tejkaloi atë që shoqëria duhet ta ketë) dhe e rëndë (që një person i arsyeshëm e konsideron këtë të pabesueshme).

Dëmi moral u kuptua në këtë rast si ankth dhe pasiguri të shkaktuar nga Olimpia tek lojtari. Kolegji theksoi se është në rregull që të kërkohen prova për të provuar dëmin, por ngaqë ky është një dëm i brendshëm, është e njohur se demonstrimi i tij është më i vështirë. Kolegji theksoi mprehtësisht: „Të kërkosh prova materiale në një dëm jo material, me të vërtetë që mund të jesh duke kërkuar të pamundurën“, atë që njihet si *probatio diabolica*. Prandaj, vendimmarrësi ka mundësinë e një gjykimi të duhur. Që është, mundësia për të shqyrtuar rrethanat dhe për të përcaktuar nëse është e vlefshme dhe e mundshme për të konkluduar nëse është shkaktuar dëm moral. Dëmi moral duhet të nxirret natyrshëm.

Kolegji kuptoi se një vendim që nuk i kushton asgjë personit që kryen aktin e paligjshëm mund të shtojë dëmin e shkeljes. Kjo, jo vetëm duke e lënë të dëmtuarin në të njëjtën situatë që do të kishte pasur në qoftë se padia e tij nuk do të ishte pranuar, por edhe më keq, duke pranuar se ekziston një akt i paligjshëm kundër tij, dhe ligji nuk bën asgjë në lidhje me këtë. Sjellja e Olimpia-s ishte e jashtëzakonshme dhe e rëndë për shkak të kontekstit dhe efekteve të saj.

Siç u përmend më parë, ky vendim është shkruar me sens të përbashkët dhe është njerëzor. Si rezultat, kështu i përshkroi Kolegji

kontekstin dhe efektet: „*Duke qenë se patologjia e lojtarit është shpesh vdekjeprurëse, nuk është e ekzagjeruar të thuhet se lojtari po jetonte sfidën më të madhe të jetës së tij. Për shkak të natyrës dhe seriozitetit të patologjisë, Tribunali nuk ka dyshim të supozojë se lojtari ishte në një gjendje brishtësie. Energjia dhe qëllimi i lojtar duhej të ishte tërësisht i përqëndruar në luftimin e sëmundjes së tij. Lufta për jetën e tij. Në këtë kontekst, Kolegji konsideron të vlefshme të supozojë se ajo çfarë Olimpia bëri, jo vetëm e shpërqëndroi, por veproi edhe si një shtresë ankthi shtesë mbi supet e lojtarit që do të kishte qenë e preferueshme të shmangej. Ky ankth shtesë i atribuohet tërësisht Olimpia-s, pasi është një ankth në sipër atij të nxitur nga vetë patologjia.*

Efektet - ankth dhe pasiguri - u përshkruan nga tre dëshmitarë: gruaja e lojtarit, një mik dhe mjeku i tij onkolog. Kolegji pranoi se dëshmitë e dy të parëve mund të jenë të njëanshëm. Megjithatë, ai gjithashtu konsideroi se vetëm rrethi intim i lojtarit mund të dinte se si ndihesh ai. Pra, edhe pse pesha e kësaj dëshmie u konsiderua e ndërmjetme, ajo ishte ende e rëndësishme. Vlera e dëshmisë së onkologut ishte natyrisht më e lartë, pasi ai mund të përshkruajë, si një profesionist, efektin e humorit të lojtarit në trajtim, pasi dëgjoi se Olimpia kishte pushuar kontratën e tij. Kolegji e përmblodhi sjelljen e Olimpias si shkelje e pothuajse të gjitha detyrimeve të saj. Për më tepër, kjo u përsërit pasi nuk iu përmbajt para dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes së dytë. Dhe me shumë rëndësi për t'u përmendur, është që klubi veproi në keqbesim të hapur.

Ka dy akte shumë të qarta keqbesimi që theksohen nga Kolegji: depozitimi nga Olimpia i një sasive të caktuar që i detyrohej lojtarit në Federatë, në vend që ta depozitonte këtë shumë siç kishte bërë me pagesat e tjera në vitet e shkuara të kontratës, dhe duke kërkuar që lojtari të dërgonte një faturë, gjë që ishte e pamundur për lojtarin pasi ai ishte punonjës dhe nuk kishte faturë. Në krye të kësaj, lojtari ishte në mes të trajtimit në Uruguaj dhe nuk ishte në gjendje të shkonte në Federatën e Paraguait për ta zgjidhur këtë çështje.

Akti tjetër i qartë i keqbesimit ishte njoftimi i paracaktuar që iu dërgua lojtarit, ku i kërkohej lojtarit të kthehej në trajnim pasi ky i fundit kishte ndërprerë kontratën. Kjo kërkesë u bë në kohën kur lojtari po luftonte për jetën e tij, duke përjetuar kimioterapinë në Uruguaj. Kolegji konsideron

se veçanërisht këto dy veprime të klubit ishin të destinuara të hidhëronin lojtarin, të përkeqësonin gjendjen emocionale të tij. Është e përcaktuar qartë që klubi Olimpia nuk është përgjegjës për gjendjen e lojtarit, kështu që problemi nuk është që në origjinë, por në reagimin e klubit. Problemi është se si Olimpia reagoi ndaj sëmundjes së lojtarit; ndalimi i pagesave, pezullimi në mënyrë të njëanshme i kontratës dhe vënia e lojtarit në mungesë që kthehej në stërvitje në mes të trajtimit mjeksor të tij. Kjo është e jashtëzakonshme dhe e rëndë, dhe gjithashtu e paligjshme. „Një person me një sëmundje vdekjeprurëse është i brishtë, nuk është vetëm një çështje mirësjellje, por edhe humanizëm për t’i trajtuar ata me respekt dhe privilegj“.

Është konsideruar se një sanksion që nuk perceptohet nga personi që ka kryer aktin e paligjshëm mund të shtojë dëmin e veprës, jo vetëm duke e lënë personin në të njëjtën situatë që ai / ajo ishte para kryerjes së veprës së paligjshme, por më keq, duke njohur se edhe pse ka një akt të paligjëm, ligji nuk bën dot asgjë në lidhur me këtë. Duke krijuar kështu rëndësinë e dhënies së dëmshpërblimeve të tilla.

Vëmë re që, qendrimi i GjAS në këtë rast ka qenë konform të gjitha kërkesave për respektimin e te drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke respektuar dhe legjisacionin kombëtar të punës, lidhur me dhënien e pagës së trembëdhjetë edhe pse kontrata nuk e parashikonte. Në këtë rast GjAS-i, e ka vënë theksin plotësisht tek mbrojtja e lirive dhe të drejtave të palës më të brishtë të kontratës, punëmarrësit. Ky vendim mund të konsiderohet si sukses, në kuadër të veprimtarisë për mbrojtjen e të drejtave themelore të lojtarëve si punëmarrës.

Përfundime

Aktorët politikë dhe ligjorë ndërkombëtarë të sportit, kanë bërë të mundur që të shkohet drejt standartizimit të procedurave, marrëdhënieve dhe natyrshëm edhe të Kontratave Sportive. Kësisoj, marrim shembull Kontratën Sportive në futboll, ku veç të tjerash, janë të shprehura edhe kërkesat minimale të vendosura në marrëveshjen e UEFA-s dhe organizmave të tjera të futbollit europian të përmendur më lart (Marrëveshja mbi standartet minimale).

Kuptohet që qëllimi i këtyre organizatave (FIFA, UEFA, UNESCO) është që të shtrijnë sa më shumë tentakulat e tyre të influencës edhe për pushtet juridik, veç atij ekonomik dhe politik që kanë në botën e sportit. Dhe ndërhyrja edhe në këtë çështje e shpreh më së miri manifestimin në praktikë të këtij synimi. Megjithë veçoritë që sporti ka si industri, natyrën e veçantë të kësaj industrie, marrëdhëniet e punës që krijohen mes sportistit dhe klubit që ai ka zgjedhur t'i përkasë, nuk janë çështje që i përkasin sportit, po çështje që më shumë lidhen me ekzigjencat shoqërore për rregull, nevojën e shoqërisë që të rregullojë marrëdhënie të caktuara ekonomiko-shoqërore, mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut (ndalimi i punës së detyruar, ndalimi i diskriminimit, e drejta për të fituar jetesën në mënyrë të ligjshme, liria e lëvizjes etj).

Në lidhje me pasqyrimin në praktikë të Kontratës së Punës Sportive, vëmë re që si në evropë ashtu edhe SHBA na rezulton se po shkohet drejt një standartizimi global, duke patur parasysh që rregullimet juridike të marrëdhënies së punës sportive janë në një masë të gjerë të mgjashme nga shteti në shtet. Gjithashtu, roli specifik dhe synimi i Organizatave Ndërkombëtare të sportit, ndër të tjera, është pikërisht vendosja e standarteve në nivel global.

Bibliografia

- Çela, K., *E Drejtë e Punës*, Botimet ILAR, Botimi XIII, Tiranë, 2015
- LIGJ Nr.7961, datë 12.7.1995 (i përditësuar), Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Dhjetor 2014, neni 155 (3).
- Vendim i Tribunalit Federal të Zvicrës, 4A_558/2011 i 27 marsit 2012
- Vendim i Dhomës së Zgjidhjeve të Mosmarrëveshje të FIFA, i datës 2 nëntor 2007
- GjAS 2008/A/1519-1520
- GjAS 2007/A/1298; 2007/A/1300
- Vendim i Tribunalit Federal të Zvicrës, 4A_320/2009 i 2 qershorit 2010

- GjAS 2010/A/2261 Real Zaragoza SAD v/ FIFA
- GjAS 2010/A/2263 Matuzalem Francelino da Silva v/ FIFA
- Vendim i Tribunali Federal të Zvicrës 4A-558/2011 në pikën 4.3.5.
- TAS 2015/A/3871 Ariosa c. Club Olimpia
- TAS 2015/A/3882 Club Olimpia c. Ariosa
- Academic Journal of Interdisciplinary Studies, vol.3, no.1, March 2014, Rome, Italy, ISSN 2281-3993(print); ISSN 2281-4612 (online); pg.359;
- 14-International sport sciences congress, 01-04 november 2016, Belek, Antalya, Turkey; 1084/International Legal Documents Regarding Sports Contract; pg.81;
- Shatku S., Universality of Human Rights in the labour World, pg.145; Konferenca e IV-të shkencore ndërkombëtare “Sistemi i Drejtësisë në Udhëkryqin e Transformimit”; Tiranë më, 04 maj 2016;

INTEGRITETI DHE ROLI I TIJ NË PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Msc. Marbona CUKA

Hyrje

Integriteti përbëhet nga sjellje dhe veprimenë përputhje me një tërësi parimesh dhe standardesh morale etike, të cilat në rast se respektohen nga individët, organizatat, institucionet dhe qeveria bëhen pengesë përkorrupsionin¹.

Integritetinëkuptonndershmëri,kërkim të së vërtetës, besueshmëri, vërtetësidheqëndrueshmëri të vazhdueshme².

Sfidat e rëndësishme si: forcimi i demokracisë, zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm, krijimi i vendeve të reja të punës etj, kërkojnë që zyrtarët publikë të mendojnë në mënyrë të zgjuar.

Problemet që hasin qeveritë, kompanitë dhe qytetarët kërkojnë profesionistë të përkushtuar. Të punosh për të mirën publike ofron prestigj, respekt dhe mundësi për rritje personale, por në këmbim, shoqëria kërkon efektivitet, efikasitet, efçencë dhe përpikmëri³. Përtej të gjithave, puna është subjekt i gabimeve njerëzore. Problemi nuk qëndron në teori, tek Kushtetuta apo legjislacioni.

Çfarë realisht shkakton vështirësi është zbatimi në praktikë i politikave të qeverisë apo organizatave nga punonjësit në aktivitetin e tyre të përditshëm. Politikanët, zyrtarët publikë, punonjësit dhe sipërmarrjet

1 Fjalori Anti-Korrupsion, Transparency International <http://www.transparency.org/glossary/term/integrity>

2 Lawrence Wilson, Artikull “Integrity, what it is and what it means”, Janar 2014, The Center For Development, <http://drlwilson.com/Articles/INTEGRITY.htm>

3 Henk Bruning, “To be honest, ‘Finding inspiration and integrity in public service and business’”, Caslon S.L-Madrid 2014, fq. 43

publike duhet që të punojnë bashkë për të koordinuar politikat dhe zbatimin e tyre. Bashkë ata mund të përmirësojnë ose përkeqësojnë imazhin publik të një qeverie ose organizate.

1. Integriteti dhe roli i tij për qeverisje të mirë

Qytetarët nuk e shikojnë qeverinë si një shumë të të gjithë njerëzve, por si një entitet të ndarë. Njerëzit nuk mund të zgjedhin midis disa qeverive në çdo moment. Nëse një person shkon në dyqan, restorant dhe shërbimi që ata marrin nuk ju pëlqen, ata mund të shkojnë diku tjetër për të marrë një shërbim më të mirë. Kjo mundësi nuk vlen për qeveritë.

Pozita e qeverisë në shoqëri është e ndërlikuar dhe e vështirë. Si mund t'i realizojë ajo detyrat e saj duke garantuar qeverisjen e mirë dhe integritetin?

Kur dikush është në një pozitë drejtuese, mendon se ndershmëria dhe integriteti nuk janë aq të rëndësishme sa paratë. Ndershmëria dhe integriteti janë pafundësisht më të rëndësishme se paratë. Ata janë po aq të rëndësishme sa ajri, ushqimi dhe uji.

Për një drejtues, ndershmëria dhe integriteti janë absolutisht thelbësore. Shumë njerëz të organizatave qeveritare apo biznesit nuk e kuptojnë se sa afër ata janë duke u shikuar në çdo veprim të tyre nga vartësit e tyre. Për ta kuptuar më mirë këtë, mjafton të kujtoni veten tuaj kur ishit në shkollë fillore, se me sa shumë vëmendje vëzhgonit mësuesin tuaj gjatë gjithë ditës.⁴

Integriteti është një detyrim për çdo qytetar, politikan, zyrtar dhe punonjës. Organizatat në sektorin publik dhe privat mund të jenë viktime ose aktorë dhe partnerë në korrupsion.

Duhet të jemi të përgjegjshëm dhe të udhëheqim shoqërinë drejt një niveli më të lartë të drejtësisë dhe ndershmërisë.

Të punosh në qeveri ose në një organizatë të njohur përbën një punë të mirë, pasi nënkupton një mënyrë të jetuari dhe karrierë që të jep kënaqësi personale. Sidoqoftë, gjërat nuk janë gjithmonë të thjeshta. Mund të hezitosh, të dyshosh, apo të akuzohesh për diçka të cilën nuk e

4 Jim Rohn, Artikull "Maintaining Honesty and Integrity", <http://www.nightingale.com/articles/maintaining-honesty-and-integrity/>

ke bërë. Këto situata janë dilema, dilema morale, dilema etike dhe dilema rreth përgjegjësisë.

Sipas fjalorit të gjuhës shqipe, “dilema” është gjendje e vështirë, kur dikush duhet të zgjedhë, njërën nga dy mundësitë ose nga dy gjërat e kundërta që i paraqiten.

Edhe presidentët apo kryeministrat përballen me dilemat apo pendesa, lidhur me faktin nëse zgjedhja e tyre ishte në të njëjtën kohë zgjedhja e duhur.

2. Dilemat

Të marrësh një vendim të drejtë nuk është gjithmonë e thjeshtë. Gjithashtu dilemat ofrojnë mundësinë që ne t’i përdorim në avantazhin tonë; për qetësinë e mendjes tonë dhe në varësi të pozitës tonë edhe mirëqenies së vendit tonë.

Vendoseni veten përballë këtyre dilemave të vështira, si më poshtë⁵:

-Një proces gjyqësor zbulon se në 20 vitet e fundit, një ish-President dhe kryetari i nderit i një partie në koalicion ka depozituar 1.5 billion euro në parajsat fiskale dhe ka detyruar bizneset t’i paguajnë atij 3% të shumës së kontratës. Ju jeni në krye të qeverisë aktuale. A do të distancoheni publikisht nga kjo parti apo do të vazhdoni koalicionin me ta? Ose, si një qytetar, a do të vijoni të votoni për këtë parti?

-Ju jeni kryetari i një partie qeverisëse dhe hapur e kundërshtoni korrupsionin. Në të njëjtën kohë, je i ndërgjegjshëm se vendi juaj është i rrethuar nga korrupsioni. A do të ndizni alarmin dhe aktivisht të luftoni korrupsionin, nëpërmjet partisë tuaj politike?

-Ti je një profesor në universitet, ku është zbuluar që ish-zëvendësdekani është i korruptuar. Do ta denoncosh këtë fakt publikisht, apo do të jetë diçka që ti do mjaftohesh ta diskutosh me kolegët?

-Një kompani e huaj kërkon leje për të investuar në një port. Kërkesa është refuzuar dy herë, për shkak të lidhjeve të mundshme mes kompanisë dhe krimit të organizuar. Ndërkohë kriza ekonomike po merr zgjerim. Kompania bën një kërkesë të tretë. A do të jepje dakordësinë tuaj në rast

5 “To be honest, ‘Finding inspiration and integrity in public service and business”, Caslon S.L-Madrid 2014, faqe 15-16

se do ishit Ministër i Ekonomisë?

-Një kompani për të cilën ju jeni personi i kontaktit, ofron për ju dhe familjen tuaj një fundjavë me të gjitha shpenzimet e mbuluara në një resort turistik. Kompania e bën këtë me qëllime të mira biznesi. Do ta pranosh ftesën?

-Ti je punësuar nga këshilli bashkiak si arkitekt. Një kontraktor lokal ju ofron një verë të shkëlqyer. Do ta pranosh?

-Ti je një inspektor i mjedisit pranë një bashkie dhe një qytetar dëshiron të ndërtojë një shtëpi në kundërshtim me rregullat. Ti e mohove kërkesën. Sidoqoftë, më vonë ti mëson që eprori yt ka vendosur t'ja pranojë kërkesën. Do ta kundërshtoni këtë vendim pranë kryetarit të bashkisë ose autoritetit përkatës, apo do të mendoni se kjo nuk është përgjegjësia juaj?

-Ti punon për një agjenci qeveritare dhe vë re se disa prej kolegëve tuaj arrijnë vonë në punë dhe ikin herët. Do ta adresoni këtë çështje për kolegët tuaj?

-Ti je kryebashkiak dhe vë re se 30% e nëpunësve nuk janë të motivuar dhe të aftë të bëjnë punën e tyre. Një numër i lartë i këtyre punonjësve janë emëruar në detyrë si rezultat i premtimeve gjatë fushatës elektorale. Do të ndërmarrësh ndonjë veprim?

-Ti je kryetar i këshillit bashkiak dhe punonjësit të ankohen për pagat e tyre të cilat janë shumë të ulëta për të mbajtur familjet. A do ta vendosësh këtë çështje në agjendën e mbledhjeve të këshillit?

-Një kontraktor është duke rimodeluar shtëpinë tuaj. Ai ju pyet nëse dëshironi ta përfshijë TVSH-në në faturë apo jo? Si do i përgjigjeni ju?

-Kompania juaj është duke investuar në një vend të huaj. Gjatë aplikimit për leje, këshilli lokal ju kërkon të derdhni një kontribut financiar për një organizatë lokale? A do ta pranojë këtë kërkesë?

1.1 Ti kthejmë dilemat në mundësi

Ndërkohë që lexojmë dilemat e përmendura më lart, me siguri kuptojmë situatat e vështira me të cilat mund të përballemi çdo ditë. Automatikisht fillojmë dhe peshojmë avantazhet dhe disavantazhet e marrjes së një vendimi dhe kuptojmë se nuk është aq e thjeshtë sa kemi menduar dhe gjendemi shpesh të ngatërruar në standardet tona etike.

Media dhe autoritetet e drejtësisë duhet të bëjnë çfarë mundën për

publikimin dhe ndëshkimin e situatave të paligjshme.

Sidoqoftë, shumica e dilemave mbeten në prapaskenat e zyrave të qeverisë, të ministrive, të departamenteve dhe mes kolegëve. Kjo është e dëmshme dhe alarmuese sepse⁶:

-zyrtarët publikë dhe politikanët janë të “detyruar” të marrin vendimet e tyre në varësi të vlerave të tyre morale dhe profesionale dhe ;

-imazhi i qeverisë apo organizatës dëmtohet nëpërmjet këtyre veprimeve.

A janë këto sjellje raste të izoluara apo po flasim për një keqmenaxhim sistematik? Nëse nuk marrim përgjigje të kënaqshme nga këto pyetje, qeveria humbet kredibilitetin e saj dhe ne jemi dëshmitarë të rrënimin të demokracisë.

Njerëzit pa dilema morale dhe etike thjesht nuk ekzistojnë dhe paraqitet si domosdoshmëri adresimi i kësaj çështjeje në mënyrë të hapur dhe të ndershme. Një vendimmarrje bazuar në vlera morale dhe etike do të forcojë integritetin në çdo organizatë e qeveri.

3. Hartimi dhe zbatimi i politikave për integritetin dhe qeverisjen e mirë

Vlerat morale dhe etike dobësohen aty ku gjen hapësira korrupsioni. Shpesh politikanët duken sikur bëjnë marrëveshje xhentëllmenësh për të mos ndëshkuar njëri-tjetrin, duke i prezantuar veprimet që ndërmarrin sit ë domosdoshme për të mirën e përgjithshme.

Njerëzit anembanë botës janë të motivuar për të zhvilluar qeverisjen e mirë dhe integritetin, sepse këto koncepte sjellin zhvillime pozitive. Pikëpamjet e tyre se çfarë nënkupton korrupsioni dhe çfarë nënkupton qeverisja e mirë dhe integriteti, janë shumë të përafërta. Në një intervistë me një student britanik, i cili jeton në një vend të ndryshëm nga Shqipëria, gjejmë shpjegimin si më poshtë të këtyre koncepteve:

6 To be honest, ‘Finding inspiration and integrity in public service and business’, Caslon S.L-Madrid 2014, faqe 17

Korrupsioni	Qeverisja e mirë dhe integriteti
Shkatërron vlerat	Gjithçka funksionin në proporcion dhe në përputhje me normat dhe vlerat
Ul standardin e jetesës	Menaxhohen mirë burimet natyrore
Unë jam i rëndësishëm, të tjerët jo	Shërbimet publike funksionojnë në përputhje me nevojat e qytetarëve
Ndikon në aspekte të tjera të shoqërisë: p.sh unë paguaj për gjelbërimin, por nuk ka kujdes për këtë çështje, si pasojë rrezikshmëria për jetën shtohet	Merr përparësi interesi publik
Ulet niveli i përgjegjshmërisë	Rritet niveli i llogaridhënies

Integriteti dhe qeverisja e mirë kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit dhe pastrimit të parave. Detyra kryesore për të luftuar me sukses pastrimin e parave është procesi i mbledhjes, ekzaminimit, analizimit me paanësi, objektivitet dhe integritet të të dhënave dhe fakteve. Pa respektuar rregullat e integritetit, kriminelët mund t'i shpëtojnë drejtësisë dhe mund të dhunohen të drejtat e njerëzve të pafajshëm. Në këtë mënyrë konceptet e qeverisjes së mirë dhe integritetit janë jetike dhe për dhënien e drejtësisë.

Shumica e europianëve bien dakord që korrupsioni është problem shumë shqetësues në perspektivat e vendeve të tyre. Në vitin 2014, një studim mbi korrupsionin në Bashkimin Europian, zbuloi një dëm rreth 120 bilionë dollar, nga korrupsioni. Ky studim i Komisionit theksoi se 76% e europianëve besonin që korrupsioni është shumë i përhapur dhe 55% e tyre mendonin se në tre vitet e fundit korrupsioni është rritur në mënyrë të dukshme në vendin e tyre.⁷

Çështja që shtrohet është nëse hartimi dhe zhvillimi i politikave për qeverisjen e mirë dhe integritetin janë të mirëpritura dhe të gjithëpranuara për realitetin tonë në Shqipëri?

7 Raporti i Antikorrupsionit (2014) Komisioni Europian (raportim i Malstrom)

3.1 Argumentat pro dhe kundër politikave për integritetin

Argumentat pro:

-Kontrolli mbi politikat qeveritare mund të bëhet më mirë dhe në mënyrë efikase;

-Imazhi i qeverisë do të përmirësohet;

-Ligjshmëria do të përbëjë rregullin;

-Vendimmarrja e qeverisë dhe menaxhimi i burimeve do të jenë më transparente;

-Njerëzit do krijojnë kontakt më të drejtpërdrejtë me të zgjedhurit e tyre.

Argumentet kundër:

-Një politikë e tillë shtron si nevojë një ndryshim thelbësor në organizimin dhe praktikat e përditshme për punonjësit e një organizmi qeveritar apo organizate;

-Të zgjedhurit e politikave në përputhje me qeverisjen e mirë dhe integritetin çon drejt humbjes së marrëdhënieve shoqërore;

-Politikat e qeverisjes së mirë dhe integritetit kushtojnë para;

-Zbatimi i qeverisjes së mirë dhe integritetit, vazhdimisht mund të krijojë konflikte.

Duke hetuar argumentat kundër politikave që fokusohen në qeverisjen e mirë dhe integritetin, evidentojmë se zbatimi i tyre mund të krijojë probleme për vendimmarrjen në përgjithësi, por nga ana tjetër përmirëson cilësinë e vendimmarrjes dhe transparencë.

Gjykoj me rëndësi të ndalem te aspekti financiar. Të luftosh korrupsionin sigurisht që kushton para. Por mjafton të kujtojmë shifrat alarmante të parave të humbura nga korrupsioni për të kuptuar se ideja se të luftuarit e korrupsionit kërkon shumë para nga buxheti i shtetit është një ide e gabuar.

Në Milan, Itali⁸, pas një skandali të madh korrupsioni, ku disa politikanë të shquar u dënuan me burg dhe disa të tjerë kryen vetëvrasje, projektet e investimeve kapitale ranë ndjeshëm. Analizat treguan se

8 To be honest, 'Finding inspiration and integrity in public service and business', Caslon S.L-Madrid 2014, faqe 73

kjo rënie ishte për shkak të numrit të ulët të projekteve të kontraktuara. Transparency International vjen me një zbulim interesant: Dy-tre vjet pas këtij skandali në Milan, kostoja e ndërtimit të një hekurudhe u ul me 52%, kostoja e një kilometri hekurudhe u ul me 57% dhe kostoja e ndërtimit të një aeroporti ra me më shumë se 59%, duke vërtetuar kështu një lidhje shkak-pasojë, ku korrupsioni politik është i lidhur me projektet e investimeve.

Në vitin 2014, për shkak të akuzave për zhvatje dhe pastrim parash rreth 1.8 bilionë Euro, në Spanjë nisi një hetim për ish-Presidentin e Katalonjës. Ai kishte qenë President për 23 vite dhe gëzonte respekt nga populli. Ai dhe familja e tij fitonin rregullisht para duke marrë për vete sistematikisht 1 - 3 % të çdo kontrate publike në formë komisioni. Nëse një investitor nuk bashkëpunonte, atij nuk i lidhej kontrata.

Korrupsioni rrit sasinë e projekteve gjithashtu dhe shkallën e kompleksitetit. Rezultati neto është një rritje në pjesën e të mirave publike ne GDP, një ulje në prodhimin mesatar të investimeve, por gjithashtu një ulje e mundshme në shpenzimet qeveritare të tilla si mirëmbajtja dhe zbatimi i politikave të edukimit dhe kujdesit shëndetësor. Korrupsioni prek zhvillimin e një vendi në drejtim negativ. Për sa më lart, me fjalë të tjera, duke luftuar dhe parandaluar korrupsionin, fitohen para.

4. Integriteti si pengesë për korrupsionin

Rregullat mbi integritetin ndihmojnë që të jemi të suksesshëm në parandalimin e korrupsionit. Korrupsioni dëmton besimin e qytetarëve, në pavarësinë, integritetin dhe aftësinë për të ndërmarrë veprime. Korrupsioni dëmton këdo. Ai dëmton imazhin e shtetit dhe të njerëzve që punojnë për të, si dhe të dërgon menjëherë në përgjegjësi penale. Korrupsioni nis me ndere të vogla, të lë të pambrojtur përballë kërcënimeve dhe mund të të kushtojë vendin e punës.

Për këtë arsye, parandalimi i korrupsionit është thelbësor dhe meriton vëmendjen tonë të plotë. Ne duhet të jemi vigjilentë të mos i japim korrupsionit asnjë mundësi. Drejtuesit duhet të krijojnë një kulturë transparence dhe integriteti brenda institucionit me zero tolerancë ndaj korrupsionit. Ata sigurohen që ajo që bëjnë njerëzit brenda institucionit të tyre është e drejtë.

Shkeljet në vendin e punës (përfshirë vjedhjet, veprime korruptive etj.) janë ndër problemet më të përhapura me të cilat përballen qeveritë, administratat apo organizatat e biznesit. Këto sjellje rezultojnë në miliarda dollarë të ardhura të humbura në vit. Asnjë organizatë nuk është immune ndaj tyre. Studimet tregojnë se deri në 50% të të gjitha dështimeve të biznesit dhe rreth 30% e dështimeve të biznesit të vogël janë të lidhura me pandershmërinë e punonjësve⁹.

Çdo institucion duhet ta nisë punën nga miratimi i një Kodi Sjelljeje kundër Korrupsionit me qëllim informimin e stafit mbi situatat, në të cilat aksidentalisht mund të bëhen pjesë e korrupsionit. Ai gjithashtu ka si qëllim të angazhojë stafin në përmbushjen e detyrave të tij në mënyrë korrekte dhe në përputhje me ligjin dhe t'i shqetësojë ata në lidhje me pasojat e një sjelljeje korruptive.

Përmbytja e një kodi sjelljeje, rekomandohet të përfshijë rregullat si më poshtë¹⁰:

Bëhu shëmbull: Trego nëpërmjet sjelljes tënde që ti kurrë nuk do tolerosh apo mbështesësh korrupsionin;

Refuzo menjëherë çdo tentativë për t'u përfshirë në aktivitete korruptive dhe informo personin e kontaktit për parandalimin e korrupsionit dhe eprorin tënd pa vonesë;

Nëse dyshon që dikush kërkon trajtim preferencial në kundërshtim me detyrën tënde, njofto kolegun si dëshmitar;

Ndaje qartësisht punën tënde nga jeta private. Kontrolllo nëse interesat privatë mund të kenë konflikt me detyrat e punës;

Kontribo në vendin tënd të punës në zbulimin dhe pastrimin nga korrupsioni. Informo eprorin dhe personin e kontaktit për parandalimin e korrupsionit në rast të treguesve konkretë të një sjelljeje korruptive.

Merr pjesë në trajnime fillestare dhe të avancuara që parandalojnë korrupsionin.

Dhe çfarë duhet të bësh në qoftë se e gjen veten të përfshirë në mënyrë pavullnetshme në korrupsion?

9 Hasan M. Aleassa, Ziad M. Zurigat, Organizational Identification, Corporate Ethical Values, and Intention to Report Peers' Unethical Behavior, European Journal of Business and Management, Vol.6, No.15, 2014, fq. 76

10 Ministria Federale e Brendshme Gjermane, Rules on Integrity, fq.14

Ndjeje veten të lirë nga frika e të treguarit një gjë të tillë. Nëse ti rrëfen më iniciativën tënde dhe informacioni juaj ndihmon në qartësimin e fakteve, kjo gjë mund të reduktojë ashpërsinë e dënimit dhe pasojat.

Procesi i vendimmarrjes dhe zbulimit nga bilbilfryrësit¹¹ është gjithshu pjesë integrale e luftës kundër korrupsionit dhe mënyra se si është rregulluar kjo çështje në një vend tregon angazhimin për luftimin e korrupsionit dhe rritjen e integritetit në administratën publike.

Një pikënisje e mbarë për të promovuar etikë dhe parandaluar korrupsionin është sigurimi i një kulture transparence në fushat ku kërkohet më shumë, në zemër të qeverisë, në institucionet që mbrojnë publikun, ofrojnë siguri dhe shërbime për publikun. Për ta arritur këtë¹², duhet që:

së pari: të forcohen rregullat që detyrojnë punonjësit të deklarojnë pasurinë, interesat financiarë, dhuratat e marra, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit dhe të përmirësohet niveli i zbatimit të ligjeve të miratuara më këtë qëllim¹³.

Së dyti: për të pasur transparencë të plotë në qeveri, është thelbësore krijimi i transparencës në çdo pjesë të sistemit, duke përfshirë konsultimet paraprake, marrëveshjet biznes-qeveri deri te ofrimi i shërbimeve. Kjo mundëson që njerëzit të kontrollojnë se sa po realizohen premtimet dhe të rrisin besimin tek përfaqësuesit e tyre në qeveri apo parlament. Informacioni nuk është një dhuratë. Ai ju takon njerëzve. Në vitin 2014 në Shqipëri u miratua ligji i ri për të drejtën e informimit¹⁴ i bazuar në modelet më të përparuara të vendeve evropiane dhe atyre të rajonit, me pritshmëri të garantojë rregulla konkrete për mbrojtjen dhe shndërrimin e të drejtës së informimit në një të drejtë reale dhe lehtësisht të zbatueshme në praktikë.

11 Ligj nr. 60, datë 2.06.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

12 Haguette Labelle, “Towards a corruption-Free caribbean: ethics, values, trust and morality”, 19 mars 2014, Transparency International

13 Ligjin.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar

14 Ligj nr.119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”

5. Shtyllat e integritetit

Një politikë e suksesshme integriteti ka 7 shtylla të rëndësishme¹⁵:

1. Gjykim moral dhe etik nga ana e çdo individi;
2. Debat gjithëpërfshirës dhe ekzaminim të dilemave;
3. Vlerat e një organizate;
4. Rregulloret dhe kodi i sjelljes;
5. Lidhshipi, të mbajturit dhe të promovuarit integritet;
6. Mbikëqyrje dhe ndëshkim;
7. Hetim i riskut, së brendshmi dhe nga jashtë.

Gjithçka nis nga gjykimi moral i individit. Çdo person është përgjegjës për një vendim që merr ose veprim që kryen. Në rrethana normale vendimmarrja është rutinë, e drejtuar nga bindja jonë e brendshme, përvoja dhe ndjesia. Sidoqoftë, ne gjendemi në dilema (vështirësi për të zgjedhur), kemi dyshime për një vendimmarrje. Çdo dilemë ka anën e saj të moralit; ajo të bren ndërgjegjen nëse nuk justifikohet moralisht. Të marrësh një vendim shpesh është e vështirë për një individ. Përfshirja e shumë njerëzve në vendimmarrje, në çdo rast është më efektive, transparente dhe më e justifikuar moralisht.

Vlera e organizatave ose e njerëzve reflektohet në çdo vendimmarrje apo marrëveshje të nëshkruar. Identiteti i organizatës dhe personaliteti i punonjësve shkrihen me njëri-tjetrin.

Rregullat janë bërë për t'u thyer. Prandaj është e rëndësishme miratimi i rregulloreve dhe kodeve të sjelljes me rregullat që duhen ndjekur nga punonjësit.

Menaxherët dhe mbikëqyrësit kanë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e përgjegjësive për të kontrolluar praktikat e punonjësve të tyre dhe ndërmarrjen e sanksioneve sipas rastit.

Me rëndësi është edhe shtylla e ekzaminimit dhe parandalimit të rrezikut (riskut).

Ekzaminimi i herëpashershëm i riskut dhe ndëshkimi i konfliktit të interesit, mashtrimit, korrupsionit, abuzimit me pushtetin, forcojnë organizatën dhe pjesëtarët e saj.

15 Henk Bruning, "To be honest... 'Finding inspiration and integrity in public service and business'", Caslon S.L-Madrid 2014, fq.100

6. Pakti i Integritetit

Në të gjitha vendet, fusha e prokurimeve dhe ndërtimeve, janë me risk të lartë ndaj korrupsionit, veçanërisht për projektet e mëdha. Në përgjithësi, për këto projekte, qeveria kontraktton kompani private. Kjo lidhje mes sektorit publik dhe privat mund të përbëjë një hapësirë për korrupsion. “Pengesat themelore për analizën dhe trajtimin e korrupsionit ka të bëjë pikërisht me marrëdhëniet tepër të ngushta që ekzistojnë në tri drejtime kryesore: korrupsioni politik, korrupsioni i funksionarëve dhe korrupsioni që zbatojnë ndërmarrjet private me një qëllim të qartë: maksimizimin e përfitimeve duke shtrembëruar mekanizmat e ekonomisë së tregut”¹⁶.

Këta projekte të mëdha bëhen me paratë e qytetarëve, kështu që është detyrim për çdo qeveri të dëshmojë se procesi po mbahet në kushtet e transparencës së plotë.

Këtë lloj korrupsioni nuk bëjmë gabim ta quajmë korrupsion i ditëve tona, për shkak të shkallës së gjerë të përhapjes së tij. Sipas Donald Strombonit, ish-shefit të prokurimeve për BB, projektet ndërtimore të punëve publike janë rastet më të mëdha të korrupsionit në të gjithë botën. Gjithashtu, përdorimi i konsulentëve të huaj dhe kontraktimi me burime të huaja, për shërbime janë një mundësi e re për korruptim.

Format e korrupsionit janë të ndryshme, si: dhënia e një depozite, dërgimi për studime të fëmijëve të personit pranë shkollave të njohura jashtë shtetit, pagesa të drejtpërdrejta, etj.¹⁷

Pakti i integritetit është një mjet, i cili është krijuar në vitet ’90 nga Transparency International, me qëllimin për të ndihmuar Qeveritë, ekonominë dhe shoqërinë civile, që janë të gatshme për të luftuar korrupsionin në sektorin e lidhjes së kontratave për punët publike. Pakti i Integritetit ndihmon për të forcuar besimin e popullsisë në mënyrën e trajtimit të tenderëve nga autoritetet dhe kontribuon në rritjen e besueshmërisë ndaj qeverive dhe administratave në përgjithësi.

Pakti i Integritetit është aplikuar në më shumë se 15 vende dhe 300 projekte. Ato mbrojnë fondet e taksapaguesve, sigurojnë që projektet e

16 Pierre Lascoume, “Korrupsion”, Botimet Sokol, Tiranë 2002, fq.94

17 Hysi Vasilika, “Kriminologjia”, Kristalina-KH, Tiranë 2010, fq. 309.

infrastrukturës dhe vepra të tjera publike të dorëzohen në mënyrë efikase, dhe eliminon rrugët për përfitime të paligjshme.¹⁸

Nëpërmjet Paktit të Integritetit, si një nga instrumentet më të suksesshme të Transparency International në luftën kundër korrupsionit, Autoriteti tenderues dhe të gjithë kontraktuesit potencialë detyrohen të heqin dorë nga metodat korruptuese në këtë situatë konkurrence. Me monitorimin e këtij procesi ngarkohet një autoritet i pavarur, nëse është e mundur një organizatë e shoqërisë civile, si për shembull një seksion kombëtar i TI-së. Kush e shkel marrëveshjen kundër korrupsionit, merr gjoba të konsiderueshme.¹⁹

Pikat kryesore të Paktit të Integritetit

Për autoritetin apo sipërmarrjen tenderuese²⁰:

- Asnjë përfaqësues zyrtar i autoritetit nuk ka të drejtë të pranojë apo të kërkojë as direkt dhe as me ndërmjetës çdo lloj ryshfeti, dhurate apo sponsorizimi tjetër për vete apo për një person, organizatë apo palë të tretë, e cila ka lidhje me tenderin dhe në këmbim të sigurojë avantazhe gjatë procesit të dhënies së ofertave.

- Autoriteti do të bëjë publike të gjithë informacionet e nevojshme dhe teknike, ligjore dhe administrative, që lidhen me projektin në zbatim apo të tenderuar.

- Asnjë përfaqësues i autoritetit nuk do t'u japë ofertuesve apo palëve të kontratës informacione, të cilët do të krijojnë një avantazh të kundërligjshëm për ofertuesit apo palët e kontratës në procesin e tenderimit apo të zbatimit të kontratës.

- Të gjithë përfaqësuesit e autoritetit, që kanë lidhje me procesin e ofertave, verifikimin e ofertës dhe lidhjen e kontratës, do të deklarojnë çdo lloj konflikti interesi që lidhet me kontratën. Do të ishte shumë e dëshirueshme, që në të njëjtën mënyrë ata të deklaronin si pasuritë e tyre ashtu edhe të familjarëve të tyre.

18 http://www.transparency.org/whatwedo/tools/integrity_pacts

19 Peter Eigen, "Rrjeti i Korrupsionit", "Campus", Frankfurt/Njujork, 2003, faqe 59

20 Po aty, faqe 61

- Secili përfaqësues i autoritetit duhet t'u raportojë autoriteteve përkatëse qeveritare çdo tentativë apo shkelje faktike të marrëveshjeve si dhe çdo dyshim serioz, që ka krijuar një problem të tillë.

Edhe rregullat për kontraktorët e mundshëm janë të ngjashëm²¹:

- Atyre nuk u lejohej t'u ofrojnë as përfaqësuesve të autoritetit tenderues dhe as të afërmeve apo miqve të tyre, as në mënyrë direkte dhe as me ndërmjetës, çdo lloj ryshfeti, dhurate apo sponsorizim tjetër, me qëllim që të sigurojnë avantazhe gjatë procesit të dhënies së ofertave.

- Ata duhet të bëjnë marrëveshje me palët e tjera brend procesit të tenderimit, duke kufizuar në këtë mënyrë transparencën e ofruar dhe ndershëmrinë e procesit të dhënies së ofertave dhe të lidhjes së kontratës.

- Ata nuk do të pranojnë asnjë përfitim në këmbim të një sjelljeje joprofesionale.

- Ata duhet të deklarojnë të gjitha pagesat për agjentët apo ndërmjetësit e tjerë, të cilët për shërbimet e tyre në asnjë rast nuk duhet të marrin më shumë se vlera e arsyeshme ekuivalente.

Është e rëndësishme, që të gjithë pjesëmarrësit në një proces tenderimi të bëhen pjesë e Paktit të Integritetit. Në rast se vetëm njëri e refuzon këtë, Pakti nuk funksionon.

1.1 Dobitë e një Pakti Integriteti

Pakti i Integritetit është i përshtatshëm në projektet e privatizimit, sektorin e ndërtimit, të dhënies së lejeve të shfrytëzimit apo të licencave për nxjerrjen e mineraleve, mxjerrjen e naftës, shfrytëzimin e pyjeve, menaxhimin e mbetjeve, etj.

“Pakti i Integritetit është një premtim për reciprocitet, me rregulla për t'u zbatuar nga të dyja palët, p.sh për Ministrinë nga njëra anë dhe firmat e ndërtimit, lëvruarit dhe konsulentët teknikë nga ana tjetër. Në këtë proces duhet që porositësi gjatë tenderit të deklarojë, se ai është i gatshëm të zbatojë Paktin dhe kësaj duhet t'i përmbahen të gjithë ofertuesit. Këtu është e rëndësishme, që të parashikohen sanksione si për porositësin ashtu edhe për të porositurin. Në këtë mënyrë porositësi

21 Peter Eigen, “Rrjeti i Korrupsionit”, “Campus”, Frankfurt/Njujork, 2003, faqe 62

detyrohet që të marrë masa disiplinore ndaj punonjësve të korruptuar. Natyrisht që i porosituri potencial do ta humbasë kontratën, në rast se atij i vërtetohet se ka përdorur metoda korruptive. Krahas kësaj Pakti përfshin edhe humbjen e garancisë së ofertuesit, pra atë shumë, të cilën ofertuesit duhet t'ia paguajnë paraprakisht porositësit dhe që për vëllime punimesh prej 50 milionë Euro arrin nga tre deri në pesë milionë. Përveç kësaj korruptuesi detyrohet që të dëmshpërblejë dëmin dhe vendoset në listën e zezë, pra përjashtohet nga tenderët e ardhshëm.”²²

Disa shembuj për ilustrim: në qytetin Maron të Argjentinës, u lidh Pakti i Integritetit midis administratës së Bashkisë dhe katër ofertuesve, të cilët konkurronin për një kontratë katërvjeçare për pastrimin e mbeturinave. Projekti kishte vlerën 32 milionë dollar amerikanë. Në Itali, Milano, Genua, Varese dhe Bergamo kanë pranuar paktin e Integritetit në shumicën e projekteve të tyre. Pakti i Integritetit është aplikuar me sukses edhe në vende si Pakistani, Koreja e Jugut, Meksikë, etj.

Ndërsa Pakti i Integritetit ndihmon për të siguruar veprime të pastra nga ana e kontraktorëve dhe zyrtarëve publikë gjatë ekzekutimit të një projekti, sjell gjithashtu përfitime të tjera. Ai siguron gjithashtu akses të zgjeruar në informacion dhe rritjen e nivelit të transparencës në kontratat publike. Kjo, nga ana tjetër, të çon në besim më të madh në vendimmarrjen publike, më pak kontestime mbi proceset e prokurimit dhe më shumë ofertues që konkurrojnë për kontrata. Pakti i Integritetit gjithashtu udhëheq ndryshime institucionale, të tilla si rritje në përdorimin e sistemeve të e-prokurimit, thjeshtimi i procedurave administrative etj.²³

22 Michael Wiehen (themelues i Paktit të Integritetit) cituar në “Rrjeti i Korrupsionit”, Peter Eigen, “Campus”, Frankfurt/Njujork, 2003, faqe 61

23 http://www.transparency.org/whatwedo/tools/integrity_pacts; http://www.transparency.org/whatwedo/tools/resources_about_integrity_pacts/3/

Konkluzione

Integriteti është thelbësor për një demokraci funksionale dhe një parakusht për shërbime efektive ndaj qytetarëve. Ai përbëhet nga sjellje dhe veprimenë përputhje me një tërësi parimesh dhe standardesh morale e etike, të cilat në rast se respektohen nga individët, organizatat, institucionet dhe qeveria bëhen pengesë përkorrupsionin.

Njerëzit anembanë botës janë të motivuar për të zhvilluar qeverisjen e mirë dhe integritetin, sepse këto koncepte sjellin zhvillime pozitive.

Gjithçka nis nga gjykimi moral i individit. Çdo person është përgjegjës për një vendim që merr ose veprim që kryen. Në rrethana normale vendimmarrja është rutinë, e drejtuar nga bindja jonë e brendshme, përvoja dhe ndjesia. Sidoqoftë, ne gjendemi vështirësi për të zgjedhur, kemi dyshime për një vendimmarrje. Çdo dilemë ka anën e saj të moralit; ajo të bren ndërgjegjen nëse nuk justifikohet moralisht. Të marrësh një vendim shpesh është e vështirë për një individ. Përfshirja e shumë njerëzve në vendimmarrje, në çdo rast është më efektive, transparente dhe më e justifikuar moralisht.

Vlera e qeverive, organizatave ose e njerëzve reflektohet në çdo vendimmarrje apo marrëveshje të nëshkruar. Identiteti i organizatës dhe personaliteti i punonjësve shkrihen me njëri-tjetrin.

Rregullat janë bërë për t'u thyer. Prandaj është e rëndësishme miratimi i rregulloreve dhe kodeve të sjelljes me rregullat e integritetit që duhen ndjekur nga punonjësit.

Literatura

-Henk Bruning, "To be honest, 'Finding inspiration and integrity in public service and business'", Caslon S.L-Madrid, 2014

-Peter Eigen, "Rrjeti i Korrupsionit", "Campus", Frankfurt/Njwjk, 2003

-Pierre Lascoume, "Korrupsion", Botimet Sokol, Tiranë 2002

-Vasilika Hysi, "Kriminologjia", Kristalina-KH, Tiranë 2010

-Hasan M. Aleassa, Ziad M. Zurigat, Organizational Identification,

Corporate Ethical Values, and Intention to Report Peers' Unethical Behavior, European Journal of Business and Management, Vol.6, No.15, 2014

-Haguette Labelle, "Towards a corruption-free Caribbean: ethics, values, trust and morality", 19 mars 2014, Transparency International

-Ministria Federale e Brendshme Gjermane, Rules on Integrity, Media fur Kommunikation GmbH, 2014

-Lawrence Wilson, Artikull "Integrity, what it is and what it means", The Center For Development, Janar 2014

-Jim Rohn, Artikull "Maintaining Honesty and Integrity", <http://www.nightingale.com/articles/maintaining-honesty-and-integrity/>

-Fjalori Anti-Korrupsion, Transparency International

-<http://www.transparency.org/glossary/term/integrity>

-http://www.transparency.org/whatwedo/tools/integrity_pacts

-<http://thehagueacademy.com/>

-Ligjnr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar

-Ligj nr. 119, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit"

-Ligj nr. 60, datë 2.06.2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

BAZA LIGJORE E PROGRAMEVE TË NDIHMËS SË JASHTME TË BASHKIMIT EVROPIAN

MSc, Doktorante Linda GJERMANI

Hyrje

Bashkimi Evropian (BE) është sot donatori më i madh në botë për ndihmën e dhënë vendeve në zhvillim. Ndihma e BE-së jepet si nëpërmjet Komisionit, ashtu edhe individualisht nga shtetet anëtare. Roli i Komunitetit Evropian (KE) si donator për vendet në zhvillim është sanksionuar në Traktatin themelues (Romë, 1957). Traktati parashikon dhënien e ndihmës vendeve në zhvillim dhe territoreve që atëhere ishin të lidhura me vendet themeluese, por i jep KE-së një rol “plotësues” në lidhje me atë të shteteve anëtare. Nga pikëpamja ligjore, çdo programi, të quajtur në gjuhën e KE “Instrument”, i korrespondon një rregullore e posaçme e miratuar nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian. Bazë tjetër ligjore e rëndësishme për lëvrimin e ndihmave janë edhe marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga KE me vendet marrëse, si dhe me organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale. Prirja e KE është për të thjeshtëzuar dhe unifikuar instrumentet e ndihmës dhe procedurat e tyre, të bazuarit në strategji afatgjata për çdo vend marrës, të hartuara me përfshirjen e qeverive partnere dhe koordinimin me ndihmën e dhënë individualisht nga shtetet anëtare. Gjithashtu, BE bashkëpunon ngushtë edhe me aktorë të tjerë globalë si me: organizmat e OKB-së, Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, etj. BE po bën përpjekje për të folur me një zë me shtetet anëtare për çështjet e zhvillimit dhe po forcon përfaqësimin e tij në botë nëpërmjet Delegacioneve. Në të ardhmen, në vijim të zgjerimit dhe të konsolidimit të BE-së, ndoshta baza ligjore e Traktateve do të rishikohet sërisht edhe pas Lisbonës, për t'i dhënë KE-së rolin parësor në çështjet e ndihmës së jashtme, në krahasim me shtetet antare. KE mund të kthehet nga plotësues, në drejtues dhe koordinues të

ndihmës së tyre. Ky artikull synon të bëjë një paraqitje të përmbledhur të bazave ligjore që mundësojnë dhe rregullojnë ndihmën e jashtme të dhënë nga BE në përfaqsim të vendeve anëtare, kryesisht për bashkëpunimin për zhvillim por edhe atë të llojit humanitar dhe të emergjencës. Shqipëria, është një nga vendet përfituese të ndihmës së jashtme të BE, kryesisht nëpërmjet programit IPA (Instrument of Pre—Accession ose Instrumenti paraprak i antarësimit), në kuadrin e antarësimit të saj në BE.

1. Llojet e legjislacionit dhe veprimtaria në BE

Baza ligjore e ndihmës së jashtme të BE-së ka disa nivele. Parimet dhe rregullat themelore janë të shprehura në Traktatet themeluese të KE dhe BE. Instrumentet e ndryshme që veprojnë si kanale për derdhjen e ndihmave, miratohen në formë rregulloresh të ndryshme, me afate kohore dhe kuadër financiar të përcaktuar dhe me listën ose kriteret për përfituesit. Baza ligjore e politikës për zhvillimin të BE, ashtu si edhe legjislacioni i fushave të tjera, përbëhet nga tre lloje legjislacionesh të veçanta, por të ndërlidhura mes tyre, të cilat së bashku përbëjnë “Acquis communautaire”. Këto janë: *legjislacioni parësor*, *dytësor* dhe *legjislacioni tretësor* ose “i butë”.

1.1 Legjislacioni parësor

Legjislacioni parësor i BE është ai që përfshin Traktatet themeluese dhe të amenduara. Në mënyrë krahasuese, Traktatet përbëjnë legjislacionin bazë ose themelor, i cili krahasohet me kushtetutat e vendeve sovrane. Si të tilla, ato përcaktojnë tiparet themelore të BE, përgjegjësitë e çdo aktori në procesin e vendimmarrjes, procedurat legjislative në sistemin e Komunitetit dhe fuqinë që rrjedh prej tyre. Traktatet amendohen duke u negociuar nga qeveritë e shteteve anëtare dhe ratifikohen në përputhje me procedurat që veprojnë në nivel kombëtar, të çdo anëtare. Amendimet duhet të nënshkruhen nga të gjitha shtetet anëtare dhe të ratifikohen nga parlamentet e tyre përkatëse, drejtëpërsëdrejti ose nëpërmjet referendumeve.

Traktatet themeluese mbi të cilat mbështetet funksionimi i BE-së, janë:

Traktati themelues i KE. Qëllimi kryesor i këtij Traktati ishte krijimi i KE, nëpërmjet integritimit gradual të shteteve evropiane dhe formimi e një tregu të përbashkët të bazuar në 4 liritë e lëvizjes (mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit) dhe në përafrimin e politikave ekonomike. Kjo u arrit nga dorëheqja prej një pjese të sovranitetit nga ana e institucioneve kombëtare të shteteve anëtare, në favor të institucioneve të KE, për të vendosur ligje (rregullore, direktiva, vendime) të zbatueshme për shtetet anëtare dhe që merrnin përparësi mbi legjislaconin e tyre kombëtar. Traktati i tanishëm i KE është versioni i amenduar i Traktatit themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian në Romë, në 1957, dhe që hyri në fuqi në 1 janar 1958. Ky traktat fillestar është amenduar disa herë, veçanërisht nga Akti Unik Evropian (Single European Act) i cili hyri në fuqi më 1987, Traktati i Mastrihtit (Traktati mbi BE) që hyri në fuqi më 1993, Traktati i Amsterdimit, i cili hyri në fuqi në 1999, dhe traktati i Nisës, që hyri në fuqi më 1 shkurt 2003. Si rezultat, janë zgjeruar sektorët që bien nën Traktatin e KE, për të përfshirë pothuajse të gjitha aspektet e ekonomisë, dhe disa çështje specifike më politike nga natyra si psh. e drejta e azilit dhe emigracioni.

Traktati i BE. Ky Traktat arriti dy objektiva: krijimin e bashkimit monetar duke përgatitur infrastrukturën për futjen e Euros dhe krijimin e bashkimit ekonomik dhe politik, duke futur për herë të parë konceptin e strukturës së “tre shtyllave”, ku e para (I) konsiston në KE dhe dy të tjerat përkatësisht në (II) politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe (III) për policinë dhe bashkëpunimin gjyqësor dhe çështjet kriminale. Mes shtyllës së parë dhe dy shtyllave të tjera ka një ndryshim të madh përsa i përket delegimit të përgjegjësisë dhe autoritetit ndaj Komisionit. Në fushat që mbulojnë shtyllat II dhe III, shtetet anëtare kanë ruajtur vendimmarrjen e tyre të pavarur dhe bashkëpunojnë me shtetet e tjera antare nëpërmjet formës ndërqeveritare të bashkëpunimit. Instrumentet ligjore më të rëndësishme në këtë fushë janë: veprimet e përbashkëta, pozicionet/qëndrimet e përbashkëta dhe vendimet kuadër (framework decisions), të cilat përgjithësisht miratohen në mënyrë unanime dhe nuk janë plotësisht të detyrueshme. Një arritje tjetër e traktatit të BE ishte kthimi i KEE në KE duke bashkuar në të edhe dy komunitetet e tjera: të Euroatomit dhe të Qymyrit dhe Çelikut. Traktati i Lisbonës, i nënshkruar

në 13 dhjetor 2007 dhe i futur në fuqi në 1 dhjetor 2009, rishikon rolet vendimmarrëse të aktorëve të BE duke rritur kohezionin e BE në fushën e politikës së jashtme dhe e shpall atë si person juridik. Lidhur me bashkëpunimin për zhvillim dhe ndihmën humanitare të cilat përfshihen në funksionet/vendimmarrjet e përbashkëta: “Ushtimi i kompetencave nga BE nuk duhet të pengojë ushtimin e të njëjtave kompetenca nga shtetet anëtare.”

Meqenëse nenet e Traktateve Themeluese të mbartuara pa ndryshime gjatë amendimeve të bëra, janë baza më solide the parësore ligjore për dhënien e ndihmës së jashtme nga KE, dhe pikënisja e gjithë Rregulloreve përkatëse mbi të cilat zbatohen programet e ndihmave, ia vlen të ndalemi në një analizë të shkurtër të tyre.

Baza ligjore parësore për dhënien e ndihmës së jashtme të KE buron nga Traktati i Romës (version i konsoliduar i Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Romë, 25 mars, 1957). Nenet që i referohen bashkëpunimit për zhvillim bëjnë pjesë në Titullin XX dhe ato për bashkëpunimin ekonomik, financiar dhe teknik me vendet e treta në Titullin XXI, konkretisht nenet 177-181a. Ndërsa pjesa vijuese 4, mbulon “Asocjimin e vendeve dhe territoreve përtej detit”. Qëllimi i shprehur i asocijimit është të “nxisë zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve dhe territoreve dhe të vendosë lidhje të ngushta ekonomike mes tyre dhe Komunitetit në tërësi. Asocijimi do t’u shërbejë në rradhë të parë interesave dhe mirëqenies së banorëve të këtyre vendeve dhe territoreve, me qëllim që t’i shpjerë ata drejt zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor për të cilin aspirojnë”. “Shtetet antare do të kontribuojnë me investimet e duhura për një zhvillim progresiv të këtyre vendeve dhe territoreve. Shtetet anëtare do të zbatojnë të njëjtin trajtim për tregtinë me vendet dhe territoret e përtej detit, si për shtetet antare. Pagesat doganore për importet e ardhura ose të origjinuara në OCT (Overseas Countries and Territories ose vendet dhe territoret e përtej detit), do të përjashtohen dhe hiqen, ashtu si për mallrat e shteteve antare”(Version i konsoliduar i Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Romë, 25 mars, 1957).

Më poshtë po shohim më më hollësi dy titujt e tjerë.

1. Titulli XX . Bashkëpunimi për zhvillim

Që në nenin 177 të Traktatit të Romës, theksohet se politika e

KE në fushën e zhvillimit do të jetë plotësuese e asaj të ushtruar nga shtetet antare. Synimet e saj janë të nxisë zhvillimin e qendrueshëm ekonomik dhe social të vendeve në zhvillim, sidomos atyre që janë më në disavantazh, integrimin e tyre gradual në ekonominë botërore, pakësimin e varfërisë, në kuadrin e përgjithshëm të konsolidimit të demokracisë dhe shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Neni 178 sanksionon se “Komuniteti dhe shtetet anëtare do të veprojnë në përputhje me angazhimet e marra prej tyre në kuadrin e OKB dhe organizatave të tjera kompetente ndërkombëtare” ndërsa në nenin 179 të këtij traktati sanksionohet se “Banka Evropiane e Investimeve do të kontribuojë në përputhje me termat e Statutit të saj”. Neni 180 i Traktatit të Romës sanksionon se Komuniteti dhe shtetet antare do të koordinojnë me njëri-tjetrin politikat e tyre të zhvillimit dhe do të konsultohen për programet e tyre të ndihmës, përfshirë edhe ato për organizatat ndërkombëtare si dhe para konferencave ndërkombëtare. Ata mund të ndër marrin veprime të përbashkëta. Shtetet antare nëqoftëse është e domosdoshme, do të kontribuojnë për zbatimin e programeve të ndihmës së KE. Komisioni mund të ndërmarrë nismat e nevojshme kordinuese.

Neni 181 i po këtij traktati sanksionon se: “Brenda sferës së tyre përkatëse të kompetencave, KE dhe shtetet antare do të bashkëpunojnë me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare. Për këtë do përdoren marrëveshje mes KE dhe vendeve të treta, të cilat do negociohen dhe nënshkruhen në përputhje me nenin 300. Kjo nuk paragjykon të drejtën e shteteve antare për të nënshkruar marrëveshje dy-palëshe me organizma ndërkombëtare dhe vende të treta”. (Version i konsoliduar i Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Romë, 25 mars, 1957)

• *Titulli XXI Bashkëpunimi ekonomik, financiar dhe teknik me vendet e treta*

“Pa paragjykuar nenet e tjera të Traktatit, sidomos të Titullit XX, KE do të ndërmarrë brenda sferave të tij të kompetencës, masa bashkëpunimi ekonomik, social, financiar dhe teknik, në plotësim të atyre që kryejnë shtetet anëtare, në përputhje me politikën e KE për zhvillimin. Duke vepruar me një shumicë të kualifikuar mbi një propozim të Komisionit, dhe mbas këshillimit me Parlamentin Evropian, Këshilli do të veprojë unanimisht për marrëveshjet e asociimit të përmendura në nenin 310, dhe

për marrveshjet që do nënshkruhen me shtetet që janë candidate për antarësim në BE. Rregullimi i bashkëpunimit me vende të treta do të bëhet me anë të marrveshjeve mes KE dhe palës së tretë, në përputhje me nenin 300 të Traktatit. Kjo nuk paragjykon të drejtën e shteteve antare për të negociuar dhe nënshkruar marrveshje me organizmat ndërkombëtare.” (Version i konsoliduar i Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Romë, 25 mars, 1957)

Kjo është pra baza ligjore kryesore për ndihmën e jashtme të KE, e cila përcakton procedurën dhe qëllimet kryesore politike të ndihmës. Të gjitha marrveshjet e nënshkruara dhe zbatuara deri tani, bazohen në nenet e mësipërme dhe hartohen e nënshkruhen sipas procedurave të specifikuar në Traktate. Traktati përmend nevojën e koordinimit të ndihmave nga shtetet antare dhe e vendos ndihmën e komunitetit si plotësuese të asaj që jepet drejtpërdrejt prej tyre. Kjo politikë, në fakt është duke ndryshuar në praktikë në të anasjelltën, siç do e shohim gjatë trajtimit në vijim, sidomos për vendet marrëse që kanë një perspektivë antarësimi në BE.

Traktatet e pranimit të shteteve të reja ose të zgjerimit. Këto kanë sjellë gjithashtu amendimin e traktateve themelore në fushat ku ka nevojë të reflektohet zgjerimi.

Marrëveshjet ndërkombëtare. *Marrëveshjet ndërkombëtare me të tretë, me organizata ndërkombëtare ose ato mes shteteve anëtare* janë burimi i dytë i legjislacionit, që i mundëson BE të zhvillojë lidhjet e tij ekonomike, politike dhe sociale me pjesët e tjera të botës. Këto janë gjithmonë marrëveshje të përfunduara mes subjekteve të ligjit ndërkombëtar (shtete anëtare ose organizatat) me qëllim vendosjen e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar. Marrveshjet e nënshkruara mes BE në shtyllën I, janë detyruese për Institucionet e BE, dhe për shtetet anëtare, ndërsa ato të shtyllës II dhe III, janë detyruese për institucionet e BE, por jo gjithmonë edhe për shtetet anëtare. Ato janë dy tipesh: (i) marrëveshje ndërkombëtare me vende të treta ose organizata ndërkombëtare, (ii) marrveshje dhe konventa mes shteteve anëtare. Shumica e marrëveshjeve për ndihmën e jashtme bëjnë pjesë në kategorinë (i) dhe prandaj do

shtjellohen më hollësisht, ndërsa tipi (ii) ka të bëjë me marrveshje që nuk prekin sferën e ndihmës së jashtme.

- *Marrëveshjet me vendet të treta ose organizatat ndërkombëtare.* Marrëveshje të këtij lloji mund të nënshkruhen nga KE ose nga KE dhe shtetet antare (marrveshje të përbashkëta). Këto janë detyruese si për KE, po ashtu edhe për shtetet antare, duke patur liabilitet në fushën ndërkombëtare.
- *Marrëveshjet e asocjimit,* të cilat përfshijnë bashkëpunim të ngushtë ekonomik të kombinuar me mbështetje të gjerë financiare nga Komuniteti për palën tjetër partnere, nënshkruese të marrveshjes. Këto lloj marrëveshjesh përdoren për vendet dhe territoret përtej detit, marrveshjet për përgatitjen e pranimit të vendeve të reja, dhe që krijojnë një bashkim doganor, si dhe marrveshjet për Zonën Ekonomike Evropiane (EEA). Shqipëria ka nënshkruar marrëveshjen e Stabilizim Asocjimit me KE dhe vendet antare (MSA) në 12 qershor 2006, dhe marrveshja ka hyrë në fuqi në 1 prill 2009 mbas ratifikimit nga të gjitha vendet anëtare të BE. MSA ka për qëllim të mbështesë forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor në Shqipëri, të kontribuojë për qendrushmërinë politike, ekonomike dhe institucionale të vendit, si dhe qendrueshmërinë në rajon. MSA ofron kornizën e duhur për dialog politik mes palëve dhe afrimin dhe forcimin e marrdhënieve politike mes tyre. Gjithashtu, kjo marrëveshje mbështet përpjekjet e Shqipërisë për të zhvilluar bashkëpunimin ekonomik dhe atë ndërkombëtar, duke përafruar edhe legjislacionin e saj me atë të BE, kalimin e plotë në një ekonomi tregu funksionale, nxitjen e marrëdhënieve ekonomike harmonike dhe krijimin gradual të një zonetë lirë ekonomike midis palëve. Në të njëjtën kohë, MSA mbështet bashkëpunim rajonal në të gjitha drejtimet e sipërpërmendura. Në sajë të MSA, Shqipëria përfiton aktivisht nga programi IPA, i cili cakton fonde vjetore prej afërsisht 85 milion Euro për bashkëpunimin me Shqipërinë.
- *Marrëveshjet e bashkëpunimit,* të cilat nuk kanë të njëjtën fushë si ato të asocjimit, mbasi ato kanë të bëjnë vetëm me bashkëpunim intensiv të natyrës ekonomike. Marrëveshje të këtij lloji lidhin

KE me vendet e Maghrebit (Algjeria, Maroku dhe Tunizia) dhe Masher (Egjypt, Jordani, Liban dhe Siri) si dhe me Izraelin.

- *Marrveshjet tregtare*, të cilat janë kryesisht për doganat dhe politikën tregtare dhe nënshkruhen me vende jo-anëtare ose grupet e tyre, ose në kuadrin e organizatave ndërkombëtare të tregtisë (psh me Organizatën Botërore të Tregtisë/ OBT).

1.2 Legjislacioni dytësor

Legjislacioni dytësor përfshin të gjitha veprimet ligjërish të detyruese, të cilat ndërmerren për të zbatuar politikën e vendosura nga Traktatet, dhe përbën burimin e tretë më të rëndësishëm për legjislacionin e BE. Mund të përcaktohet si tërësia e instrumentave legjislativë të përdorura nga institucionet evropiane në zbatim të Traktateve. Legjislacioni dytësor përfshin instrumentet ligjore detyruese dhe jo detyruese. Instrumentet detyruese janë si më poshtë:

- *Rregulloret*, të cilat përgjithësisht janë të zbatueshme dhe të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare, dhe miratohen nga Këshilli bashkë me Parlamentin Evropian, ose vetëm nga Komisioni. Ato u adresohen të gjitha vendeve anëtare.
- *Direktivat*, të cilat janë miratuar si më lart dhe janë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të cilave u drejtohen, dhe kanë qëllim përshtatjen e legjislacionit kombëtar, por duke ua lënë në dorë shteteve dhe institucioneve të tyre kombëtare të zgjedhin mënyrën e zbatimit.
- *Vendimet*, të cilat merren ose nga Këshilli, ose nga Këshilli bashkë me Parlamentin Evropian, ose nga Komisioni, dhe kanë të bëjnë si rregull me një çështje të veçantë. Ato nuk janë të zbatueshme në përgjithësi, por vetëm për shtetet anëtare, ndërmarrjet ose individët, të cilëve u drejtohen. Vendimi është një masë e natyrës individuale dhe personi të cilit i drejtohet duhet të specifikohet, ndërsa zbatimi është i detyrueshëm.

Instrumentet e legjislacionit dytësor jo të detyrueshme janë:

- *Rekomandimet*, të cilat shpalosin pikëpamjet e institucioneve të ndryshme dhe ftojnë për veprime të caktuara, por pa patur ndonjë fuqi detyruese.

- *Opinionet*, të cilat janë deklarative dhe shfaqin opinione të institucioneve pa imponuar marrjen e vendimeve ligjore për çështjen në fjalë.
- *Veprime të përbashkëta* (për politikën e jashtme të përbashkët dhe sigurisë). Këto janë të tipit ndërqeveritar dhe miratohen nga Këshilli herë unanimisht, dhe herë me shumicë të kualifikuar, dhe si rregull janë detyruese për shtetet anëtare, për të arritur objektivat e kërkuara, përveçse në rastet e vështirësive të paparashikuara.

1.3 Legjislacioni tretësor

Legjislacioni tretësor ose i ashtuquajtura legjislacioni i butë, përmban akte ligjore të cilat nuk janë detyruese nga pikëpamja ligjore, por mund të kenë një peshë të madhe nga pikëpamja politike. Si të tilla, ato mund të bëhen pararendëset e legjislacionit dytësor ose parësor, pasi vendosin standarde dhe krijojnë bazën për legjislacion të mëtejshëm detyrues. Ligjet e buta të BE mund të marrin formën e:

- *Konkluzioneve, deklaratave dhe rezolucioneve të Këshillit*,
- *Komunikimeve* nga ana e Komisionit, përfshirë udhëzime, njoftime, etj. Në të shumtën e rasteve, Komunikimet nga ana e Komisionit (COM dokumentet) janë propozime legjislative. Ndërsa në rastet e tjera janë dokumente “te bardha” ose “të gjelbra”, të cilat synojnë të fillojnë një proces konsultues për çështje të ndryshme.
- *Rezolutave të Parlamentit Evropian*,
Gjithashtu, ligji i bazuar tek rastet (case-law), është një lloj legjislacioni i krijuar nga gjykimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe nga Gjykata Evropiane e shkallës I, në përgjigje të parashtrësive të bëra nga Komisioni, gjykatat kombëtare të shteteve antare ose nga individët. Ky lloj legjislacioni nuk është shumë prezent në çështjet që kanë të bëjnë me ndihmën e jashtme, dhe për këtë arsye nuk do trajtohet më tutje.
Procedurat më të përhapura të vendimmarrjes/ligjvënies në BE, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkombëtare janë:
- *Procedura e miratimit* (nga Parlamenti Evropian), (kodi AVC) vepron për disa marrëveshje ndërkombëtare [neni 300 (3)], pranimin e shteteve të reja anëtare (neni 49 i traktatit të BE).

- *Procedura e bashkëvendosjes/bashkëvendimit* (kodi COD), mbulon bashkëpunimin për zhvillim. Kjo është bërë së fundi, procedura më e përhapur për ligjvënien dhe që vë në kushte të barabarta Këshillin dhe Parlamentin Evropian.
Rolet e Institucioneve kryesore të BE, lidhur me marrveshjet për ndihmën e jashtme janë përmbledhtas si më poshtë:
- *Këshilli*, nënshkruan në emër të KE marrëveshje ndërkombëtare midis KE dhe një ose më shumë shteteve të tjera ose organizatave ndërkombëtare, përcakton politikën e jashtme të përbashkët dhe të sigurisë në emër të BE, sipas udhëzimeve të dhëna nga Këshilli Evropian,
- *Komisioni* përfaqëson KE dhe në emër të tij negocion marrëveshjet ndërkombëtare me shtetet jo-anëtare dhe organizatat ndërkombëtare, në bashkëpunim me komitetet e veçanta të ngritura nga Këshilli, brenda hapësirave negociuese të përcaktuara prej tij. Komisioni ka gjithashtu për detyrë të ndjekë zbatimin e marrëveshjeve dhe manaxhimin e fondeve përkatëse. Mund të thuhet se Komisioni ka për gjithshka nismën kryesore ligjvënëse për të propozuar akte ligjore për miratim. Këto propozime duhet të mbrojnë interesat e BE dhe qytetarëve të tij, dhe jo ato të vendeve ose industrive të caktuara. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit, Komisioni propozon veprime në nivel BE vetëm kur konsideron se problemi nuk mund të zgjidhet në mënyre më efektive duke ndërmarrë veprime në nivel kombëtar, rajonal ose lokal.

3. Përfundime dhe reflektime

“Sot, BE përballlet me përgjegjësi dhe sfida globale. BE është blloku më i madh tregtar në botë, donatori më i madh i ndihmës humanitare dhe asaj për zhvillim, dhe një pikë reference e përhershme për të tjerët përsa i përket stabilitetit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.” (European Commission - Development - relations with Delegations, http://ec.europa.eu/development/how_relations/reldels_en.cfm)

1. *Kuadri ligjor i KE, nëpërmjet Traktateve i ka hapur rrugën dhënies së fondeve për të mbështetur fillimisht territoret dhe vendet e asociuara me shtetet anëtare.*

Fillimisht, ndihma e jashtme e BE (atëhere KEE) ka synuar mbështetjen e vendeve (ish)koloni të shteteve anëtare, duke krijuar premisat për asocjimin e tyre me KEE. Kjo është reflektuar edhe në karakterin jashtë-komunitar të buxhetit të Fondit Evropian të Zhvillimit, të krijuar si instrument për të realizuar lëvrimin e ndihmës mbi bazën e kontributeve vullnetare individuale të shteteve anëtare.

- *Traktati themelues i lë KE vetëm një rol plotësues të ndihmës në lidhje me atë të shteteve anëtare, duke pranuar veprimin e parimit të subsidiaritetit në ndihmën për zhvillim.*

Premisat politike kanë qenë të njëjta: të përdoret KE si një instrument për të dërguar një ndihmë kolektive për vendet në zhvillim, por duke ruajtur edhe këtu, krahas ndihmave individuale, mundësitë për të influencuar ndihmën e tij sipas interesave politike e strategjike të shteteve anëtare. Më pas, perspektiva praktike e asocjimit është dobësuar, dhe ndihma është shtrirë për vende me situata të ngjashme, është njohur sovraniteti i vendeve ish-koloniale, duke u lënë atyre më shumë rol në hartimin e marrveshjeve dhe caktimin e prioriteteve.

Koncepti i asocjimit, duke marrë parasysh kushtet reale të vendeve marrëse, ia ka lënë gradualisht vendin konceptit të mirëfilltë të zhvillimit, duke reflektuar edhe ndryshimet brenda vetë KE, që kanë shkuar në favor të homogjenizimit të tij dhe politikave përkatëse, përfshirë edhe ato për marrëdhëniet me jashtë dhe zhvillimin. Një tregues për këtë është harmonizimi i instrumentave për zhvillimin e përdorura nga BE, si dhe futja e klauzolave për respektimin e të drejtave të njeriut si kusht në çdo marrëveshje, pa marrë parasysh lidhjet e mëparshme mes shteteve anëtare dhe vendeve marrëse.

- *Vetë baza ligjore e Traktateve, ka krijuar një kontradiktë midis ambicjes natyrale të BE nga njera anë, për të vepruar si një i tërë edhe përsa i përket dhënies së ndihmave, dhe nga ana tjetër, konceptit dhe mundësisë së shteteve anëtare të luajtjes së rolit të tyre të pavarur në dhënien e ndihmave, dhe vënien e KE në rolin e plotësuesit të tyre.*

Plotësimi i ndihmave të shteteve anëtare nga KE, duke e vënë atë në rolin e aktorit dytësor, ishte i mundur në fillimet e KE, kur numri i anëtarëve ishte i vogël dhe kordinimi i mundshëm. Me zmadhimin e BE dhe me shtimin e shteteve anëtare, me forcimin e buxhetit dhe strukturave të BE, si dhe njohjen e tij në botë si një aktor unik, kordinimi me politikatat e ndihmës së shteteve antare, duke marrë ato si pikë referimi apo parësore, po bëhet dhe do vazhdojë të bëhet gjithnjë e më i vështirë. Kordinimi është vërtet i mundshëm, por vetëm në drejtimin e anasjelltë, duke lejuar BE nëpërmjet Komisionit, të jetë aktori kryesor ndërsa shtetet anëtare të përpiqen individualisht për të harmonizuar dhe plotësuar ndihmat e Komisionit.

Kjo është jo vetëm e mundshme, por edhe e nevojshme, pasi Komisioni është një aktor financiarisht dhe politikisht shumë më i fuqishëm se çdo vend anëtar i veçante. Ai perceptohet gjithashtu si më neutral, gjë që është me shumë rëndësi psh. kur vjen fjala për fushat e mirëqeverisjes, demokracisë, të drejtave të njeriut, etj. Një numër shtetesh anëtare, si psh Suedia, kanë filluar tashmë ta bëjnë një gjë të tillë, duke sanksionuar në politikatat e tyre të zhvillimit, dhe duke instruktuar punonjësit e tyre të bashkëpunimit për zhvillim, të marrin si pikë parësore programet e BE, dhe të plotësojnë ato, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, si nëpërmjet Brukselit, po ashtu edhe nëpërmjet Delegacioneve përkatëse.

- *Baza ligjore e ndihmës, duhet ndoshta të rishikohet, për ta kalur bashkëpunimin ekonomik dhe atë për zhvillim, plotësisht në shtyllën e parë, ku KE ka fuqinë më të madhe vendimmarrëse.*

Deri tani ndihma për zhvillim, bie në shtyllën e parë dhe atë të dytë (CFSP/ politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë) dhe kjo situatë bëhet shkas për problemet që janë evidentuar. Baza ligjore parësore është tashmë e vjetëruar dhe nuk pasqyron BE e sotëm dhe sfidat e tij perspektive. Politikatat por edhe instrumentet e reja të ndihmës pasqyrojnë rolin unik të BE si një aktor i fuqishëm në arenën ndërkombëtare, me një individualitet politik dhe institucional gjithnjë e më të spikatur, ndonëse jo-ende krejtësisht homogjen ose të unifikuar. Neni 22, paragrafi 2, i Traktatit të BE mbas amendimit të Lisbonës shprehet se

“BE do të sigurojë përputhje mes fushave të ndryshme të veprimit të tij të jashtëm si dhe midis tyre dhe politikave të tjera.” Vija e ndarjes mes politikave të jashtme dhe marrdhënieve me jashtë, kryesisht në aspekt ekonomik, nuk ka qenë kurrë plotësisht e qartë. Megjithatë, çështjet që kanë të bëjnë më shumë me sigurinë ndërkombëtare janë konsideruar si pjesë e Politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë edhe në rastet kur ato kanë të bëjnë me bashkëpunimin për zhvillim dhe si të tilla janë kompetencë e Komunitetit.

- *BE ka përdorur gjërësisht bazën ligjore dytësore (rregulloret, vendimet, etj) brenda kuadrit të Traktateve, si një mjet apo alternativë për të unifikuar në praktikë metodat e punës, koordinimin me shtetet anëtare dhe përdorimin e Delegacioneve, si pjesë e shërbimeve të jashtme.*

BE ka vazhduar të përdorë instrumentet e vjetra apo tradicionale të ndihmës, krahas atyre të reja më të unifikuara. Përpjekjet për unifikim dhe uniformizim kanë dhënë më shumë rezultat në fushën e metodave të programimit dhe futjes së perspektivave shumë-vjeçare më afat-gjata se më parë, si dhe në krijimin e strukturave të qendëruara të zbatimit të ndihmës si EuropeAid, ECHO, etj.

Një lëvizje pozitive në këtë drejtim është edhe fuqizimi i shërbimeve të jashtme të BE, nëpërmjet reformimit ndërmjet të tjerave, të rolit dhe mandatit të Delegacioneve, si përfaqësues politik por edhe negociatorë dhe manaxhues të ndihmës së jashtme të BE. Me që ndihma e jashtme është edhe pjesë e sistemit të Politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, që i përket shtyllës së dytë të BE, dhe ku shtetet antare preferojnë të ruajnë ende një shkallë të konsiderueshme sovraniteti dhe vendimrarrjeje, parashikohet që procesi i unifikimit të politikave dhe instrumentave të ndihmës do të kërkojë kohë dhe do të ecë paralelisht me konsolidimin dhe fuqizimin e institucioneve të përbashkëta të BE-së. Prija është për shkrirjen dhe shfuqizimin gradual ose më saktë mosrinovimin e instrumentave të mëparshëm, në favor të instrumentave të reja të manaxhuara nëpërmjet Komisionit. Gjithsesi, zbatimi i sistemit të vendimarrjes në bazë shtyllash përbën një rrezik për konsistencën e marrëdhënieve të jashtme të BE, shkaktuar nga ndarja e tyre në dy

regjime ligjore traktatesh të ndryshme. Si për shkak të procedurave të vendimmarrjes, po ashtu edhe të instrumenteve të përdorura, do të mbeten të pranishme vështirësitë e kombinimit të politikës së jashtme me politikat e tjera të BE, si dhe do të mbeten fërkimet e brendshme ligjore ose së paku interpretativte. Në këtë kuadër edhe traktati i Lisbonës nuk duket t'ia ketë arritur qëllimit të plotë të unifikimit të politikës së jashtme evropiane në të njëjtin traktat me atë të gjithë politikave të tjera të BE.

Megjithëse Shqipëria është një vend kandidat për antarësimin në BE, dhe ka pavarësinë e vet ligjvënësë ndaj BE, përafrimi i legjislacionit me BE hap pas hapi, ka nisur ndjeshëm që me marrjen e statusit kandidat i mundshëm në vitin 2014, ndërkohë që detyrimi për të bërë të gjitha përpjekjet për të përqsaur legjislacionin e vendit me atë komunitar ka filluar që me hyrjen në fuqi të MSA (Zaganjori, Anastasi, Çani, Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2011, faqe 66). Po kështu, ndjehet edhe forcimi i rolit dhe mandatit politik të Delegacionit të BE në Shqipëri, sidomos në proceset madhore dhe sfiduese nëpër të cilat ka kaluar apo po kalon vendi si reforma në drejtësi, reforma e administratës publike dhe lufta kundër korrupsionit.

Lidhur me ndihmën e jashtme të BE, Shqipëria zotëron instrumentet ligjore përkatëse për të mundësuar një bashkëpunim efektiv. Sfidat e vërtetë për të përthithur më mirë ndihmën e ofruar, më tepër se në aspektet ligjore, qendron në nevojën e forcimit të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore të qeverisë dhe agjensive të saj, të cilat janë përfituese direkte të kësaj ndihme, por njëkohësisht edhe orientuese të ndihmës që shkon për sektorë të tjerë si ai i shoqërisë civile, sektori privat, organet e drejtësisë, etj.

Bibliografia

- Wessels. Ramses A. The Impact of Lison Treaty on the Legal Competencies of the EU in Interantional Affairs. Appril 2008, Brussels.
- Lisbon Treaty at a Glance, ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/legal_bases
- Eurostep Briefing paper: “Towards a responsible Europe in the world-Briefing on the Draft Regulation on Development Co-operation and Economic Co-operation: A blank Cheque for the European Commission”, Shtator 2004, The Independent European Development portal, <http://www.developmentportal.eu/wcm/subsite/snv1v2/content/vie...>
- Sohet Karine,(Aprodev Briefing paper): “Financial Perspectives 2007-2013 and EU as a global actor: What does the proposal mean for the future? Fight against poverty or terrorism?”, Dhjetor 2004, botuar nw:[http:// www.developmentportal.eu/wcm/subsite/snv1v2/content/vie....](http://www.developmentportal.eu/wcm/subsite/snv1v2/content/vie...)
- Raymond J. Ahearn USA Congress/Foreign Affairs, Defense and Trade division, Europe’s New Trade Agenda <http://www.uscu.be/>
- European Report, EU reviews its effectiveness in external policies, 15 Maj, 2002, [http:// goliath.exnct.com](http://goliath.exnct.com)
- Mirjam Van Reisen, Simon Stocker, Florent Sebban, European Solidarity Towards Equal Participation of People Europe External Policy Advisors, European Union security concerns vs. human security, 2004 , [http://www . social atch.org/informTematicos/75/html](http://www.socialatc.org/informTematicos/75/html)
- Report on EU external assistance 2002, www.europa-eu-un.org
- European Voice 15 May 2008
- The European Union in the World, 50 years stories of solidarity, News papper published by the European Commission. [http:// ec.europa.eu/world/index_en.htm](http://ec.europa.eu/world/index_en.htm)
- Eurpean Commission, Annual report 2007, on the European Community’s development policy and the implementation of

- external assistance in 2006. Publications office, publications.europa.eu
- Report from the Commission to the Council and the European Parliament, Annual report 2008 on the European Community's development and External Assistance policies and their implementation in 2007, (COM (2008) 379), Brussels, 23.06.2008
 - EC External assistance : UN Security Council resolution 13 73, EC External assistance facilitating the implementation of UN Security Council Resolution 13 73: an overview, Brussels, 25 shkurt 2002, Ref:EC02-032EN, http://www.europa.-eu-un.org/articles/en/article_1230_en.htm
 - Guide to Funding and Participation in European Union programmes –Section 3, http://www.osi.hu/brussels/guide2001/funding_section_03.html
 - EU FTA MANUAL, Briefing 2, Inside the European Union Trade Policy, Shkurt 2008, <http://www.christianaid.org.uk/FTA/FTA%2002%20Inside%20Final.pdf>
 - Alesandra Lang, Coherence between EU Development Policy and other External policies, Romë 4-5 prill 2003, Seminar on “Capacity and Actor building: Which Instruments and Institutions does the EU need to enhance its capacity to act with regard to its trade, economic Cooperation and Foreign, Security and defence Policy? Instituto Affari Internazionali, Sponsored by the European Commission.
 - WELCOME EUROPE© 2007, Eurofunding International Cooperation Guide, Extracts for applicants programme sheets.
 - Towards a responsible Europe in the world, Briefing on the Draft Regulation on Development Co-operation and Economic Cooperation, A blank cheque for the European Commission?, shtator 2004, Eurostep, www.eurostep.org
 - Marcin Pietrzak, Johar Arifin, Brian Ward, The EU as global player and partner, 09,12,2002. Potsdam University, Gjermani
 - Nielson, P. (2001) A new focus and a better organization for the European Communities' Development Cooperation, Brussels, European Commission...pdf

- Stephen Brobbey; Lijuan Zhang, Reform of EU administration, 16, 12, 2002. Potsdam University, Gjermani, Joint workshop with the Federal Ministry for Economic Cooperation and development
- Communication to the Commission on the Reform of the management of the External Assistance, 16 maj, 2000, Rev 8
- Communication from the Commission to the Council and the European Parliament: On the Instruments for External Assistance under the Future Financial Perspective 2007-2013, Brussels, 29.9.2004, COM (2004) 626 final
- Communication from the Commission to the Council and the European Parliament. External Actions through Thematic Programmes under the Future Financial Perspectives 2007-2013, Brussels, 3.8.2005 COM (2005) 324 final
- Iva zajmi: http://.ajls.org/doc/7_Izajmi_Takimi_V_Autonomia_Ligjit_Komunitar.pdf
- Aurela Anastasi, Xhezair Zaganjori, Eralda Methasanai (Çani): Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2011. http://.kas.de/f/doc/kas_22897-1522-33-30.pdf?110527101932

VEPRA PENALE E FALIMENTIMIT TËPROVOKUAR NË TË DREJTËN PENALE TË EKONOMISË

Msc. Agathi NANO

I. Hyrje

Historikisht, qëllimi i legjislacionit të falimentimit ka qënë të garantojë një sistem nëpërmjet të cilit, kreditorët e një debitori insolvent mund të realizonin plotësisht ose pjesërisht pretendimet e tyre në një mënyrë të organizuar dhe korrekte.

Nga praktika, shpesh herë, konstatohet se ekzekutimi i këtij detyrimi është jo efikas dhe në përgjithësi nuk arrihet vetë qëllimi i së drejtës së falimentimit, që është trajtimi i barabartë i kreditorëve që një debitor ka. Për më tepër, debitorët mospërbushës pengojnë ekzekutimin duke fshehur të ardhurat e tyre ose duke bërë që atotë mos konfiskohen ose shiten nga autoritetet ekzekutive ose në mënyra të tjera, të cilat do të analizohen në këtë punim.

Legjislacioni i falimentimit, në fakt duhet të synojë krijimin e një sistemi falimentimi adekuat duke vendosur, ndër të tjera, asetet e debitorit që është në gjendjen e paaftësisë paguese nën kontrollin e një administratori të besuar ose administratori¹ të caktuar nga gjykata e falimentimit dhe kreditorët, nëpërmjet një komiteti të kreditorëve², mund të realizojnë të drejtat e tyre monetare.

Është mëse e qartë se, në të gjitha shtetet që kanë ekonomi shumë të zhvilluara, procedura e falimentimit luan një rol të rëndësishëm. Si kreditorët, ashtu edhe debitorët e shikojnë atësi një mekanizëm ligjor

1 Shih nenin 18/1 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9919, datë 19.5.2008 dhe Ligjin Nr.10 137, datë 11.5.2009 (Ligji i Falimentimit)

2 Për më shumë detaje, shih nenin 54 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9919, datë 19.5.2008 dhe Ligjin Nr.10 137, datë 11.5.2009 (Ligji i Falimentimit)

të rëndësishëm, i cili vihet në lëvizje pasi marrëdhënia debitor-kreditor fillon të hasë vështirësi.

Sigurisht, në Shqipëri, implemetimi i një sistemi të tillë të zhvilluar diktohet nga një sërë faktorësh³, e konkretisht:

1. Sistemi gjyqësor duhet të ndërgjegjësohet mbi dobitë e zbatimit të këtij legjislacioni në ekonominë shqiptare.
2. Kreditorët duhet të kuptojnë rolin e zbatimit të këtij ligji në mbrojtjen e interesave të tyre të cilat çënohen për shkak të paafëtisë së paguese të debitorit.
3. Roli i administratorit duhet të kryhet nga persona të aftë dhe kompetentë. Mbi të gjitha, publiku duhet të ketë besim në drejtësinë dhe efektshmërinë e sistemit.
4. Kujdestari *super partes* është diktuar nga nevoja për të shmangur që debitori sipërmarrës insolvent të marrë me mashtrim një pjesë ose të mirat në tërësi që mbeten nga pasuria e falimentimit, të cilat janë të nevojshme për të kënaqur nevojat e kreditorëve, për të ruajtur pasurinë ose disponueshmërinë.

II. Vështrim i përgjithshëm i falimentimit

Sistemi i kreditimit luan një rol të rëndësishëm në ekonominë moderne të tregut, veçanërisht në ekonominë të zhvillim si ajo shqiptare. Pa të, rritja dhe zgjerimi i ekonomisë dëmtohen seriozisht, çka sjell domosdoshmërinë e nxjerrjes nga qarkullimi civil i subjekteve në krizë kur vazhdimësia e aktivitetit të tyre do të çënonte vetë ecurinë e saj. Megjithatë, kur shoqëritë tregtare ose personat fizikë mbingarkohen me kreditime, të ndikuar edhe nga kriza globale, duke bërë të pamundur pjesëmarrjen e mëtejshme të tyre në një veprimtari ekonomike, është e rëndësishme që të vihen në lëvizje mekanizmat ligjorë për të zgjidhur këtë problem.

Falimentimi është një institut juridik i cili bën pjesë në kategorinë e së drejtës tregtare që rregullon pushimin e veprimtarisë së një shoqërie tregtare e prekur nga një paqëndrueshmëri ekonomike. Nëpërmjet

3 *Manuali mbi ligjin shqiptar për Falimentimin*, Ronald C.C. Cuming, Yair Baranes, Shtëpia Botuese Maluka, viti 2013, f. 16.

ndërhyrjes së pushtetit gjyqësor, sipërmarrësi insolvent “shpronësohet” nga pasuria e tij duke mundësuar kështu përbushjen e detyrimeve që ai ka ndaj kreditorëve të tij.

A. Fillimi i procedurës së falimentimit

Hapja e procedurës së falimentimit bëhet me vendim të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori, në cilësinë e një personi juridik, ka vendbanimin ose selinë në momentin e deklarimit të falimentimit⁴. Sigurisht, kjo procedurë e inicuar në territorin e Republikës së Shqipërisë mbulon gjithë pasuritë e debitorit në çdo shtet që ato ndodhen⁵.

Marrja e një vendimi të tillë pas sjell prishjen e shoqërisë tregtare, pasi me hapjen e një procedure të tillë, shoqëria nuk mund të vazhdojë me aktivitetin tregtar.

Një alternativë e vendimit të gjykatës është dhe rrëzimi i kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak se debitori nuk ka pasuri për të mbuluar shpenzimet e këtij procesi. Në këtë rast ligji ka parashikuar se personi juridik, shpërndahet ditën kur vendimi merr formë të prerë.

Gjithashtu, legjislacioni i falimentimit parashikon shkaqet, të cilat mund të çojnë një subjekt në hapjen e një procedure falimentimi, të tilla si:

- a) Paaftësia paguese⁶;
- b) Mungesa e likuiditeteve apo bllokimi i pagesave;
- c) Paaftësia paguese në një të ardhme të afërt⁷;

4 Neni 3 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

5 Neni 278 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

6 Neni 13/2 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar, parashikon se debitori quhet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet e tij në datën e maturimit. Kjo situatë kolapsi ekonomik konstatohet kur 1. Ekzistojnë detyrime të njohura të tij ndaj kreditorëve; 2. këto detyrime të jenë maturuar; 3. ai të mos i përbushë në kohë dhe tërësisht këto detyrime; 4. ai të mos ketë mjete paguese për këto detyrime për një kohë të gjatë dhe kjo të jetë një gjendje permanente, në kushtet e mosrealizimit të përgjithshëm të pagesave, jo vetëm i një pagese.

7 Neni 13/3 i ligjitnr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar, parashikon se Debitori ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese në një të

d) Mbingarkesa me borxhe⁸.

B. Kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit

Ligji i falimentimit përcakton se subjekt i procedurës së falimentimit mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo shoqëri e thjeshtë me paaftësi paguese.

Nga procedura e falimentimit janë të përjashtuar shteti ose institucionet e tij apo njësitë e qeverisjes vendore si në rastin kur institucionet shtetërore apo organet e qeverisjes vendore krijojnë detyrime, duke ushtruar kompetencat e tyre ekzekutive ashtu sikurse edhe kur kanë hyrë në marrëdhënie juridiko-civile me karakter tregtar.

Nga ky konstatim i përgjithshëm gjejnë përjashtim ato shoqëri tregtare, kapitali i të cilave zotërohet nga shteti, të cilat për shkak se gëzojnë një personalitet juridik të pavarur, mund t'i nënshtrohen procedurës së falimentimit sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, i ndryshuar.

Ndër të tjera, falimentimi i bankave dhe institucioneve të tjera financiare, për shkak të specifikave që ka ky sektor, realizohet sipas ligjeve të veçanta⁹.

Gjithashtu, në nenin 14 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar, parashikohen subjektet të cilët gëzojnë të drejtën për të kërkuar hapjen e procedurave të falimentimit.

Një ndër këto subjekte është sigurisht, debitori, i cili kur konstaton një nga rrethanat, të cilat janë kusht për falimentimin e një personi juridik, ka

ardhme të afërt, kur nuk është në gjendje të paguajë ose të shlyejë detyrimet që ka në datën e maturimit. Si rrjedhojë ndodhemi para një situatë të tillë kur debitori ka detyrime të pamaturuara dhe të njohura të tij ndaj kreditorëve dhe këto detyrime debitori nuk është në gjendje ti përmbushë tërësisht kur ato të maturohen dhe mbi të gjitha kjo gjendje e pamundësisë së tij të jetë permanente dhe të mos ekzistojë asnjë mundësi që ai të dalë prej saj

8 Neni 13/4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar, parashikon se: Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë

9 Shih nenin 12 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar

të drejtën dhe detyrimin¹⁰ që të paraqesë pranë seksionit tregtar të gjykatës së vendit ku ka selinë, kërkesën për fillimin e procedurave të falimentimit.

Të drejtën për të kërkuar¹¹ hapjen e një procedure falimentimi për pasurinë e një personi juridik e gëzon çdo kreditor¹², anëtarët e organit drejtues ose edhe çdo ortak i thjeshtë ose likuidator, në rastin e shoqërive të thjeshta¹³ si edhe organet tatimore¹⁴.

Që nga data e hapjes së procedurës së falimentimit, debitorit i hiqet e drejta edisponimit të pasurive që përfshihen në masën e falimentimit si edhe ai nuk mund të kryerjëasnjë veprim që ka ndikim në masën e falimentimit, sepse është absolutisht i pavlefshëm. Për këtë arsye, gjykata emëron administratorin e përkohshëm¹⁵ të falimentimit që administron masën

10 Sipas nenit 15 ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar, bashke me kërkesën për falimentimin duhet të paraqesë a) listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi, ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë; b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre.

11 Referuar pikës 3, nenit 16 të ligjitnr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar, Kur ortakët ose aksionarët e shoqërisë kanë pasur gjatë veprimtarisë dijeni për paaftësinë paguese të shoqërisë dhe nuk kanë paraqitur në seksionin tregtar të gjykatës kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit, brenda një afati prej 3-muajsh, nga dita në të cilën ata kanë pasur dijeni, janë personalisht përgjegjës dhe dënohen nga autoritetet fiskale me gjobë nga 200 000 deri në 500 000 lekë. a) listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi, ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë; b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre.

12 Shih nenin 120 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

13 Shih nenin 16 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

14 Shih nenin 14 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar

15 Shih nenin 18 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar

e falimentimit dhe ndër të tjera të vlerëson dhe verifikon nëse është real shkak për hapjen e procedurës së falimentimit, apo jemi përpara realizimit të atyre veprimeve ose mosveprimeve të cilat diktojnë konsumimin e veprës penale të “Falimentimit të provokuar”.

C. Masa e falimentimit

Me fillimin e procedurës së falimentimit duhet të përcaktohet edhe masa e falimentimit¹⁶, objekt procedure, në të cilën përfshihen të gjithë pasuritë dhe të drejtat qëdebitori ka në datën e hapjes së procedurës së falimentimit si dhe ato pasuri që ai fiton gjatë zbatimit të kësaj procedure¹⁷.

Veçoria bazë dhe më e rëndësishme e procedurës së falimentimit është pikërisht masa e falimentimit, e cila përbën burimin e vetëm të përmbushjes të pretendimeve të kreditorëve të falimentimit dhe nëse kjo masë nuk mbulon shpenzimet e procedurës, gjykata vendosë rrëzimin e kërkesës për deklarimin e falimentimit¹⁸.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se në këtë masë nuk përfshihen ato sende të cilat nuk janë objekt për ekzekutimin e detyrueshëm, parashikuar nga neni 529 i Kodit të Procedurës Civile¹⁹.

16 Shih nenin 119 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

17 Shih nenin 33 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

18 Shih nenin 18 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

19 Përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit: 1. sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiljet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre; 2. ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj; 3. dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë; 4. librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij; 5. deri 3 dynmë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale; 6. ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë

D. Hyrje në veprën penale të falimentimit të provokuar

Është e kuptueshme që sipërmarrësi mund të tjetërsojë të mirat të cilat i janë besuar nga kreditorët edhe duke ndryshuar vetë objektin e veprimtarisë tregtare që ushtron, për shëmbull, kompania e sotme e petroliferit Shell²⁰ ishte në gjenezën e saj një shoqëri tregtare që sillte guaska nga india (Lindja e Largët), çka edhe sot ka mbetur simboli i kësaj shoqërie.

Për shkak të aktivitetit tregtar si edhe faktorëve të ndryshëm ekonomiko-financiar, sipërmarrësi mund të mos jetëmë në gjendje të përballojë me sukses detyrimet që ka.

Situata e deficitit në të cilin ndodhet debitori mund të provohet vetëm nëpërmjet dokumentacionit përkatës, librave dhe shkresave kontabël, tëmbajtura në mënyrë korrekte dhe të qarta për të pasqyruar vetë historinë financiare tëshoqërisë tregtare.

Vetëm nëpërmjet dokumentacionit kontabël është e mundur që kreditorët, në rastin e mospërmbylljes së detyrimeve nga ana e debitorit, do të mund të njohin shkakun e dëmit të pësuar si edhe të përcaktohet se cilat janë ato veprime ose mosveprime me faj të sipërmarrësit-debitor që kanë çuar në dëmtimin e interesave të tyre pasurore.

Vepra penale e Falimentimit të provokuar bën pjesë në atë kategori veprash penale për të cilat ndjekja penale fillon kryesisht ex officio nga ana e organit të ndjekjes penale pa qënë e nevojshme ankimi i të dëmtuarit²¹.

Falimentimit i provokuar konsiston në njëserë veprimesh të kryera me dashje (mashttrim i drejtpërdrejtë për të përkeqësuar ose shkaktuar paaftësinë paguese dhe për të cënuar/shkelur interesat e kreditorëve), të cilat sjellin si pasojë falimentimin e atyre subjekteve të përcaktuar në nenin

ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës; 7. frutat natyrore një muaj para se ato të piqen. 8. Sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës

20 <http://www.shell.com/about-us/who-we-are/our-beginnings.html>

21 Shih nenin 284 të Kodit të Procedurës Penale

11 të Ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

Ndërkohë, legjislacioni italian parashikon tiplogji të ndryshme të veprës penale të falimentimit, të cilat mund të kryhen edhe nga pakujdesia, si formë faji (Falimentimi i thjeshtë) dhe me dashje, duke synuar përkeqësimin ose shkaktimin e paaftësisë paguese dheshkelur interesat e kreditorëve, parashikuar nga një normë juridike e aprovuar në Dekretin Mbretëror, datë 16 mars 1942²².

Termi “falimentim i provokuar” ose njohur si *bancae ruptio*, në mesjetë, fr. *banqueroute*; sp. *quiebra*; gjerman. *Bankrott*; angl. *Bankruptcy*, vjen nga përdorimi gjenovez në periudhën mesjetare “*thyerja e tryezës ose arkës prej druri të bankierit*²³ në gjendje të paaftësisë paguese”, e shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e tregtarit. Në mesjetë, të gjithë të falimentuarit konsideroheshin *decoctus, ergo fraudator*.

Karakteristike e konfigurimit të kësaj figure vepre penale është ekzistenca e një vendimi gjyqësor të shpalljes së falimentimit dhe gjatë këtij procesi gjyqësor provohet:

a) cilësia e tregtarit (duke qenë se subjektet kanë ushtruar një veprimtari ekonomike- tregtare);

b) ndalimi i kryerjes së pagesave (*eventus damni*);

c) deklarata gjyqësore e mosrealizimit të pagesave, dhënë nga gjykata e vendit ku subjekti tregtar ka selinë kryesore.

d) Dashja, si formë e anës subjektive, për kryerjen e këtyre veprimeve, duke përjashtuar ato të cilat janë rezultat i veprimit të forcës madhore ose veprimeve të rastit.

- Çfarë nënkuptohet me pasuri, objekt material i veprës penale të Falimentimit të provokuar?

Në pasuri, objekt material i kësaj vepre penale, bëjnë pjesë të drejtat reale dhe pasurore, siposedimi, e drejta e kreditit, pritsmëritë bazuar në

22 Për më shumë detaje, shih: Ligjin e Falimentimit, Drektori Mbretëror, datë 16 mars 1942, n. 267 “*Disiplina e Falimentimit, administrimit të kontrolluar, dhe të likuadimit*”. Testi i azhornuar me Dekret- Ligjin e 3 maj 2016, n. 59 (Në fletoren zyrtare 03/05/2016, n.102), dhe ligji i datës 30.06.2016 me nr. 119 (Fletore zyrtare 02/07/2016, n. 153)

23 <http://www.treccani.it/vocabolario/bancarotta>

aktet juridike (p.sh. akte të mundura për të arritur një financim ose një prokurim publik), e drejta e opsionit, hipoteka, pengu, sekuestroja, të mirat në leasing, të dhënat informatike, e drejta e parablerjes²⁴, etj.

Objekti material i falimentimit të provokuar përcaktohet në raport me detyrimet e debitorit, detyrime këto të karakterit ekonomik. Sigurisht, që sipërmarrësi mund të tjetërsojë të mirat e dhënë nga kreditori por pa dëmtuar interesat e kreditorëve.

Si rrjedhojë, cënimi i garancisë së kreditorëve përcakton edhe kufirin mes aktivitetit të ligjshëm dhe të paligjshëm dhe atë të konsumimit të veprës penale të falimentimit të provokuar.

Nga kjo premisë e karakterit të përgjithshëm rrjedh koncepti i quajtur privatist i falimentimit të provokuar kundrejt atij publicistik sipas së cilës dëmton ekonominë publike, ushtrimin e rregull të tregtisë dhe administrimin e drejtësisë²⁵.

III. Ana objektive e veprës penale të “Falimentimit të provokuar”

Vepra penale e “Falimentimit të provokuar” bën pjesë në kategorinë e atyre figurave relativisht sintetike dhe aspak analitike. Në një nen të vetëm, në të cilën nuk reflektohen detaje lidhur me elementet objektive të kësaj figure, legjislatori përpiket të parandalojë çdo formë që do të conte me dashje në cënimin e interesave të kreditorëve.

Neni 193 i Ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar, parashikon se :

Çuarja me dashje e personit juridik në gjendjen e falimentimit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Nga analiza juridike e kësaj figure evidentohen karakteristikat kryesore të saj:

- Objekt i kësaj vepre penale është marrëdhënia juridike e vendosur për të mbrojtur pasurinë dhe ekonominë në tërësi si edhe të drejtat e kreditorëve në veçanti nga veprime ose mosveprime të kundraligjshme.

24 Për më shumë detaje, shih vendimin unifikues 23, 01.04.2002 të Gjykatës së Lartë

25 Ubaldo Giuliani- Balestrino “*Bancarotta Declaratoria e giudicato fallimentare*”, Giuffrè Editore, f. 18

- *Conditio Iuris*, i kësaj figure është deklarimi i falimentimit të subjektit aktiv, element thelbësor i kësaj vepre, çka ndërlidhet me elementin kohë, pasi konsumimi i veprës penale mund të realizohet vetëm pas deklarimit të falimentimit.

Një shembull tipik i konsumimit të kësaj vepre penale është kur administratori i një shoqërie tregtare me dashje fsheh të mirat e shoqërisë dhe më pas deklaron falimentimin e saj.

Si rrjedhojë, është e qartë se çdo subjekt aktiv përgjigjet penalisht, nëse pas deklarimit të falimentimit, kryen me dashje veprimet e mëposhtme:

1. Zhvatja, fshehja²⁶, shkatërrimi, shpërndarja në tërësi ose pjesërisht i pasurisë së tij në mënyrë që të shkaktojë dëm të kreditorët, krijimi²⁷ ose njohja e pasiveve që nuk ekzistojnë në dëm të kreditorëve si edhe simulimi i veprimeve juridike siç ndodh shpesh kalimi i pronësisë në mënyrë fiktive në favor të të tretëve, duke bërë që pasuria de juro është në duar të personave, të ndryshëm nga i falimentuari, çka e përjashton atë nga masa e falimentimit.

Nëpërmjet një analize krahasimore me legjislacionin italian, konstatohet se në Drekretin Mbretëror, n. 267 datë 16 mars 1942, të azhornuar, parashikohen edhe forma të tjera të kësaj vepre penale. Këto tipologji janë si mëposhtë:

a. Përpara nisjes së procedurës së falimentimit, sipërmarrësi shkatërron ose falsifikon shkresat kontabël ose çdo dokumentacion tjetër financiar lidhur me aktivitetin tregtar në mënyrë të tillë që rezulton e pamundur të përcaktohet gjithë veprimtaria ekonomiko- financiare e realizuar. Gjithashtu, sipërmarrësi, i cili në kundërshtim me legjislacionin financiar mban librat e detyrueshëm, regjistrat për mbajtjen e TVSH

26 Fshehja mund të realizohet edhe përmes fshehjes së dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e pasurisë në duart e të falimentuarit, apo edhe përmes mosveprimeve të subjektit aktiv, i cili nuk i komunikon administratorit të falimentit ekzistencën e aseteve të caktuara.

27 Rasti më tipik i krijimit të pasiviteve jo ekzistues është krijimi i një kontratë fiktive qiraje në favor të një të treti e garantuar nga një e drejtë reale si hipoteka.

dhe shkresat e tjera kontabël ose përpilon bilancet në kundërshtim me parashikimet ligjore duke bërë të pamundur ose të vështirë rindërtimin e “historisë” së veprimtarisë financiare. Në këtë rast jemi para konsumimit të veprës penale të Falimentimit shkresor me dashje, parashikuar nga neni 216 i Drekretit Mbretëror Italian, n. 267 datë 16 mars 1942.

b. Falimentimi i thjeshtë pasurore²⁸ realizohet në ato raste kur subjekti ka kryer shpenzime personale apo familjare, jo objektive dhe të tepërta për shkak të gjendjes së tij ekonomike, dhe konkretisht:

1. Sipërmarrësi duhet të kuptojë se nuk po redukton vetëm pasurinë e tij por edhe të konceptojë dëmtimin real që po i shkakton të drejtave që gëzojnë kreditorët e tij. Nëse dëmtimi është real dhe serioz atëherë ai duhet të shmanget nga kryerja e këtyre veprimeve.

2. Sipërmarrësi kryen transaksione të pakujdesshme për të vonuar falimentimin;

3. Sipërmarrësi ka rënduar paqëndrueshmërinë e tij ekonomike duke mos kërkuar shpalljen e falimentimit apo me një formë me faj të rëndë;

4. Sipërmarrësi nuk ka përmbushur detyrimet e marra përsipër në një marrëveshje të mëparshme me kreditorët ose gjatë një procedure të mëparshme falimentimi.

c. Falimentimi i privilegjuar, i konsideruar edhe si “favorizim i kreditorit”, konsiston në njohjen dhe përmbushjen e detyrimit që debitori ka vetëm në favor të një pjesë të kreditorëve, në dëm të të tretëve ose duke stimuluar tituj preferencial, duke cënuar kështu parimin «*par condicio creditorum*», sipas së cilës kreditorët kanë të drejtë të konkurrojnë në mënyrë të barabartë për të realizuar të drejtat e tyre në masë të njejtë nga pasuria e debitorit.

Referuar legjislacionit tonë të falimentimit, në nenin 35 specifikohet

28 Shih nenin 217 të Drekretit Mbretëror, n. 267 datë 16 mars 1942, i përditësuar.

se kreditorët e siguruar²⁹, gëzojnë të drejtën e ripagimit të veçantë³⁰, duke qëndruar kështu në një rend preferimi më lart se kreditorët e tjerë, madje edhe nga ata të privilegjuar.

Kjo skemë preferimi, siç përcaktohet edhe në nenin 605 të Kodit Civil është e rëndësishme në ato raste kur vlera e aktiveve të pasurisë së debitorit nuk është e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha detyrimet e pashlyera të tij duke i dhënë përparësi pretendimeve të kreditorëve të siguruar dhe të pasiguar për mundësinë e përmbushjes së pretendimeve të tyre nga masa e falimentimit.

Pra, shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe shpenzimet e tjera administrative qëndrojnë në rendin më të lartë të preferimit në listën e detyrimeve që duhet të përmbushen dhe shlyhen nga masa e falimentimit para pretendimeve të kreditorëve të tjerë të falimentimit³¹.

Jurisprudenca italiane, ndër të tjera thekson se edhe pagesat virtuale janë veprime të cilat mund të çojnë në falimentimin e provokuar. Në fakt, këto operacione ndryshojnë raportin debi-kredi dhe ndikojnë në bilancin/pasqyrat financiare të shoqërisë³².

IV. Subjekti Aktiv

Sikurse, analizuan më sipër, me anë të vendimit deklarativ të falimentimit verifikohet paaftësia paguese e debitorit dhe sigurohet një mbrojtje adekuatë e të gjithë kreditorëve, përtej gjendjes ekonomike në të cilën ndodhet debitori.

29 Neni 35, Kreditorët e siguruar 1. Kreditorët, që nëpërmjet një veprimi juridik, kanë vendosur barrë sigurouese mbi sendin ose në bazë të ligjit kanë fituar një të drejtë mbi sende të masës së falimentimit, si mjet sigurimi për pretendimet e tyre, kanë të drejtë të realizojnë shlyerjen e detyrimit nga kolaterali, në përputhje me dispozitat e zbatueshme jashtë procedurës së falimentimit, por duke iu nënshtruar përjashtimeve të pikës 2 të këtij neni dhe neneve 133 e në vazhdim të këtij ligji.

30 Shih nenin 41 të Ligjit nr.8901, dt 23.05.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

31 Shih nenin 36, ligji nr.8901, dt 23.05.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

32 Shih vendimin nr. 37107, datë 23.09.2009 të Gjykatës së Kasacionit, Seksioni Penal, Itali

Sipas nenit 11 të Ligjit të Falimentimit, subjekt i kësaj procedure mund të jetë çdo person fizik ose juridik, si dhe për pasuritë e shoqërive të thjeshta, duke përfshirë shtetin ose një organ të tij, sektorë të caktuar si strategjikë, njësitë e qeverisjes vendore dhe organet e tyre si edhe bankat dhe institutet e tjera financiare të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

Bazuar në një vështrim krahasues, subjekte të procedurës së falimentimit ndryshojnë në varësi të legjislacioneve të vendeve të ndryshme, dhe konkretisht:

- Sipas nenit 2221 të Kodit Civil³³ të Republikës Italiane, sipërmarrësit, përveç enteve publike dhe tregtarëve të vegjël, janë subjekte të procedurës së falimentimit;

- Çdo³⁴ person juridik, përveç agjencisë qeveritare; ndërmarrjes në pronësi shoqërore ose ndërmarrjes në pronësi publike, siç përcaktohet në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/12 “*Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit*”, “*Siguruesit të pensionit*” siç definohet në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/13 “*Mbi Pensionet në Kosovë*”; Një “*Kompanie të sigurimit*” ose “*ndërmjetësi të sigurimit*” siç definohet në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/15 “*Mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësve të Sigurimit*”, ose “*Institucionit financiar*” siç definohet në Rregulloren Nr. 2001/24 “*Ndryshimet e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20 Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës*”.

- Sipas legjislacionit francez³⁵ janë subjekte tregtar, çdo person juridik, jo personat fizik.

- Në Mbretërinë e Bashkuar³⁶ lejohet kushdo të deklarojë falimentimin por parashikohet një procedurë e ndryshme për debitorët civilë, ata që zhvillojnë apo jo aktivitet tregtar, duke përfshirë këtu

33 Kodi Civil i Republikës Italiane, (Dekreti mbretëror nr. 262 datë 16 mars 1942, n. 262), modifikuar me dekret-ligjin nr. 180 datë 16 nëntor 2015.

34 Shih nenin 4 të ligjit nr. 2003/4 “Për likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Falimentim”

35 <http://piazzettamonte.dobank.com/iv-trimestre-2009-i-trimestre-2010/le-procedure-concorsuali-secondo-il-diritto-francese>

36 <http://www.legislation.gov.uk/ukpga/1986/45/contents>, Insolvency Act 1986

personat fizikë dhe procedurë tjetër për shoqëritë me personalitet juridik.

Karakteristikë thelbësore e kësaj vepre penale “*delictum proprium*” është natyra kualifikuese, pra karakteristikat e veçanta që duhet të gëzojë subjekti i posaçëm.

Në lidhje me subjektin aktiv, norma penalo-juridike ka parashikuar jo vetëm një figurë specifike si ajo e debitorit por edhe subjekte të tjerë që në bashkëpunim mund tërealizojnë këtë vepër penale.

Si rrjedhojë, subjekte të kësaj vepre penale janë gjithashtu, administratori, drejtorët e përgjithshëm, likuiduesit e shoqërive të deklaruara në falimentim.

Sipërmarrësi i fshehtëmund të jetë, gjithashtu subjekt aktiv i kësaj vepre, i cili sillet dhe vepron si pronari efektiv i shoqërisë por de jure nuk shfaqet si titullar i saj. Jurisprudenca italiane ka ngritur hipotizën e një shoqërie de facto midis sipërmarrësit de juro dhe atij të fshehtë/ de facto, duke e konsideruar këtë të fundit, qoftë për qellime civile dhe penale, si një ortak me përgjegjësi të pakufizuar.

Administratori i fshehtë i një shoqërie kapitali, nënkupton atë subjekt që në fakt realizon veprime administrative edhe pse nuk shfaqet de juro si i tillë.

Në fakt, gjykata penale, duke pasur parasysh faktin që subjektet aktive të kësaj vepre janë vetëm ata të parashikuar në mënyrë eksplicite dhe jo të tjerë, si edhe duke qënë se analogjia në të drejtën penale nuk aplikohet, do të vlerësohet rast pas rasti, bazuar në rrethanat e faktit, nëse subjekti ka vepruar si sipërmarrës, si ortak me përgjegjësi të pakufizuar ose si administrator pavarësisht faktit nëse ata kanë një detyrë formale ose jo.

Një problem që mund të haset në praktikë është elementi i bashkëpunimit në këtë vepër penale. I punësuari, i cili është i lidhur me detyrimin e besnikërisë dhe bindjes në favor të punëdhënësit të tij, a mund të mbaj përgjegjësi penale?

Jurisprudenca italiane ka hasur vështirësi përballë rastit kur falimentimi i provokuar ka qënë për efekt dokumentacioni dhe konkretisht kur punëmarrësi ka keqpërdorur librat kontabël ose i ka mbajtur ato në mënyrë të tillëqë të bëjnë të pasigurt saktësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë.

Në rastin konkret, bashkëpunimi nëkëtë vepër penale provohet nëse ekzistondashja dhe vullneti nga ana e punonjësit për të bërëtë vështirë për këdo konstatimin e situatës financiare të shoqërisë.

V. Elementi Subjektiv

Konsumimi i veprës penale realizohet kur subjekti vepron me dashje dhe konkretisht me qëllimin e posacëm për të realizuar një avantazh për të, duke dëmtuar kështu interesat e kreditorëve.

Pra duhet ndërgjegjja dhe vullneti për të përmbushur veprime të kundraligjshme si pakësimi i pasurisë, shpërdorimi ose abuzimi ose fshehja e aktiveve të pasurisë së shoqërisë, e cila në një moment në të ardhmen do tëshpalli falimentimin.

Shpesh, jurisprudenca³⁷ mund të formojë bindjen e brendshme mbi konsumimin e kësaj vepre penale edhe në rastin kur sipërmarrësi është i paaftë të tregojë destinacionin e të mirave dhe të pasurisë së shoqërisë. Pra, sipërmarrësi ka barrën e provës për të vërtetuar se të mirat e pasurisë janë përdorur për një destinacion të duhur dhe në mënyrë të ligjshme.

Në këtë rast, sipërmarrësi është i ndërgjegjshëm që një veprim financiar i gabuar do të shkaktojë me siguri një pakësim të kapitalit të shoqërisë dhe si rrjedhim një situatë të mundshme debie kundrejt kreditorëve të ndryshëm.

Përfundim

Me zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe teknologjisë, rezulton se edhe veprimet ose mosveprimet e kundraligjshme, të kryera nga sipërmarrësi, të cilat mund të çojnë me dashje në falimentim, kanë ndryshuar.

Faji në formën e dashjes evidentohet edhe në rastin kur i falimentuari ka harxhuar një pjesë të konsiderueshme të pasurisë së tij në operacione

37 Lina Cusano, Sostituto procuratore della Repubblica presso il tribunale ordinario di Roma“Indagini ed attività del pubblico ministero sino alla pronuncia della sentenza nel processo per reati fallimentari” 28 nentor 2005, f. 9

të rastit ose veprime haptazi të pakujdesshme, duke përmendur këtu transaksione fiktive të realizuara në bursë, të cilat nëse janë realizuar në mënyrë të pakujdesshme përbëjnë elemente të anës objektive të kësaj figure për aq sa lidhet me pjesën më të madhe të pasurisë.

Si rrjedhojë, subjekti i cili ka pasur si qëllim shkaktim e falimentimit dhe ka kryer efektivisht shitje të objekteve nën vlerën aktuale të tregut, ose ka marrë kredi ose ka përdorur mjete të tjera shkatërruese për të prokuruar fonde, të vërtetuara këto nga gjykata e cila mund të konstatojë nëse operacionet janë kryer në gjendjen e pezullimit të pagesave, ose në qoftë se këto operacione kanë pasur si qëllim të shkaktonin falimentimin ose në të kundërt ta shmangnin atë.

Bibliografia

Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9919, datë 19.5.2008 dhe Ligjin Nr.10 137, datë 11.5.2009 (Ligji i Falimentimit)

Ligji nr.7850 datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”

Ligj nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së shqipërisë

Ligji i Falimentimit, Dekreti Mbretëror, datë 16 mars 1942, n. 267 “Disiplina e Falimentimit, administrimit të kontrolluar, dhe të likuadimit”. Testi i azhornuar me Dekret- Ligjin e 3 maj 2016, n. 59 (Në fletoren zyrtare 03/05/2016, n.102), dhe ligji i datës 30.06.2016 me nr. 119 (Fletore zyrtare 02/07/2016, n. 153)

Kodi Civil i Republikës Italiane, (Dekreti mbretëror nr. 262 datë 16 mars 1942, n. 262), modifikuar me dekret-ligjin nr. 180 datë 16 nëntor 2015.

Ligji nr. 2003/4 “Për likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Falimentim”

Manuali mbi ligjin shqiptar për Falimentimin, Ronald C.C. Cuming, Yair Baranes, Shtëpia Botuese Maluka, viti 2013, f. 16

Baldo Giuliani- Balestrino “Bancarotta Declaratoria e giudicato fallimentare”, Giuffrè Editore, f. 18

Lina Cusano, Sostituto procuratore della Repubblica presso il tribunale ordinario di Roma “*Indagini ed attività del pubblico ministero sino alla pronuncia della sentenza nel processo per reati fallimentari*” 28 nentor 2005, f. 9

Vendimi unifikues nr.23, 01.04.2002 të Gjykatës së Lartë

<http://www.shell.com/about-us/who-we-are/our-beginnings.html>

<http://www.treccani.it/vocabolario/bancarotta>

<http://piazzettamonte.dobank.com/iv-trimestre-2009-i-trimestre-2010/le-procedure-concorsuali-secondo-il-diritto-francese>

<http://www.legislation.gov.uk/ukpga/1986/45/contents>, Insolvency Act 1986

LIGJSHMËRIA E VEPRIMEVE TË AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE KOMBËTARE NË RASTET E FLUTURIMEVE “RENEGADE”

Ajet MAKSUTI¹

Hyrje

Sot në të gjithë botën, terrorizmi është përhapur si një fenomen shumë i rrezikshëm i cili cënon rendin, sigurinë, jetën, shëndetin dhe pasurinë e personave dhe të shteteve. Qëllimi kryesor i terrorizmit është që nëpërmjet krijimit të frikës dhe të pasigurisë të arrijnë përfitime politike, ekonomike etj. Terrorizmi është përdorur në kohë të ndryshme dhe në forma të ndryshme. Kështu mund të flasim për levizjet në Irlandë dhe në Izrael të cilat edhe çuan në krijimin e shtetit të Irlandës dhe të Izraelit.

Megjithatë, në kohët e sotme, terrorizmi po shfaqet një formë gjithmonë e më të rrezikshme. Në këto raste po flasim për terrorizëm ndërkombëtar. Një nga format më rënda të shfaqjes së terrorizmit është rrëmbimi i avionëve civilë dhe përdorimi i tyre për qëllime terrorizmi duke goditur objektiva të tjerë në tokë (civile dhe/ose qeveritare). Përdorimi i këtyre mjeteve ka qëllime të dyfishta. Kështu është e frikshme që në fillim rrëmbimi i avionëve të cilët kanë civilë brenda tyre. Kjo që në fillim mund të paralizojë çdo lloj tentative për kundërveprim të autoriteteve shtetërore. Nga ana tjetër ky mjet dhe këto jetë njerezish do të përdoren për të shkaktuar sa më shumë dëme dhe për të marrë sa më shumë jetë të tjera njerëzish. Në terminologjinë e huaj këto avionë quhen “renegade”.

Duke pasur në konsideratë këtë situatë mjaft delikate, identifikimi dhe reagimi i autoriteteve shtetërore është gjithmonë problematike. Qëllimi i

1 Doktorant, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës.

këtij punimi është pikërisht që të analizojë kuptimin e termit “renegade”, kalsifikimin e rasteve “renegade”, gjendjen aktuale të mëxhamimit të këtyre rasteve, ligjshmëria e vrypiemve të autoriteteve kombëtare, si edhe rekomandimet përkatëse.

I. Disa vlerësime në lidhje me kuptimin e termit “Renegade”.

Shqetësimi për një siguri të lartë në fluturimet ajrore ka qenë i hershëm për organizatat ndërkombëtare. Më 01 Shtator 1983 një avion “Boing” me numër 747-230B, i cili fluturonte nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Anchorage) në drejtim të Seul-it (Korea e Jugut) me 269 persona në bord, humbi orientimin gjeografik, duke u shmangur nga korridoret e fluturimit të bazuar në planin e miratuar. Mbas vlerësimit të situatës ai është detyruar të ulet nga dy avionë rusë SU-15 të bazës ajrore Dolinsk – Sokol në afërsi të Oqeanit Paqësor. Pas kësaj ngjarje, në vitin 1984, komuniteti ndërkombëtar vendosi të përmirësojë legjislacionin me synim shmangien e ngjarjeve të mundëshme dhe monitorimin e këtyre rasteve. Në këtë frymë u zhvillua edhe takimi i Montrealit i cili u bazua në nenin nr. 3 të Koventës së Çikagos³, artikulli i cili përcakton se: *...Shtetet kontraktuese njohin se secili prej tyre duhet ti përmbahet rishikimit të përdorimit të armëve kundra avionëve civilë në fluturim, dhe në rast kapje jetët e personave në bord dhe siguria e avionit nuk do të rrezikohen.*

Kuptimi i termit “Renegade” ka dalë në pah kohët e fundit nga platforma e veprimeve dhe taktikave terroriste të praktikuara për realizimin e qëllimeve të tyre në destinacione të përcaktuara ose “objekt interesi”. Ky kuptim, pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA, solli në vëmendjen e strukturave civile dhe ushtarake një ridimensionim të masave koordinuese dhe kundërvepruese për të ardhmen. Një situatë “Renegade” ka të bëjë me rrëmbimin e avionëve të linjave të ndryshme të kompanive të transportit civil, për t’u përdorur si armë dhe shantazh ndaj aspektit politik, ekonomik, sigurisë në të gjithë botën. Realizimi i këtyre

2 Situata kur një avion civil përdoret si armë për të kryer një sulm terrorist zakonisht është referuar si një rast Renegade.

3 Konventa e Çikagos është Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar e nënshkruar në Çikago më 7 dhjetor 1944, e ndryshuar

veprimeve ka si objekt kryesor, humbjen e besimit për një jetë të sigurt dhe të lirë në mbarë botën.

Ndodhja e një veprimtarie “Renegade” buron ose fillon në aspektin e veprimtarisë civile të menaxhimit të hapësirës ajrore. Kjo sepse mund të ndodhë në kushtet e përditëshme, rutinë të fluturimeve civile tregtare, në kushte paqësore, në të gjithë hapësirën ajrore të botës. Ndryshe nga kushtet e veprimtarisë në një situatë luftarake kur planet operationale kanë dimensionin e veprimit në kohë dhe hapësirë, ku komandim – kontrolli është i centralizuar në interes të zhvillimit të një operacioni, me objektiva të qarta në modelin e një operacioni të fushës ushtarake, veprimet renegade kanë karakteristika të veçanta. Ato ndodhin në kohë të pa përcaktuar, ku fillimi dhe përfundimi i këtij aktiviteti është në një kohë relativisht të shkurtër dhe në mënyrë të papritur, me premisa ndodhje nga çdo vend i botës ku gjendet terren i dobët sigurie.

II. Klasifikimi i rasteve “Renegade”

Klasifikimi i një rasti renegade mund të përfshijë kriteret minimale, por nuk kufizohet vetëm në një nga detyrat vijuese:

2.1 Renegade i dyshuar:

- Avion i marrë peng, por nuk janë të qarta qëllimet.
- Avionë civilë me dy ose më shumë nga kriteret e mëposhtëm:
 - a. Shmangie e tepruar nga rruga e fluturimit të miratuar;
 - b. Mos ndjekja e udhëzimit të fundit nga ATC (kontrollorit të trafikut ajror);
 - c. Ndërprerja e komunikimit;

2.2 Renegade i mundshëm:

- Çdo avion i rrëmbyer.
- Avioni i dyshuar renegade, i cili nuk ndjek udhëzimet e dhëna nga kontrollori i trafikut ajror (KTA) për t’u kthyer në rrugën e fluturimit ose refuzon përpjekjet e përsëritura për të ndërhyrë dhe kthyer në situatën normale.

2.3 Renegade i kofirmuar:

- Informacionini i disponueshëm vërteton çdo dyshim të arsyeshëm se platforma është duke u përdorur si një armë terroriste.
- Vetëm NGA (National Government Authority) mund të deklarojë një avion renegade të konfirmuar në çdo kohë.

III. Gjendja aktuale në menaxhimin e situatave “renegade”.

Aktualisht vendi ynë është antar i NATO-s dhe hapësira ajrore shqiptare është pjesë e përgjegjësisë së kësaj aleance. Bazuar në përmbajtjen e artikullit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, (Washington, 4 prill 1949), sovraniteti i kësaj hapësire është i garantuar nga cënimi i saj. Por menaxhimi i rasteve renegade nuk është përgjegjësi e kësaj aleance. Ajo siguron dhe jep informacion nëpërmjet kapaciteteve të saj për të gjitha vendet anëtare por nuk ndërhyt në procesin vendimarrës, duke e konsideruar përgjegjësi kombëtare.

Në kuadër të zhvillimeve të mësipërme, me qëllim standardizimin e procedurave në përputhje me kërkesat e NATO-s, janë miratuar disa akte ligjore midis të cilëve përmendim;

1. Ligji nr.10133, datë 11.5.2009 “Për Patrullimin e Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë”;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 13.4.2016 “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), për Patrullimin e Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë”
3. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) për patrullimin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Të tre aktet e mësipërme, mundësojnë lejimin dhe kryerjen e patrullimit në hapësirën ajrore të RSH, por në to, nuk gjejmë një parashikim për mënyrën se si institucionet e vendit do të veprojnë në rast se gjenden përpara një situatë renegade.

Vetëm marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë, e sjell në vëmendje si fenomen, duke dhënë edhe përkufizimin në pikën A.1.21, konkretisht; *Termi “RENEGADE” përdoret për të përkufizuar një platformë civile që vlerësohet se operon në një mënyrë të tillë sa për të ngritur dyshime se mund të përdoret si një armë për të kryer një sulm terrorist..⁴*

IV. Ligjshmëria e veprimeve të autoritetit përgjegjës kombëtar

Duke iu referuar legjislacionit të brendshëm, vërejmë se aktet kryesore ku mund të referojmë rastet renegade, përveç disa dispozitave të përmendur mësipër janë;

1. Kushtetuta e RSH;

2. Ligji nr.64/2014, datë 26.10.2000 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejtimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Kushtetuta e RSH, në pjesën e gjashtëmbëdhjetë të saj (nenet 170-176) të titulluar “Masat e Jashtëzakonshme“, ka përcaktuar se këto masa mund të vendosen për shkak të luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Referuar rastit tonë studimor rezultoi se situatë kur ndodhemi përballë një rasti renegade mund të përfshijë gjëndjen e luftës dhe gjëndjen e jashtëzakonshme. Sipas Kushtetutës, gjëndja e luftës mund të shpallet në dy raste:

a) në rastin e një agresioni nga jashtë. Në këtë rast gjëndja e luftës sipas nenit 171/1 të Kushtetutës shpallet nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Ministrave. Sipas neniut 172, ky dekret i dërgohet për miratim Kuvendit brënda 48 orëve, ku ky i fundit duhet të vendos me shumicën e të gjithë antarëve të tij për miratimin ose jo të dekretit për shpalljen e gjëndjes së luftës

4 (SDP, NATINADS shtojca YY, 2007).

b) në raste të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare. Sipas kësaj situatë, të parashikuar nga neni 171/2 i Kushtetutës, Republika e Shqipërisë mund të hyjë në luftime nëse ky detyrim buron nga një marrëveshje ndërkombëtare. Në këtë rast gjëndja e luftës shpallet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës.

Dallimi midis këtyre rasteve qëndron në faktin se në rastin e parë gjëndja e luftës shpallet nga Presidenti i Republikës (me propozim të Këshillit të Ministrave) për shkak të shpejtësisë së vendimmarrjes që kërkohet në rastet e një agresioni nga jashtë. Ndërhyrja e Kuvendit është e mëvonshme dhe ka thjesht efekte miratuese me fuqi prapavepruese nëse e miraton dekretin e Presidentit për shpalljen e gjëndjes së luftës (gjëndja e luftës konsiderohet e shpallur në momentin që Presidenti nxjerr dekretin dhe jo në momentin e miratimit të dekretit nga Kuvendi).

Ne rastin e dytë, duke qenë se nuk kemi të bëjmë me situatë rreziku për integritetin territorial të vendit atëherë gjëndja e luftës shpallet nga Kuvendi (me propozim të Presidentit), pasi në këto raste edhe koha në dispozicion është mëse e mjaftueshme.

Sqarojmë se në të dy rastet, Kushtetuta parashikon një procedurë e cila kërkon pjesëmarrjen e disa organeve të larta shtetërore (Kuvendi, Presidenti, Këshilli i Ministrave), reflektim ky i parimit të ndarjes dhe të balancimit midis pushteteve të sanskionuar në nenin 7 të Kushtetutës.

Duke e lidhur me rastin konkret, rezulton se një avion renegade mund të jetë si shkak si shpalljes së gjëndjes së luftës në të dyja raste. Kështu në rastin e parë, një shtet i cili mund të ketë ambicie territoriale ndaj vendit tonë ose të të influencojë vendin tonë përdor taktikën e sulmeve renegade ndaj vendit tonë. Në këtë rast shpallja e gjëndjes së luftës me këtë shtet është plotësiht e përligjur. Në rastin e dytë, mund të jemi përpara të njëjtës situatë por objekt sulmi me avione renegade është një shtet tjetër, me të cilin neve jemi në kushtet e ekzistencës së një marrëveshjeje mbrojtjeje, dhe sipas së cilës jemi të detyruar që të shpallim gjëndjen e luftës me synim realizimin e mbrojtjes së përbashkët. Kjo mund të ndodhë në kuadër të detyrimeve ndërkombëtare që ne kemi marrë në kuadër të traktatit të NATO-s.

Megjithatë kushti kryesor në këtë rast është që aktiviteti terrorist të ushtrohet nga një shtet tjetër dhe jo nga ndonjë organizatë terroriste. Pra, rasti i shpalljes së gjendjes së luftës është një mundësi e rradhe, pasi shumica e vendve nuk përdorin taktika terroiste për arritjen e qëllimeve të tyre, megjithëse nuk mund të të thuhet *apriori* se është një mundësi që mund të përjashtohet totalisht.

Rasti tjetër i marrjes së masave të jashtëzakonshme janë situatat e parashikuara nga neni 173 i Kushtetutës, ku kemi të bëjmë me gjendjen e jashtëzakonshme. Sipas kësaj dispozite, gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet në dy raste:

a) Në rast rreziku për rendin kushtetues. Në këtë rast kemi levizje të armatosura ose jo të cilat kanë si qëllim marrjen e pushtetit me dhunë dhe me mënyra jo demokratike (këtu mund të përfshihen nocione të tilla si kryengritja, rebelimi, grushi i shtetit etj, megjithatë mund të ketë edhe plot situata të tjera të ngjashme)

b) Në rast rreziku për sigurinë publike. Në këtë rast ka levizje të tilla të armatosura ose jo, të cilat nuk kanë si qëllim marrjen e pushtetit, por krijimin e një situatë pasigurie e cila cënon jetën, shëndetin dhe pasurinë e personave (mund të citojmë në këto raste si shembuj, bandat e armatosura ose grupet anarkiste)

Nën këndvështrimin e këtyre parashikimeve kushtetuese, avionët renegadë mund ti klasifikojmë si rrezik për sigurinë publike. Ky është rasti më tipik në të cilën mund të klasifikohet një situatë renegade, për shkak se në përgjithësi, grupet terroriste synojnë të shkaktojnë panik, duke goditur objektiva të cilat shkaktojnë humbje në jetë njerëzish dhe në pasurinë e tyre. Në këtë rast, gjendja e jashtëzakonshme shpallet nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave dhe duhet që Kuvendi të autorizojë ndërhyrjen e Forcave të Armatosura.

Kjo do të thotë që vetë shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme nuk është e mjaftueshme që t'i lejojë Këshillit të Ministrave mundësinë për të përdorur forcat e armatosura, veçanërisht forcat ajrore. Duhet kuptuar që vetëm forcat e armatosura kanë infrastrukturën dhe mundësinë

për t'u përballur me grupet terroriste që veprojnë në këto nivelo sa që mund të përdorin edhe sulme me avionë renegade. Pra, duhet që Këshilli i Ministrave të bindë Kuvendin që përveç shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme të autorzojë atë që të përdorë repartet e forcave të armatosura për të shmangur apo luftuar rrezikun përkatës.

Kuptohet që elementi kohë dhe nevoja për një reagim të menjëhershëm, duket sikur nuk shkon në respektimin e lejimit të zhvillimit të procedurave kushtetuese, pasi koha fizike në dispozicion për të ndërhyrë është shumë e shkurtër, ndërkohë që për të ndërmarrë këto veprime duhet një kohë relativisht e gjatë. Edhe pse neni 83 i Kushtetutës lejon kalimin e ligjit për gjendjen e jashtëzakonshme me procedurë të përshpejtuar, përsëri, po sipas kësaj dispozite, kjo procedurë nuk mund të jetë më e vogël se një javë, pra jashtë qëllimit që kërkohet të arrihet në rastin e situatave renegade.

Megjithatë kjo situatë mund të shmanget me aplikimin e nenit 101 të Kushtetutës, e cila lejon miratimin e akteve normative me fuqinë e ligjit, në kushtet e nevojës dhe të urgjencës. Personalisht jam i mendimit se rreziku për një sulm me avionë renegade apo realizimi i një sulmi të tillë, përfshihet brenda nocionit “nevojë dhe urgjencë” që Kushtetuta kërkon për nxjerrjen e këtyre akteve. Përdorimi i këtij mekanizimi kushtetutes paraqet avantazhin se një akt i tillë hynë në fuqi menjëherë.⁵

5 Vendimi nr.24, datë 10.11.2006 i Gjykatës Kushtetuese: Hyrja në fuqi e aktit normativ me fuqinë e ligjit dallon nga hyrja në fuqi e ligjit, të cilën Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar qartë, me vendimin e saj nr. 47, datë 07.07.1999. Për të interpretuar këtë aspekt të aktit normativ me fuqinë e ligjit, Gjykata Kushtetuese çmon se duhen mbajtur parasysh përmbajtja dhe specifikat e nenit 101 të Kushtetutës. Elementë të tillë, si nevoja dhe urgjenca, tregojnë se aktet në fjalë duhet të hyjnë në fuqi menjëherë. Këta elementë, që qëndrojnë në bazë të transferimit kushtetues të së drejtës së nxjerrjes së aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi drejt Këshillit të Ministrave, do të zhvlefteoheshin nëse për hyrjen në fuqi të tyre do të duhet të respektohen, detyrimisht, të gjitha afatet dhe procedurat e parashikuara nga neni 117 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, përmbajtja e pjesës së dytë të dispozitës kushtetuese në shqyrtim, ku thuhet se “Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve”, tregon qartë se ato hyjnë në fuqi menjëherë. Me një interpretim a contrario të kësaj fjalie, kuptohet se aktet normative me fuqinë e ligjit duhet ta disponojnë

Nga ana tjetër, pavarësisht se ligji për gjendjen e jashtëzakonshme, në bazë të nenit 81, pika 2, gërma “dh”, miratohet me një shumicë prej tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, nuk rezulton që, bazuar në jurisprudencën më të fundit të Gjykatës Kushtetuese të ketë një ndalim që më akt normativ me fuqinë e ligjit të ndërhyhet në këtë fushë. Kështu është e vërtetë që me vendimin nr.5, datë 5.2.2014 Gjykata Kushtetuese Gjykata Kushtetuese është shprehur se nuk mundet që të ndërhyhet në ligje të cilat, duke qenë se janë parashikuar shprehimisht nga Kushtetuta si edhe kërkojnë një shumicë të cilësuar (prej 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit), përbëjnë rezervë ekskluzive të Kuvendit dhe nuk mund të delegohen Këshillit të Ministrave. Pra në thelb duke qenë se për këto ligje ndalohet miratimi i tyre me procedurë të përshtjetuar atëherë në fushat që rregullohen prej tyre nuk mundet që të ndërhyhet me aktë normative me fuqinë e ligjit. Gjithsesi jemi të mendimit që ky parashikim nuk zbatohet në rastin e ligjeve që shpallin gjendjen e jashtëzakonshme. Kjo sespe vetë Kushtetuta pranon mundësinë e miratimit të tij me procedurë të përshtjetuar,⁶ fakt ky i cili është pranuar dhe nga jurisprudenca kushtetuese.⁷ Për rrjedhojë Këshilli i Ministrave ka mundësi që të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme nëpërmjet miratimit të një akti normative me fuqinë e ligjit.

Por pavarësisht kësaj mundësie, edhe miratimi i një akti normative me fuqinë e ligjit për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme mund të vinte përsëri me shumë vonesë. Kështu një sulm me avionë renegade zakonisht mund të zbulohet deri në momentet e fundit dhe për rrjedhojë nuk ka kohë

fuqinë juridike që nga krijimi i tyre, me qëllim që të ekzistojë mundësia për ta humbur atë, po nga fillimi, kur nuk miratohen prej Kuvendit si dhe kur kalon afati 45 ditor pa u marrë në shqyrtim prej këtij.

6 Kushtetuta, neni 83, pika 3: *Procedura e përshtjetuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81 paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit dh.*

7 Vendimi nr.5, datë 5.2.2014 i Gjykatës Kushtetuese, parag.49: *Duke iu referuar pikës 3 të nenit 83, Gjykata konstaton se rregullimi kushtetues e ndalon zbatimin e procedurës së përshtjetuar për shqyrtimin e projektligjeve të renditura në nenin 81/2, me përjashtim të parashikimit të pikës “dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme”.*

për Këshillin e Ministrave që të mblidhet dhe të diksutojë miratimin e një akti të tillë dhe më pas organet kompetente shtetërore të veprojnë. Për këtë arsye ndoshta më mirë do të ishte miratimi i një ligji, ku ndër të tjera do të rregullonte pikërisht këtë situatë. Aktualisht një rregullim i tillë mungon. Kështu Kodi Ajror parashikon në dispozita të tij aksidentet ajrore, hetimin e tyre, sigruinë në lundrimet ajrore dhe në aeroporte, por nuk parashikon në mënyrë përfundimtare rastin e përdorimit të avioneve renegade.

Por edhe nëse kemi një rregullim të tillë, deri ku mund të shkohet? A mund të parashikohet me ligj mundësia që struktura të shtetit të rrëzojnë avionë renegade nëse në to ka persona civilë? Duke iu referuar praktikës botërore rezulton se pas ngjarjeve të 11 shtatorit në SHBA, Gjermania mori masa dhe miratoi me 11 Janar të vitit 2005 “Ligjin e Sigurisë Ajrore” (LuftSiG). Ligji i miratuar lejonte përdorimin e forcës së armëve, kundër avioneve të rrëmbyer, si një masë e fundit për shpëtimin e personave në tokë (sek. 14 para. 3 LuftSiG).

Nëse një masë e tillë do të ishte e lejueshme nga pikëpamja kushtetuese dhe në Shqipëri atëherë shihet e nevojshme analiza e neneve 21 dhe 17 të Kushtetutës. Neni 21 i ligjit themelor parashikon shprehimisht se *jeta e personit mbrohet me ligj*. Ndërsa përsa i përket nenit 17 të Kushtetutës, rezulton se kjo dispozitë parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ku një nga të drejtat është padiskutim edhe e drejta e jetës (neni 21 i Kushtetutës). Në fakt bazuar në parashikimet aktuale të legjisllacionit tonë rezulton se në disa raste jeta e tjetrit me qëllim mbrojtjen e jetës/jetave të tjera dhe mund të kufizohet. Këto raste janë ligji për armët, Kodi Penal etj. Megjithatë, rastet nuk mund të quhen identike. Për këtë arsye një analizë më e thelluar e këtyre elemente është mëse e nevojshme.

Duke iu rikthyer kërkesave të nenit 17 të Kushtetutës rezulton se sipas kësaj dispozite janë disa kritere që duhet të merren në konsideratë nga Ligjvënësi në kufizimin e të drejtës së jetës. Këto kritere janë:

1. Kufizimi duhet të jetë vendosur me ligj
2. Të bëhet për interes publik
3. Kufizimi të jetë proporcional

4. Të mos çenohet thelbi i së drejtës

5. Të mos tejkalohen kufizimet e parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

Në këtë drejtim, duke iu referuar dispozitës përkatëse, mund të themi se rasti i avionëve renegade, duhet që të parashikohet vetëm me ligj të miratuar nga Kuvendi. Sipas jurisprudencës Kushtetuese në këtë rast nuk lejohet asnjë formë e delegimit legjislativ tek organet ekzekutive.⁸ Pra, në rast se do të kishim një ligj të tillë, kriteri i parë do të plotësohej.

Përsa i përket kriterit të dytë, atij të interesit public, rezulton se Gjykata Kushtetuese është shprehur se *lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë kurrsesi shteruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Koncepti kushtetues i interesit publik, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para Gjykatës. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese rastet e arsyes publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë.*⁹

Bazuar në konkluzionet e mësipërme, mendoj se interesi publik në këtë rast është i justifikuar pasi synohet mbrojtja e jetëve, shëndetit dhe pasurive të personave të tjerë që ndodhen në tokë dhe që mund të jenë objekt sulmi nga avionët renegade.

Përsa i përket kriterit të tretë, atij të repsektimit të proporcionalitetit në ndërhyjen e shtetit, duhet që fillimisht të ndalemi në përkufizimin

8 Vendimi nr.20, datë 11.7.2006 i Gjykatës Kushtetuese: Gjykata Kushtetuese çmon se rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret që në këtë rast është vetëm Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi.

9 Shih vendimet nr.52, datë 05.12.2012 dhe nr.7, datë 16.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

e këtij koncepti. Sipas Gjykatës Kushtetuese në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron “ekuilibrimi i drejtë i interesave”, vlerësimi i rëndësishëm dhe objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit nëse: (i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin- ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar- sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t’u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (shih vendimet nr.52, datë 05.12.2012; nr.1 datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Prandaj dhe ekuilibrimi është metodologjia kryesore që përdoret nga Gjykata, kur ndodhemi para “konfliktit të të drejtave”, për të kuptuar dhe analizuar se kur të drejta të ndryshme konkurrojnë për njerëz apo kategori të ndryshme njerëzish dhe sa janë mbajtur parasysh nga ligjvënësi interesat përkatëse, duke mos konsideruar njërën të drejtë më të rëndësishme se tjetrën ose nëse ky ekuilibër nuk ka mundësi të vendoset, duke përzgjedhur mjetin më pak të dëmshëm ndaj kategorisë e cila gëzon të drejtën e kufizuar.¹⁰

Duke u bazuar në kërkesat e mësipërme kushtetuese, rezulton se kufizimi është proporcional dhe nuk çënon thelbin e së drejtës përsa i përket individëve që kanë rrembyer avionin dhe që synojnë të kryejnë aktin terrorist. Madje në këtë rast ndërhyja justifikohet edhe nga neni 19 i K.Penal që bën fjalë për mbrojtjen e nevojshme.

Problemi shtrohet në lidhje me civilët të cilët nuk janë pjesë e grupit terrorist dhe që ndodhen në avion të mbajtur peng prej tyre. Në këtë pikë mund të flasim për çënim të thelbit të së drejtës për jetën ndaj këtyre personave. Një justifikim që mund të përmendim në këtë rast është neni 20 i K. Penal i cili parashikon Nevojën Ekstreme, dispozitë e cila parashikon se *Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën nga nevoja për të përballuar një rrezik real, dhe të çastit që e kërcënon atë, një person tjetër apo pasurinë nga një dëmtim i rëndë dhe i pashmangshëm me menyra të*

10 Vendimi nr.56, datë 27.7.2016 i Gjykatës Kushtetuese, parag.30.

tjera me kusht që të mos jetë provokuar prej tij dhe dëmi i shkatuar të mos jetë më i madh se sa ai i zmbarsur. Por pavarësisht këtij parashikimi, në doktrinën e së drejtës penale është shfaqur mendimi se kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin kur kemi të bëjmë me jetë njerëzish.¹¹

Pra, në këtë rast marrja e jetës së njerëzve të pafajshëm me qëllim mbrojtjen e jetëve të tjera bëhet shume diskutueshme përse i përket ruajtjes së standardeve kushtetuese. Në fakt vetë ligji gjerman i sipërcituar është bërë objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese Federale e cila ka mbajtur qendrimin se: *Në situatën në të cilën gjenden këta persona për momentin, kur jepet urdhëri për të vepruar drejtpërsëdrejti me forcën e armëve ndaj mjetit ajror të përfshirë në incidentin ajror në përputhje me § 14 parag. 4 fjalia 1 LuftSiG, sipas § 14 parag. 3 LuftSiG, duhet të nisemi nga fakti se mjeti ajror duhet të përdoret kundër jetës së njerëzve. Mjetit ajror, sikurse thuhet edhe në argumentimin e ligjit, duhet t'i jetë ndërruar funksioni si mjet sulmi nga ata që e shtinë atë në dorë, ai duhet të përdoret nga vetë keqbërësit si armë vepruese, jo vetëm si mjet ndihmës për kryerjen e aktit drejtuar kundër jetës së njerëzve, të cilët qëndrojnë në zonën ku mjeti ajror duhet të përmbysset. Në këtë situatë ekstreme, që përveç të tjerash është e karakterizuar edhe nga kufizimi hapësinor i një mjeti ajror që ndodhet në fluturim, zakonisht pasagjerët dhe ekuipazhi janë në një gjendje pa rrugëdalje për ta. Ata nuk mund t'i ndikojnë më me vetësiguri rrethanat e jetës së tyre në mënyrë të pavarur nga ato të të tjerëve. Kjo gjë i bën ata objekt jo vetëm të shkelësve. Edhe shteti, i cili në një situatë të tillë kalon në masa mbrojtëse sipas § 14 parag. 3 LuftSiG, i trajton ata si objekte të hapura të aksionit të vet të shpëtimit për mbrojtjen e të tjerëve. Mungesa e rrugëdaljes dhe fataliteti që karakterizojnë gjendjen e pasagjerëve të avionit të prekur si viktima, ekziston edhe ndaj atyre që urdhërojnë dhe kryejnë goditjen e mjetit ajror. Ekuipazhi dhe pasagjerët e avionit nuk mund t'i shmanen këtij veprimi të shtetit në bazë të kushteve që nuk mund të zotërohen në asnjë mënyrë prej tyre, por ata i dorëzohen atij pa kushte dhe pa shpresë me rezultatin që ata të qëllohen së bashku me mjetin ajror dhe, për pasojë, të vriten për sigurinë e një mundësie kufizuese. Një trajtim i tillë i injoron të prekurit si subjekte me dinjitet dhe*

11 Elezi, I., Kaçupi, S., Haxhia, M., Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (pjesa e përgjithshme), GEER, Tiranë, 2001, f. 148

me të drejta të patjetërsueshme. Duke e përdorur vrasjen e tyre si mjet për shpëtimin e të tjerëve, ata materializohen dhe njëkohësisht edhe privohen. Shteti, duke zotëruar në mënyrë të njëanshme jetën e tyre, u ka mohuar pasagjerëve të avionit, që si viktimë kanë vetë nevojë për mbrojtje, vlerën që i takon njeriut për hir të qenies i tillë.¹²

Konkluzioni i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, mendon se vlen edhe për rastin e Shqipërisë. Kështu është e pamundur që të urdhërosh nëpërmjet një parashikimi ligjor “ekzekutimin” e personave civilë me synimin e vetëm për mbrojtjen e personave të tjerë. Jetët e personave nuk mundet kurrsesi që të maten nga numri i tyre. Për këtë arsye legjisllacioni duhet q të rregullojë situatë e parandalimin të këtyre ngjarjve ose mundësinë e ndërhyrjes me forcë në avion, gjithmonë duke mudnësuar në makimum ruajtjen e jetëve të pafajshme. Por në asnjë rast nuk mund të jepet urdhëri për rrëzimin e avionëve renegade në të cilin ndodhen civilë.

Është e kuptueshme që në rast se në avionin renegade ndodhen vetëm persona, të cilët konsiderohen si terroristë, atëherë goditja dhe rrezimi i tij është plotësisht i justifikueshëm.

V. Rekomandime

Bazuar në kompleksitetin e problemit renegade, përvojës ndërkombëtare, të drejtës ndërkombëtare, legjisllacionit të brendshëm, sugjerojmë;

1. Përfshirjen në legjisllacionin e brendshëm të parashikimeve për përballimin e situatave renegade, parashikime të cilat duhet të jenë në përputhje me;
- i) legjisllacionin ndërkombëtar (Kartën e Kombeve të Bashkuara, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut etj).

12 Vendimi i Senatit të Parë - 1 BvR 357/05 - datë 15.02.2006, BverfGE 115, 118, marrë nga “Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane”, botim i Fondacionit Konrad Adenauer, botim në shqip, Tiranë 2011, fq.148-149.

- ii) legjislacionin e brendshëm, duke përfshirë Kushtetutën e RSH por edhe ligje të tjera specifike.
2. Autoriteti Kombëtar (NGA) duhet të jetë qartësisht i përcaktuar, njëkohësisht të saktësohen institucionet shtetërore që do të përfshihen në përballimin e situatës. Në hartimin e dispozitave, të merret gjithashtu përvoja e vendeve anëtare të NATO-s me kapacitete të krahasueshme me vendin tonë.
3. Inicimi i marrëveshjeve ndërmjet vendit tonë dhe vendeve të NATO-s për përdorimin e kapaciteteve të munguara.
4. Përgatitja dhe zhvillimi i procedurave të përbashkëta të ROEs (rregullave të angazhimit) për renegade në mënyrë që të lejojë realizimin e operacioneve të përbashkëta.
5. Hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore të përfshira në përballimin e rasteve renegade.

Bibliografia:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë;
3. Kodi Penal;
4. Ligji nr.10100, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Atlantikut të Veriut”;
5. Ligji nr.64/2014, datë 26.10.2000 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejtimit të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”Ligji nr.10133, datë 11.5.2009 “Për Patrullimin e Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë”;
6. Ligji nr. 10133, datë 11.5.2009 “Për Patrullimin e Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë”;
7. Dekreti nr.7438, Dhjetor 1990 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Mbi Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil” (ICAO), nënshkruar më 7 Dhjetor 1944;
8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 13.4.2016 “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), për Patrullimin e Hapësirës Ajrore të

Republikës së Shqipërisë”

9. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) për patrullimin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.
10. Elezi, I., Kaçupi, S., Haxhia, M., “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (pjesa e përgjithshme)”, GEER, Tiranë, 2001.
11. NATO Analytical Air Defence Cell/NAADC “Command and Control, Communication Report” (DI (ADAM-ADS) (2008) 0140 (ADS), 10 October 2008;
12. Projekti NC3A “Studim mbi kërkesat të Vëzhgimit Ajror dhe Komunikimit për Republikën e Shqipërisë”, (ANNEX I/NC3A/OSG/ 2010/0137, ALB007698, CAT5);
13. Sistemi i Integruar i NATO-s për Mbrojtjen Ajrore (NATITNADS), (I OP/F A -2900).
14. Vendimi nr.20, datë 11.7.2006 i Gjykatës Kushtetuese.
15. Vendimi nr.24, datë 10.11.2006 i Gjykatës Kushtetuese
16. Vendimi nr.52, datë 05.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese.
17. Vendimi nr.5, datë 5.2.2014 i Gjykatës Kushtetuese.
18. Vendimi nr.7, datë 16.02.2015 i Gjykatës Kushtetuese.
19. Vendimi nr.56, datë 27.7.2016 i Gjykatës Kushtetuese.
20. Ligji Gjerman për Sigurinë Ajrore” (LuftSiG);
21. Vendimi i Senatit të Parë i Gjykatës Kushtetuese federale të Gjermanisë - 1 BvR 357/05 - datë 15.02.2006, BverfGE 115, 118.

KONTROLLI GJYQËSOR I AMENDAMENTEVE KUSHTETUESE. RASTI I SHQIPËRISË

Artemida HOXHAI¹

Hyrje

Kontrolli gjyqësor i amendamenteve kushtetuese është një çështje e cila gjen rregullime të ndryshme, në shtete të ndryshme dhe lidhet ngushtësisht me kufizimet procedurale dhe substanciale që shtetet vendosin ti parashikojnë ose jo në legjislacionet e tyre. Nga pikëpamja historike ndërkombëtare, përpjekja e parë për kufizimin substancial të bërjes ndryshimeve kushtetuese daton në vitin 1814² dhe gjendet ende në fuqi në Kushtetutën e Mbretërisë së Norvegjisë³. Bazuar në parashikimet e kësaj Kushtetute, asnjë amendim i cili shkel kufijtë e përcaktuar nga kriteret thelbësore të “shpirtit” dhe “parimeve” të Kushtetutës së

-
- 1 Master Shkencor “E drejtë publike”, Viti i Dytë, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
 - 2 Kushtetuta e Mbretërisë së Norvegjisë e miratuar më 17 maj 1814 nga Asambleja Kushtetuese, në Eidsvoll (me ndryshimet e mëvonshme, më të fundit të miratuara në 13 Maj 2014), për më tepër shih: Sortinget, The Constitution, e aksesueshme në: <https://www.stortinget.no/en/In-English/About-the-Storting/The-Constitution/>
 - 3 Në nenin 112/1 të saj parashikon se: “Nëse përvoja tregon se një pjesë e kësaj Kushtetute të Mbretërisë së Norvegjisë duhet të amendohet ... Një ndryshim i tillë megjithatë, nuk duhet duhet të vijë asnjëherë në kundërshtim me parimet e mishëruara në këtë Kushtetutë, por vetëm mund të ketë të bëjë me ndryshime të dispozitave të veçanta të Kushtetës të cilat nuk ndryshojnë frymën e Kushtetutës, dhe një ndryshim i tillë kërkon që dy të tretat e Parlamentit (Storting) të votojnë pro këtyre ndryshimeve”. Kushtetuta e Mbretërisë së Norvegjisë është e aksesueshme në: <http://www.legislationline.org/documents/section/constitutions>

Norvegjisë nuk mundej të miratohej. Klauzola e “frymës dhe parimeve” të Kushtetutës së Norvegjisë është shembulli i parë i këtij lloji në epokën kushtetuese, përpjekjet për hartimin e së cilës dolën në pah që nga fundi i shekullit të XVIII. Rruga e cila u hap nga Norvegjia u ndoq më pas nga vendet e tjera, duke përfshirë Ekuadorin⁴ me Kushtetutën e vitit 1861, e cila ishte ndër Kushtetutat më inovative dhe përfaqësuese të asaj periudhe në Ekuador⁵, si dhe Greqinë⁶ me Kushtetutën e 1864-ës.⁷

Në rastin e disa Kushtetutave të tjera, hartuesit e tyre kanë vendosur të parashikojnë ndalime më specifike dhe kanë renditur dispozita që janë të përjashtuara nga çdo amendim i ardhshëm kushtetues. Qasja e parashikimit të dispozitave kushtetuese të pandryshueshme është shfaqur gjithashtu edhe në Francë, fillimisht në doktrinën kushtetuese të Republikës së Tretë Franceze dhe më vonë e përfshirë në disa instrumente kushtetues francez. Ndalimi francez ka pasur gjithmonë një shtrirje të kufizuar, duke u shtrirë vetëm te mosndryshimi i “formës republikane të qeverisjes”. Edhe pse kjo klauzolë ndaluese, sot mund të konsiderohet si diçka e kaluar, ajo paraqet aplikimin e parë të “teknikës së ndalimeve të renditura”⁸ si një alternativë, e ndryshme nga qasja e përgjithshme.⁹

4 Sipas nenit 132 të Kushtetutës së Ekuadorit, të vitit 1861, të drejtat e përfshira në nenet 12 (të drejtën e fesë), 13 (lidhur me karakterin popullor, përfaqësues, të zgjedhur, të përgjegjshëm të qeverisë), dhe 14 (lidhur me ndarjen e pushteteve) nuk mund të ndryshohen.

5 Constitutional history of Ecuador, e aksesueshme në : <http://www.constitutio nnet.org/country/constitutional-history-ecuador>

6 Sipas nenit 107 të Kushtetutës së Greqisë të 1864, Kushtetuta nuk mund të ndryshohej plotësisht, ndërsa dispozita të caktuara që nuk kishin një karakter “thelbësor” ishin të hapura për t’u ndryshuar të paktën dhjetë vjet pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës fillestare.

7 Smith Eivind, ““Old and protected? On the “Supra-Constitutional clause in the Constitution of Norway”, Israel Law Review, Vol. 44: 369, faqe 4 (372), e aksesueshme në: <http://law.huji.ac.il/upload/44Smith.pdf>

8 Për shembull: qasja norvegjeze.

9 Garlicki Lech, Garlicka Z.A. “External review of Constitutional Amendments? International Law as a norm of reference”, Israel Law Review, Vol. 44: 343, faqe 7 (349)

Disa vende, si p.sh. Austria, Bullgaria, Kosta Rika, Nikaragua dhe Spanja bëjnë dallimin mes amendimeve kushtetuese dhe rishikimit të gjithë Kushtetues (miratimit të një Kushtetute të re), duke parashikuar për këtë të fundit një prag më të lartë për miratimin e saj, në krahasim me miratimin e ndryshimeve kushtetuese. Një diferencim i tillë bëhet me prezumimin se kompetenca për të ndryshuar Kushtetutën nënkupton futjen e rregullimeve, modifikimeve apo ndryshimeve brenda Kushtetutës në fuqi, **por nuk përfshin kompetencën për të shkëmbyer ose zëvendësuar Kushtetutën ose strukturën e saj origjinale**. Duke pranuar konceptin e popullit si *constituant pouvoir* (fuqia që krijon rendin kushtetues) në shoqëritë demokratike, një rishikim i përgjithshëm në këto vende zakonisht kërkon përfshirjen e menjëhershme të popullit, qoftë përmes zgjedhjes së një asamble kushtetuese (Bullgari, Kosta Rika dhe Nikaragua) ose përmes një referendumi të detyrueshëm (Austri dhe Spanjë).¹⁰

Përveç shteteve të cilët kanë shprehimisht të parashikuar në Kushtetutat e tyre ndalimin e amendimit të dispozitave të caktuara, ka shtete të tjera, gjykatat e të cilave kanë përpunuar doktrina që kanë të njëjtin efekt me parashikimet absolute të shteteve që ndalojnë në mënyrë eksplicite amendimin e neneve të caktuara. Shembulli më i i shquar i një qasjeje të tillë është India. Gjykata e Lartë indiane, lidhur me një çështje me objekt kontrollin e amendamenteve kushtetuese, ka mbajtur qëndrimin se pavarësisht se amendamentet kushtetuese kanë hyrë në fuqi në përputhje me procedurat formale, ndryshimet ishin jokushtetuese, sepse nuk ishin bërë “në frymën e Kushtetutës”. Testi i përcaktuar nga Gjykata e Lartë, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ndryshimeve kushtetuese indiane ishte nëse amendamenti do të “dëmtojë apo shkatërrojë elementet esenciale ose karakteristikat themelore të Kushtetutës”. Gjykata e Lartë indiane ka ndjekur këtë linjë me arsyetimin se “fuqia e ndryshimit të Kushtetutës, nuk përfshin fuqinë për të shkatërruar ose shfuqizuar as strukturën themelore dhe as kornizën e Kushtetutës”.¹¹

10 International Institute for Democracy and Electoral Assistance, “*Constitutional Amendment Procedures*”, Shtator 2014, faqe 6

11 Choudry Sujit, “*Globalization in Search of Justification: Toward a Theory of Comparative Constitutional Interpretation*”, Indiana Law Journal, Volume 74, Issue 3, Article 4, faqe 48 (865)

Çdo Kushtetutë ka problemet e saj dhe çdo gjykatë ka kompetencat e veta. Ne disa vende shihet një tendencë që për të ruajtur pjesën e pandryshueshme të Kushtetutës, ndryshimet kushtetuese t’iu nënshtrohen një forme të caktuar kontrolli gjyqësor, duke ju njohur gjykatave të brendshme kompetenca specifike për kontrollin e ndryshimeve kushtetuese. Por, pavarësisht mungesës së parashikimeve të shprehura, Gjykatat në Evropë, në pjesën më të madhe të tyre, nuk e kanë interpretuar heshtjen e Kushtetutës lidhur me përcaktimin e kompetencës së gjykatës për kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, si mohim të kompetencës së gjykatës për të bërë një kontroll të tillë. E kundërta ka ndodhur. Gjykatat kanë përcaktuar zakonisht se, në qoftë se ekziston ndonjë argument për antikushtetutshmërinë e një amendamenti kushtetues, ai duhet të shqyrtohet në themel. Kështu, për shembull, heshtja e Kushtetutave të Gjermanisë¹², Austrisë¹³ dhe Turqisë (deri në 1971)¹⁴ lidhur me kompetencën e gjykatave për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e një amendamenti kushtetues, nuk ka çuar Gjykatat Kushtetuese të këtyre vendeve në përfundimin se ato nuk e kanë të tillë kompetencë. Ato e kanë marrë të mirëqenë pasjen e një kompetence të tillë.¹⁵

Një trajtim të veçantë, të rëndësishëm për t’u analizuar në këtë punim,

12 Për më tepër shih: Barak Aharon, “*Unconstitutional Constitutional Amendments*”, *Unconstitutional Constitutional Amendments in Germany*, faqe 8 (328)

13 *Ibid*, *Unconstitutional Constitutional Amendments in Austria*, faqe 7 (327)

14 *Ibid*, *Unconstitutional Constitutional Amendments in Turkey*, faqe 2 (322)

15 Pavarësisht kësaj linje të përgjithshme, e cila vihet re se është mbajtur nga gjykatat, ka edhe përjashtime. Për shembull, Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara, ja mohoi vetes një autoritet të tillë me vendimin Coleman kundër Miller (1939). Në këtë vendim, ndër të tjera, Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara u shpreh se kontrolli mbi procesin e ndryshimit të Kushtetutës është ekskluzivisht në duart e Kongresit dhe se nuk ka asnjë shqyrtim gjyqësor të vendimit të Kongresit, duke vënë në dukje qëndrimin se një amendament kushtetues është një “çështje kushtetuese” dhe si rrjedhojë nuk përbën objekt të kontrollit gjyqësor. Për më tepër lidhur me këtë vendim, shih: <http://caselaw.findlaw.com/us-supreme-court/307/433.html>

i bën, kontrollit gjyqësor të ndryshimeve kushtetuese, Kushtetuta dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kjo e fundit, kontrollin e ndryshimeve kushtetuese e shtrin deri në kontrollin e pajtueshmërisë së tyre me të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara nga Kushtetuta.¹⁶

Bazuar edhe në praktikat ndërkombëtare të kontrollit gjyqësor të amendamenteve kushtetuese, do të përpiqem të jap një pasqyrim sa më të plotë të kontrollit gjyqësor të amendamenteve kushtetuese në Shqipëri.

Kontrolli gjyqësor i amendamenteve të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”

Para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor, në Republikën e Shqipërisë ka qenë në fuqi ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese”¹⁷. Sipas parashikimeve të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese kishte kompetencën e interpretimit të *Kushtetutës dhe të ligjeve kushtetuese*. Gjithashtu në nenin 24, pika 10 parashikohej kompetenca e Gjykatës Kushtetuese që në rastet kur konstatonte shkeljen e të drejtave të garantuara nga ligjet kushtetuese, ti njihte të drejtat e cënuara dhe ti garantonte ato, madje kur ishte rasti të ndreqte pasojat dhe kompensonte në mënyrën e duhur dëmin e shkakuar. Nga mënyra e formulimit të këtyre dispozitave, vërehet diferencimi që bëhej jo vetëm mes ligjeve të zakonshme dhe ligjeve kushtetuese (amendamenteve), por edhe mes këtyre të fundit dhe “Kushtetutës” (dispozitave kryesore kushtetuese të miratuara në vitin 1991). Ligjet kushtetuese gëzonin një fuqi juridike më të lartë se ligjet e zakonshme dhe Gjykata Kushtetuese mund të kontrollonte pajtueshmërinë e ligjeve si me ligjet kushtetuese dhe me dispozitat kushtetuese.¹⁸ Po kështu

16 Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës : Nr. K029/12 dhe Nr. K048/12, paragrafët 62-4 dhe Nr. K0 44/14, paragrafët 25- 7

17 Ligji Nr. 7491, datë 29.4.1991, i ndryshuar nga ligji nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, në bazë të së cilit ka filluar funksionimin Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë.

18 Sadushi Sokol, “*Drejtësia kushtetuese në zhvillim*”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, faqe 220

evidentohet mungesa e kompetencës së shprehur të Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese.

Kjo, nuk e “pengoi” Gjykatën Kushtetuese që me vendimin nr. 57/1997¹⁹ të shprehej lidhur me kushtetutshmërinë ligjit nr.8257, datë 19.11.1997, i cili amendonte ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, duke përdorur të drejtën e saj të njohur nga neni 25 i ligjit në fjalë, për t’u vënë në lëvizje kryesisht.

Objekti i kësaj çështjeje e kishte pikënisjen që me vendimin nr 4/2005²⁰ të Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet të cilit, kjo Gjykatë, duke interpretuar nenin 18 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, shprehej se rotacioni i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në përfundim të afatit 3 vjeçar të përcaktuar nga ky ligj, do të konsiderohej i kryer. Kjo sepse, pas dhënies së dorëheqjes së tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në vitin 1994, ata u zëvendësuan me tre anëtarë të tjerë, si rrjedhojë qëllimi i parashikimit të rotacionit që ishte qënia gjithmonë në përbërje të Gjykatës të të paktën 2/3 të anëtarëve me jo më pak se tre vjet stazh në detyrë, sipas Gjykatës Kushtetuese, ishte i realizuar. Pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, me ligjin nr.8257, datë 19.11.1997²¹, Kuvendi, në nenin 2 të tij parashikonte: “Gjykata Kushtetuese të zhvillojë rotacionin e parë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

Pas miratimit të këtij amendimi të dispozitave kryesore kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e konsideron veten të pajisur me pushtetin për të kontrolluar amendamentin, duke u legjitimuar për marrjen në shqyrtim të tij **nga neni 17** i ligjit nr.7561, datë 29.04.1992, i cili parashikonte se Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që mbron dhe garanton respektimin e Kushtetutës dhe legjislacionit si dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe **nga neni 24 pika 1** i po këtij ligji, i cili parashikonte se interpretimi i Kushtetutës dhe i ligjeve kushtetuese është në kompetencën ekskluzive të Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në këto dispozita,

19 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.57, datë 05.12.1997

20 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 02.06.1995. Edhe në këtë çështje Gjykata Kushtetuese është vënë në lëvizje me iniciativën e saj.

21 Ligji nr.8257, datë 19.11.1997 “Për një plotësim në ligjin nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””.

Gjykata Kushtetuese ka kontrolluar nga pikëpamja **materiale** ndryshimet e ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese. Një konkluzion i tillë del nga vetë argumentimi i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të të cilit Gjykata ka marrë vendimin e konstatimit të pavlefshmërisë konstitucionale të nenit 2 të ligjit amendues. Më konkretisht, Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se ligjvënësi edhe kur vepron me cilësinë e organit konstituent nuk ka të drejtë të shfuqizojë vendimet interpretative të Gjykatës Kushtetuese të marra në mbështetje të normave të mëparshme në fuqi, e kundërta do të dobësonte së tepërmi rolin e Gjykatës Kushtetuese si garante e Kushtetutës dhe legjislacionit, duke bërë që vendimet e saj të ishin vulnerable, duke çenuar dispozitën që parashikonte se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare.

Lidhur me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese është shprehur edhe Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit²² (i njohur gjerësisht si “Komisioni i Venecias”), duke vlerësuar se parashikimet kushtetuese të Shqipërisë nuk i sigurojnë Gjykatës Kushtetuese bazat për të kontrolluar kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese. Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese nuk mund të rrëzonte një amendament kushtetues **i cili në asnjë mënyrë nuk dhuron parimet themelore**²³. Gjithashtu, parimi kushtetues

22 Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, “*Opinion mbi ndryshimet e fundit të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, miratuar nga Nën-Komisioni për Reformën Kushtetuese në 15 Prill 1998, CDL-INF (98) 9, paragrafi 43, i aksesueshëm në: file:///C:/Users/User/Desktop/kontrulli%20i%20amendamenteve%20kushtetuese/komisioni%20i%20venecias%201998.pdf

23 Bërja e një vlerësimi të tillë nga Komisioni i Venecias, lë hapësira për interpretimin e qëndrimit të saj. Kjo sepse, duke qenë se ky Komision vlerëson “*në themel*” parashikimin e ndryshimit kushtetues kur e konsideron atë jo në kundërshtim me parimet themelore dhe për këtë arsye Gjykata Kushtetuese nuk mund ta rrëzonte, a contrario mund të interpretojme se nëse këto ndryshime kushtetuese do të ishin në kundërshtim me parimet themelore, atëherë Gjykata Kushtetuese do të “*legjitimohej*” ti rrëzonte. Pra duket se Komisioni i Venecias, mungesën e kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për bërjen e një kontrolli të tillë e ka bazuar më shumë në mungesën e ekzistencës së papajtueshmërisë mes ndryshimeve kushtetuese dhe parashikimeve të ligjit “*Për dispozitat Kryesore Kushtetuese*”, të ndryshuar.

se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme, nuk ndalonte Parlamentin të ndryshonte Kushtetutën, megjithëse ky ndryshim mund ti hiqte Gjykatës Kushtetuese bazën kushtetuese në të cilën kishte mbështetur vendimet e saj të mëparshme. Gjykata Kushtetuese konsiderohet se ka tejkaluar kufijtë e autoritetit të saj, duke hyrë në një mosmarrëveshje politike me Parlamentin, e cila mund të sjell vetëm dëm në funksionimin e të dy organeve.

Kontrolli gjyqësor i amendamenteve kushtetuese, bazuar në parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë²⁴

Para miratimit të ndryshimeve kushtetuese të korrikut 2016²⁵, kontrolli gjyqësor i amendamenteve kushtetuese nuk parashikohej në mënyrë të shprehur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, megjithëse mund të thuhet se bazuar në nenet 4, 116, 124, 131, 132, të Kushtetutës, të cilat sanksionojnë se *“e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”*, që evidentojnë parimin e epërsisë së Kushtetutës dhe i japin Kushtetutës vendin më të lartë në hierarkinë e ligjeve, që përcaktojnë Gjykatën Kushtetuese si autoritetin që garanton respektimin e Kushtetutës dhe ka kompetencën për të shfuqizuar akte që bien në kundërshtim me Kushtetutën, mund të interpretohet se Gjykata Kushtetuese kishte kompetencë të shqyrtonte pajtueshmërinë amendamenteve kushtetuese me Kushtetutën.²⁶ Këtë qëndrim ka mbajtur edhe një nga hartuesit e Kushtetutës, i cili shprehet se: *“nuk mund të thuhet gjithashtu se derisa dispozitat për rishikimin e Kushtetutës nuk e përmendin ndërhyrjen e Gjykatës, kjo nuk legjitimohet të veprojë, sepse këto dispozita nuk përmendin as kontrollin mbi procedurën e amendimit. Gjykata ka për detyrë si **garant i Kushtetutës** të sigurojë respektimin e nenit 151/2 dhe jo vetëm këtë, por edhe frymën, parimet dhe vlerat e saj themelore. **Aq***

24 Kjo nënçështje trajton kontrollin gjyqësor të amendamenteve kushtetuese, bazuar në parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, para ndryshimeve kushtetuese të korrikut 2016

25 Ndryshimet kushtetuese u miratuan me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016

26 Sadushi Sokol, “Drejtesia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, faqe 222

më tepër kur amendamentet nuk shtrohen për ratifikim popullor, por mbeten vetëm për miratim parlamentar. Nuk duhet pritur referendum që Gjykata të ndërhyjë, por ajo duhet ta bëjë këtë edhe në emër të vlerave të frymës së Kushtetutës, sa herë që amendamenti miratohet përfundimisht në Kuvend.”²⁷

Më konkretisht, bazuar në nenin 131, pika a të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese kishte kompetencën për të vendosur lidhur me pajtueshmërinë e **ligjit** me Kushtetutëen. Vetë Kushtetuta në nenin 4, pika 2 të saj e konsideron Kushtetutën si **ligj**, kur parashikon se “Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në mendimin tim, kur vetë Kushtetuta konsiderohet **ligj** dhe miratimi i saj²⁸ dhe gjithë ndryshimeve të saj²⁹ është bërë me ligj, kontrolli i pajtueshmërisë së amendamenteve kushtetuese me Kushtetutën, duhet të konsiderohet se ka qenë i përfshirë në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese.³⁰

Duke qenë se Gjykata Kushtetuese ka kompetencën e shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutëen, kontrolli që Gjykata Kushtetuese mund të bënte në këtë rast është *aposteriori*, vetëm pasi amendamenti kushtetues është miratuar dhe ka hyrë në fuqi, pra kontroll i amendamentit kushtetues në formën e tij finale dhe kontrolli do të konsistonte në vlerësimin e pajtueshmërisë së dispozitave kushtetuese, me “bërthamën e Kushtetutës”.³¹

27 Traja Kristaq, parathënia e librit “Kontrrolli kushtetues”, shkruar nga Sokol Sadushi, Shtëpia Botuese “Botimpex”, Tiranë, 2004

28 Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor

29 Ndryshuar **me ligjet**: nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904, datë 21.4.2008; nr. 88/2012, datë 18.09.2012; nr. 137/2015, datë 17.12.2015 dhe nr. 76/2016, datë 22.07.2016.

30 Edhe Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar ndryshimet e Kushtetutës të miratuara me ligj. Për më tepër shih: Vendimin nr.25, datë 24.07.2009.

31 Shih: Merkuri Erind, “Kushtetushmëria e Kushtetutës – kontrolli kushtetues mbi ndryshimet kushtetuese”, Punime akademike mbi nevojën për ndryshime kushtetuese, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, faqe 82

Kontrolli i amendamenteve kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, sipas parashikimeve të së drejtës në fuqi

Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të rishikuar dhe vlerësuar pjesë të vetë Kushtetutës është një çështje shumë komplekse dhe e diskutueshme, sidomos kur vetë Kushtetuta nuk përmban të ashtëquajturat “klauzolat e përjetësisë”.³² Kjo edhe për faktin se nuk ka një standard të përgjithshëm të pranuar në të drejtën kushtetuese të krahasuar lidhur me pjesëmarrjen e Gjykatës Kushtetuese në procesin e ndryshimeve kushtetuese.³³

Gjatë procesit të ndryshimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, ka mbajtur qëndrimin se në parashikimet e reja kushtetuese, Gjykatës Kushtetuese, do të duhej ti jepej **të paktën** kompetenca për të verifikuar procedurën e miratimit të amendamenteve kushtetuese. Kjo sepse, ky Komision, kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar nga pikëpamja *formale* amendamentet kushtetuese e konsideron të ngjashme³⁴ me kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e referendumeve³⁵, kjo e fundit, kompetencë e Gjykatës Kushtetuese që

32 Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, “*Opinionimi jo përfundimtar mbi draft-amendamentet kushtetuese për gjyqësorin në Shqipëri*”, miratuar në seancën e 105-të Plenare (18-19 Dhjetor 2015), Nr. 824/2015, CDL-AD(2015)045, paragrafi 20.

33 Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, “*Opinion mbi situatetën kushtetuese në Ukarainë*”, Miratuar në Seancën e 85 Plenare (17-18 Dhjetor 2010), Nr. 599/2010, CDL-AD(2010)044, paragrafi 30.

34 Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, “*Opinionimi jo përfundimtar mbi draft-amendamentet kushtetuese për gjyqësorin në Shqipëri*”, miratuar në seancën e 105-të Plenare (18-19 Dhjetor 2015), Nr. 824/2015, CDL-AD(2015)045, paragrafi 21

35 Bazuar në nenin 131, paragrafi 1, pika ë, e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vazhdon të ketë kompetencë të shyrtojë paraprakisht kushtetutshmerinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij, brenda kufijëve të parashikuar në nenin 152, paragrafi 1. Pra, Gjykata duhet të verifikojë nëse, në rastet që i paraqiten për shqyrtim janë të pranishëm ndalime të atij lloji që parashikon neni 151 paragrafi 2 i Kushtetutës. Madje, në vendimin 31/2003

nuk preket nga ndryshimet kushtetuese. Pra, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit nuk ka qenë kundra idesë së parashikimit të kompetencës së Gjykatës Kushtetuese, për të kontrolluar nga pikëpamja substanciale kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese.³⁶

Në ndryshimet e reja kushtetuese, kushtetutëbërësi është mjaftuar më respektimin e këtij standardi minimal, të ardhur në formën e një rekomandimi nga Komisioni i Venecias, duke i njohur Gjykatës Kushtetuese vetëm kompetencën e kontrollit të procedurës së miratimit të amendamenteve kushtetuese. Më konkretisht, në nenin 131 të Kushtetutës, është shtuar paragrafi i dytë³⁷, i cili parashikon se: *“Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.”* Në bazë të këtij parashikimi kushtetues, në ligjin *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”*³⁸ u pasqyrua kjo kompetencë e re e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në parshikimet e të së drejtës në fuqi, kontrolli i amendamenteve kushtetuese në Republikën e Shqipërisë paraqet disa karakteristika, të cilat po i trajoj në mënyrë më të zgjeruar në vijim:

mund të thuhet se Gjykata Kushtetuese ka shkuar deri në bërjen e një kontrolli substancia të kërkesës për bërjen e një referendum për shfuqizimin e ligjit që parashikonte rritjen e moshës për përfitim të pensionit. Për më tepër shih: Vendimin nr.31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese, faqe 4 dhe Vendimin nr. 8 datë 08.03.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

36 Komisioni, në Opinionin në fjalë, ka referuar madje edhe te praktika e shteteve të tilla si Austria, Gjykata Kushtetuese e të cilës, pavarësisht mungesës së parashikimeve kushtetuese lidhur me paamendueshmërinë e dispozitave të caktuara, i ka shpallur parimet themelore të Kushtetutës, në jurisprudencën e saj, si de facto të paamendushme (parag 20 i Opinionit të Komisionit Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, për Shqipërinë).

37 Me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

38 Ligji nr.8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr.99/2016

1. Kontroll *aposteriori*

Kontrolli i ndryshimeve kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese është një kontroll *aposteriori*, kjo bazuar në termin e përdorur dhe mënyrën e formulimit të parashikimit kushtetues të cituar më sipër. Qartësisht, neni 131, paragrafi 2 parashikon të drejtën e Gjykatës Kushtetuese për të shyrtuar **ligjin** për rishikimin e Kushtetutës, **të miratuar nga Kuvendi** sipas nenit 177 të Kushtetutës. Kontrolli *aposteriori* i ligjeve për rishikimin e Kushtetutës passjell me vete problematikën e krijimit të vakumeve në Kushtetutë, kjo sepse bazuar në parashikimet e ligjit “Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” të ndryshuar, vendimi i Gjykatës Kushtetuese që pranon tërësisht ose pjesërisht kërkesën³⁹, sjell si pasojë shfuqizimin e amendamenteve kushtetuese të miratuara nga Kuvendi. Duke qenë se kontrolli është *aposteriori*, kjo do të thotë se me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese, ato sjellin si pasojë shfuqizimin e dispozitave të vjetra kushtetuese. Kjo pasojë e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese, nuk mundet që të riparohet nga vendimarrja e Gjykatës Kushtetuese, pasi referuar nenit 76, të ndryshuar, të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, vendimet e saj kanë efekte *ex nunc*, pra vetëm për të ardhmen.⁴⁰

Megjithatë, një situatë të tillë, ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, është përpjekur ta rregullojë, në nenin 76, paragrafi 4⁴¹, i cili i njehtë drejtën Gjykatës Kushtetuese, që në rastet kur vendos shfuqizimin e një akti juridik, të parashikojë edhe një datë për hyrjen në fuqi të vendimit të saj, të ndryshme nga rregulli i përgjithshëm i hyrjes në fuqi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në momentin e botimit në Fletoren Zyrtare. Kjo,

39 Neni 51/a paragrafi 1, shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

40 Shih: Merkuri Erind, “Kushtetushmëria e Kushtetutës – kontrolli kushtetues mbi ndryshimet kushtetuese”, Punime akademike mbi nevojën për ndryshime kushtetuese, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, faqe 84

41 “Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që vendimi për shfuqizimin e një akti të prodhojë pasoja në një datë tjetër të ndryshme nga hyrja e tij në fuqi. Në këtë rast Kuvendi apo çdo institucion tjetër bën ndryshimet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në përputhje me pjesën arsyetuese të tij.”

me qëllim që Kuvendi të bëjë ndryshimet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në përputhje me pjesën arsyetuese të tij.

Pavarësisht këtij parashikimi, mendoj se në praktikë, tejkalimi i situatave të boshllëqeve kushtetuese të cilat mund të krijohen si pasojë e ndryshimeve kushtetuese do të paraqesë vështirësi për t'u shmangur. Kjo sepse, pavarësisht faktit se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme, procesi i diskutimit, hartimit, gjetjes së rrugëve dhe mënyrave për dakortësim mes partive politike dhe miratimi i akteve juridike të caktuara në Kuvend ka një natyrë politike dhe kërkon një kohë të gjatë për t'u finalizuar. Ky proces vështirësohet akoma më shumë në rastin konkret sepse bëhet fjalë për miratimin e dispozitave kushtetuese, të cilat kërkojnë një shumicë dhe konsensus të konsiderueshëm, aq më tepër kur nevoja për miratimin e këtyre ndryshimeve kushtetuese ka ardhur pas konstatimit nga Gjykata Kushtetuese të papajtueshmërisë, së procesit të miratimit të ndryshimeve të mëparshme kushtetuese, me Kushtetutën.

2. Kontroll formal

Bazuar në parashikimet e së drejtës në fuqi, Gjykata Kushtetuese mund të ushtrojë vetëm kontroll formal ndaj ndryshimeve kushtetuese. Me kontroll formal të ndryshimeve kushtetuese kuptohet kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar vetëm nëse ndryshimet kushtetuese janë miratuar në pajtim me procedurën e parashikuar nga Kushtetuta në nenin 177 të saj. Konkretisht, bazuar në dispozitat kushtetuese, Gjykata Kushtetuese do të kontrollojë vetëm nëse janë përmbushur këto kushte: 1. Nisma për rishikimin e Kushtetutës është ndërmarrë nga të paktën se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit. 2. Ndryshimet kushtetuese nuk janë ndërmarrë gjatë kohës kur kanë qenë të vendosura masat e jashtëzakonshme. 3. Projekti i ndryshimeve kushtetuese është miratuar nga të paktën dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. 4. Rishikimi i Kushtetutës nuk është bërë përpara kalimit të një viti nga dita e rrëzimit në Kuvend të projektligjit që rregullonte të njëjtën çështje dhe nuk është bërë para kalimit të 3 viteve nga dita e rrëzimit të tij në referendum. Nëse qoftë edhe një prej këtyre kritereve nuk është zbatuar, amendamenti

kushtetues do të konsiderohet nga Gjykata Kushtetuese i papajtueshëm më Kushtetutën, për shkak se nuk është miratuar në pajtim me procedurën e parashikuar në nenin 177 të Kushtetutës.

Paksa kontradiktor mund të duket formulimi i nenit 51, paragrafi 1, pika a, e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, i cili parashikon se Gjykata Kushtetuese, gjatë shyrimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49⁴² dhe 50⁴³ të ligjit, një prej të cilave është kërkesa për kontroll të procedurës së miratimit të amendamenteve kushtetuese, duhet të vlerësojë **përmbajtjen** e ligjit. Një formulim i tillë i dispozitës mund të krijojë perceptimin se Gjykata Kushtetuese ka kompetencë jo vetëm të shyrtojë pajtueshmërinë e procedurës së miratimit të amendamentit me kërkesat kushtetuese të nenit 177, por të vlerësojë edhe kushtetutshmërinë e përmbajtjes së tij. Mendoj se krijimi i këtij perceptimi ose bërja e një interpretimi të tillë, sado që mund të konsiderohet i arsyeshëm për shkak të vetë formulimit të dispozitës, nuk mund të qëndrojë. Kjo sepse kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, për kontrollin e amendamenteve kushtetuese, është e përcaktuar në mënyrë të qartë në aktin më të lartë në hierarkinë e normave të Republikës së Shqipërisë, në Kushtetutë, e cila i njej Gjykatës Kushtetuese **vetëm**⁴⁴ kompetencën për të kontrolluar respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

Nga analizimi i kompetencave konkrete që ka Gjykata jonë Kushtetuese lidhur me kontrollin e amendamenteve Kushtetuese, qartësisht evidentohet se i mungon kompetenca për kontrollin *material* të ndryshimeve kushtetuese. Gjykata Kushtetuese nuk mund të kontrollojë

42 Neni 49, paragrafi 2 parashikon: “Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin vetëm të respektimit të procedurës së parashikuar nga Kushtetuta, sipas nenit 131, pika 2, dhe nenit 177, të Kushtetutës, e kanë Presidenti i Republikës dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve.”

43 Neni 50, paragrafi 2 parashikon: “Kërkesat për kushtetutshmërinë e ligjit për rishikimin e Kushtetutës, në aspektin procedural, mund të paraqiten brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.”

44 Neni 131, paragrafi 2 i Kushtetutës: “Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.”

nësë ndryshimet kushtetuese janë në përputhje me bërthamën esenciale të Kushtetutës, me parimet të cilat përbëjnë bazën e shtetit dhe qeverisjes dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut⁴⁵ dhe si rrjedhojë nuk mund të ndryshohen.

Në literaturë, dispozitave kushtetuese të cilat janë të ndaluara t’iu nënshtrohen ndryshimeve kushtetuese, ju referohen me terma të ndryshëm, si për shembull: “të pandryshueshme”, “të parevokueshme”, “të përjetshme”, “të pakthyeshme”, “të vazhdueshme” ose “të paamendueshme”.⁴⁶ Dispozitat të tilla shërbejnë si “barriera ndaj ndryshimeve”. Ato pasqyrojnë idenë se parashikime të caktuara kushtetuese duhet të jenë të mbrojtura nga ndryshimi, kjo për arsye të ndryshme. Cdo shtet duhet të ruajë ekzistencën dhe identitetin e vetë. Kur parashikojnë ndalime të tilla, kushtetutbërësit vlerësojnë se përmbajtja e dispozitave të veçanta është aq e rëndësishme për ekzistencën e Kushtetutës dhe për ekzistencën dhe identitetin e shtetit, sa që duhet të ekzistojnë për breza të tërë. Dispozitat e paamendueshme kanë për qëllim të sigurojnë “mbrojtje hermetike”, madje mund të shërbejnë edhe për të bllokuar procesin e amendimit të Kushtetutës, me qëllim parandalimin e shkeljes së disa parimeve themelore të veçanta.⁴⁷ Këto ndalime reflektojnë idenë se identiteti kombëtar dhe krijues i një vendi nuk duhet të nënshtrohet kapriçove të shumicave të caktuara.⁴⁸ Dispozitat e tilla kushtetuese, të cilat nuk mund të amendohen, hartohen nga shtetet, në mënyrë që të punojnë pikërisht kundër karakteristikave të traditës dhe kulturës së shteteve, të cilat mbajnë në vete rezikun potencial të shkakimit të dëmeve përmes proceseve të zakonshme politike, të cilat shpesh mund të pasqyrohen me

45 Anastasi, Aurela; Omari, Luan, “*E drejta kushtetuese*”, Shtëpia botuese “PEGI”, Tiranë 2010, faqe 38

46 Roznai Yaniv, “*Unconstitutional Constitutional Amendments: A Study of the Nature and Limits of Constitutional Amendment Powers*”, The London School of Economics and Political Science, faqe 23

47 Madje edhe në rastet e parashikimit të shumicave të cilësuar, për miratimin e amendimeve.

48 Roznai Yaniv, “*Unconstitutional Constitutional Amendments: A Study of the Nature and Limits of Constitutional Amendment Powers*”, The London School of Economics and Political Science, faqe 24

krijimin e aleancave të tilla që arrijnë të krijojnë shumica, të afta për të ndryshuar aktin themelor të shtetit sipas interesave të ngushtë të partive politike, duke prekur edhe dispozita të cilat përbëjnë bërthamën e vetë Kushtetutës dhe ekzistencës së shtetit të së drejtës, shtetit demokratik. Autoriteti për ndryshimin e Kushtetutës nuk përfshin kompetencën për të nxjerrë një të re. Kur kufizohen ndryshimet që mund t'i bëhen dispozitave të Kushtetutës mbrohet sovraniteti i popullit.⁴⁹

Gjithashtu një trajtim interesant, të ndryshëm nga parashikimet e Kushtetutës sonë, i bën Kushtetuta e Republikës së Kosovës⁵⁰ rregullimit të kontrollit të amendamenteve kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese. Ajo parashikon, njësoj si në procesin ligjberës, Kuvendin si organin kompetent për miratimin e amendamenteve kushtetuese. Subjektet të cilët mund të propozojnë ndryshime (“*amendmentime*”) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë **Qeveria, Presidenti dhe një e katërta e deputetëve të Kuvendit**. Propozimet e këtyre subjekteve mund të miratohen nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk

49 Halmai Gabor, “*Internal and External Limits of Constitutional Amendment Sovereignty*”, faqe 2, i aksesueshëm në:<http://www.eui.eu/Documents/DepartmentsCentres/Law/Professors/Halmai/Constitutional-Amendment-Power.pdf>

50 Neni 144 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nën titullin “Amendmentimi” parashikon: “1. *Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamente të kësaj Kushtetute.* 2. *Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.* 3. *Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.* 4. *Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.*”

janë shumicë në Republikën e Kosovës, **vetëm pasi** Kryetari i Kuvendit të Kosovës, amendamentet e propozuara të Kushtetutës, ia ka adresuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe kjo e fundit ka vlerësuar se amendamentet kushtetuese objekt gjykimi nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Pas miratimit në Kuvend, me shumicën e kërkuar, amendamentet kushtetuese të propozuara hyjnë në fuqi menjëherë. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, brenda gjashtëdhjetë ditëve pasi ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e amendamentit ose amendamenteve kushtetuese duhet të shprehet me vendim⁵¹ nëse amendamenti kushtetues i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës⁵².

Por Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në jurisprudencën e saj, kur ka kontrolluar amendamentet kushtetuese të propozuara, të cilat i janë paraqitur për gjykim, **nuk ka vlerësuar vetëm** nëse këto amendamente, zvogëlonin ose jo të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës, por i ka shqyrtuar amendamentet **edhe lidhur me të drejtat e garantuara nga Kapitulli III⁵³ dhe të drejta të tjera të parashikuara në Kushtetutë**, kjo sepse këto të drejta specifike janë konsideruar zgjerim i të drejtave të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës, sidomos i të drejtave të garantuara nga: neni 24, i cili parashikon barazinë para ligjit⁵⁴ dhe neni 21 i Kushtetutës, i cili parashikon parimet

51 Neni 54 i ligjit Nr. 03/L-121, “Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës”, i aksesueshëm në këtë adresë: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/Ligji_Gjkk_03-L-121.pdf

52 Kapitulli II i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parshikon të drejtat dhe liritë themelore. Për më tepër shih: Nenet 21-56 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

53 Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre. Për më tepër shih: nenet 57-62 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

54 “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartëligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. 3. Parimet e mbrojtjes

e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përcaktuar detyrimin e shtetit të Kosovës për të mbrojtur dhe garantuar të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara nga Kushtetuta dhe jo vetëm ato të parashikuara në Kreun II të saj⁵⁵. Këtë qëndrim të saj in Gjykata e mbështet po ashtu edhe në nenin 56 të Kushtetutës, i cili parashikon se shmangia nga zbatimi i të drejtave të mbrojtura dhe garantuara nga Kushtetuta bëhet vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe vetëm në masën që është e domosdoshme në rrethanat konkrete. Duke qenë se ndryshimet kushtetuese të propozuara nuk kanë qenë të lidhura me këtë situatë jo të zakonshme, Gjykata Kushtetuese, si garante e zbatimit të Kushtetutës nuk mund të lejojë shkeljen e të drejtave dhe lirive kushtetuese.⁵⁶

Bazuar në këto dispozita, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka mbajtur qëndrimin se kur vlerëson kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese të propozuara, të cilat i janë paraqitur për shqyrtim, **nuk do të marrë parasysh vetëm te drejtat dhe liritë e njeriut te perfshira ne Kapitullin II, por edhe të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe të parashikuara me shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës se Kosovës.**⁵⁷

Vënia në dukje e mungesës së kompetencës së Gjykatës tonë Kushtetuese për të kontrolluar pajtueshmërinë e amendamenteve kushtetuese me dispozitat kushtetuese “të përjetshme” në mënyrë të arsyeshme passjell lindjen e pyetjes: A ekzistojnë në Kushtetutën tonë të tilla dispozita? Për t’i kthyer përgjigje kësaj pyetjeje do të duhet të bëhet

së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

55 Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës : Nr. K029/12 dhe Nr. K048/12, paragrafët 62-4 dhe Nr. K0 44/14, paragrafët 25- 7

56 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës : Nr. K029/12 dhe Nr. K048/12, paragrafi 69

57 Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës : Nr. K029/12 dhe Nr. K048/12, paragrafi 64 dhe Nr. K0 44/14, paragrafi 28

dallimi midis parashikimeve të cilat vendosin në mënyrë eksplicite (të shprehur) ndalimin e ndryshimit të dispozitave të caktuara juridike dhe dispozitave të cilat në mënyrë implicite nuk mund të amendohen.

Ndalimet eksplicite⁵⁸ për bërjen e ndryshimeve kushtetuese rrjedhin në mënyrë direkte nga teksti Kushtetues dhe bëhet fjalë për ato dispozita kushtetuese, të cilat **në mënyrë të shprehur** konsidërohen të pamodifikueshme. Ka studiues të cilët mbajnë qëndrimin se pavarësisht aspekteve pozitive, prashikimet eksplicite të cilat ndalojnë ndryshimin e dispozitave të caktuara kushtetuese mund të krijojnë një sërë problematikash, siç mund të jenë: Krijimi i një hierarkie brenda vetë normave kushtetuese dhe forcim i madh i pushtetit gjyqësor⁵⁹, çënimi i konceptit se “pushteti krijues i takon popullit dhe të zgjedhurve të tij”, duke bërë që një organ jo i zgjedhur të jetë mbi “pushtetin krijues”.⁶⁰ Si dhe, mundësia e kufizimit të brezave të ardhshëm lidhur me fushat të cilat ata mund të ndryshojnë për t’iu përshtatur zhvillimeve dhe nevojave të tyre, duke krijuar premisat e lindjes së nevojës në të ardhmen, për krijimin e një Kushtetute të re.

Dispozitat të cilat në mënyrë implicite⁶¹ nuk mund të amendohen, janë ato dispozita, ndalimi i ndryshimit të të cilave nuk është i shprehur në mënyrë direkte në Kushtetutë, por buron nga interpretimi sistematik i tyre dhe pikëpamja se parimet themelore nuk mund të “shemben”.

Në Kushtetutën në fuqi nuk ekzistojnë parashikime eksplicite lidhur me ndalimin e ndryshimit të dispozitave të caktuara kushtetuese⁶². Por

58 Kapiti Enriko, “*Nevoja për kufizime eksplicite për rishikimin e kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*”, Punime akademike mbi nevojën për ndryshime kushtetuese, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, faqe 37

59 Kjo për shkak se duke u parashikuar mosndryshueshmëria e dispozitave të caktuara kushtetuese, krijohen edhe mekanizma gjyqësor për kontrollin e amendamenteve kushtetuese, për të vlerësuar nëse ato kanë “prekur” dispozitat kushtetuese të pandryshueshme.

60 International Institute for Democracy and Electoral Assistance, “*Constitutional Amendment Procedures*”, Shtator 2014, faqe 9

61 Po aty

62 Parashikim eksplicit në një Kushtetutë shqiptare lidhur me ndalimin e ndryshimit të dispozitave të caktuara kushtetuese, ka ekzistuar në Statutin

studiuesit⁶³, janë të mendimit se nga interpretimi sistematik i parashikimeve kushtetuese, ka dispozita të caktuara të cilat nuk mund të nënshtrohen amendimeve kushtetuese, më konkretisht: pavarësia dhe territori i shtetit, dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë themelore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetësa fetare, bashkëjetësa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat⁶⁴. Një qëndrim të tillë e konsideroj të drejtë, kjo sepse amendimi nënkupton idenë e korrigjimit, riparimit apo përmirësimit dhe qëllimi i parashikimit të rregullave lidhur me procedurën dhe përmbajtjen e amendamenteve kushtetuese krijohen për t’i shërbyer pikërisht këtij qëllimi, pra lejimit të korrigjimit dhe përmirësimit në dritën e informacioneve të reja dhe përvojave të zhvilluara. Gjithashtu, në një tjetër pikëpamje, proceset e amendimeve kushtetuese janë projektuar, jo aq për të lejuar ndryshime në strukturën origjinale të Kushtetutës, por më tepër për t’iu lejuar aktorëve legjislativë dhe popullit shtrirje më të madhe për të ndikuar në zhvillimin e interpretimit të kësaj strukture nga Gjykatave Kushtetuese.⁶⁵ Në rastin e ndryshimit të dispozitave të cilat përbëjnë “bërthamën”, “themelin” e Kushtetutës, gjithë esenca dhe kuptimi i Kushtetutës, që kishte qenë në fuqi para bërjës së këtyre ndryshimeve, humbet, duke bërë qe subjektet

e 1925, i cili parashikonte ndalimin në mënyrë absolute të ndryshimit të formës republikane të qeverisjes. Në nenin 141 të tij parashikohej: “Forma Republikane e Shtetit nuk mund të ndrohet me as një mënyrë.” Për më tepër shih : Anastasi Aurela, “Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri”, Shtëpia botuese “PEGI”, Tiranë, 2007, faqe 80

63 Anastasi, Aurela; Omari, Luan, “*E drejta kushtetuese*”, Shtëpia botuese “PEGI”, Tiranë 2010, faqe 38; Merkuri Erind, “*Kushtetushmëria e Kushtetutës – kontrolli kushtetues mbi ndryshimet kushtetuese*”, Punime akademike mbi nevojën për ndryshime kushtetuese, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, faqe 75

64 Merkuri Erind, “*Kushtetushmëria e Kushtetutës – kontrolli kushtetues mbi ndryshimet kushtetuese*”, Punime akademike mbi nevojën për ndryshime kushtetuese, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, faqe 75

65 Dixon Rosalind, “*Constitutional Amendment Rules: A Comparative perspective*”, Chicago Public Law and Legal Theory Working Paper, Nr 347, faqe 2

që miratuan këto “ndryshime”, t’i kenë njohur vetes kompetenca për të nxjerrë një Kushtetutë të re.

Jam e mendimit se në kuadër të ndryshimeve kushtetuese, do të duhej të ishte pasqyruar jo vetëm nevoja e lindur lidhur me përcaktimin eksplicit të dispozitave të caktuara kushtetuese të cilat nuk do të mundej të ndryshoheshin, kjo me qëllim shmangien e interpretimeve të ndryshme lidhur me ekzistencën apo jo në Kushtetutën tonë të dispozitave të cilat mund të interpretohen si të pandryshueshme, por edhe kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, si interpretuesja përfundimtare e Kushtetutës⁶⁶, për të kontrolluar edhe nga ana materiale pajtueshmërinë e ndryshimeve kushtetuese me “bërthamën e Kushtetutës”. Parashikime të tilla do të garantonin më shumë siguri juridike. Ne ndoshta mund t’i besojmë vetes, por jo atyre që na qeverisin.⁶⁷

Një qëndrim i tillë mbështet edhe në eksperiencën ndërkombëtare lidhur me këtë çështje. Në përpjekje për të vendosur ekuilibër të drejtë midis ngurtësisë dhe fleksibilitetit në ndryshimet kushtetuese, shumë Kushtetuta parashikojnë ndalimin e ndryshimit të dispozitave të caktuara, kjo me qëllim sigurimin e stabilitetit, sigurisë dhe garancive të fuqishme për disa pjesë të Kushtetutës të cilat duhet të jenë më të ngurta, duke lejuar ndërkohë fleksibilitet në fusha të tjera. Konkretisht, sot, më shumë se 70 kushtetuta në të gjithë botën kanë të parashikuara dispozita të tilla të paamendueshme.⁶⁸ Rregullat lidhur me amendamentet kushtetuese strukturojnë procesin përmes të cilit aktorët politikë ndryshojë tekstin dhe kuptimin e Kushtetutës, duke siguruar një kornizë ligjore transparente brenda së cilës mund të ndryshohet Kushtetuta. Përmbajtja e këtyre

66 Neni 124, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar

67 Albert Richard, “*The Expressive Function of Constitutional Amendment Rules*”, Boston College Law School Faculty Papers, faqe 10 (233), bazuar në Lawrence G Sager, “The Birth Logic of a Democratic Constitution” in Ferejohn, Rakove & Riley

68 International Institute for Democracy and Electoral Assistance, “Constitutional Amendment Procedures”, Shtator 2014, faqe 8, i aksesueshëm në: http://www.constitutionnet.org/files/constitutional_amendment_procedures.pdf

dispozitive ndryshon shumë nga vendi në vend.⁶⁹

Në praktikë nevoja ka shkuar deri aty sa studiuesit dhe shtete të caktuara nuk mbështesin vetëm idenë e parashikimit të dispozitave të caktuara kushtetuese, të cilave duhet t'ju njihet “e drejta” për të mos u ndryshuar, por duhet të garantohet “përjetësia” edhe e dispozitave të cilat ju garantojnë pandryshueshmërinë të parave. Më konkretisht, ndërkombëtarisht, shumica e dispozitave të cilat parashikojnë paamendueshmërinë e neneve të caktuara të Kushtetutës, vetë janë të ndryshueshme, pra ato parashikojnë “përjetësinë” e dispozitave të caktuara, por vetë janë objekt ndryshimi, nuk janë “të përjetshme”. Si rrjedhojë, ndryshueshmëria e tyre, passjell me vete rrezikun e ndryshimit të dispozitave që garantojnë pandryshueshmërinë e neneve të caktuara të Kushtetutës, me qëllim që pas shfuqizimit të tyre të mos ekzistojë më asnjë ndalim për ndryshimin e neneve që më parë gëzonin mbrojtje ndaj ndryshimeve kushtetuese. Pra, nëse parashikimet kushtetuese që mbrojnë dispozita të caktuara Kushtetuese nga amendimi nuk janë edhe vetë të mbrojtura nga ndryshimi, dispozitat të cilat gëzojnë mbrojtje ndaj ndryshimeve, rrezikojnë të jenë objekt i procedurës së mësipërme amenduese të dyfishte.

Prandaj, me qëllimin e shmangies së procedurës së dyfishtë amenduese, kushtetutbërësit do të duhet të parashikojnë dispozita të cilat jo vetëm garantojnë pandryshueshmërinë e parashikimeve kushtetuese të caktuara, por gjithashtu ndalojnë edhe amendimin e “vetes së tyre”,⁷⁰ e konsideruar kjo si “mekanizmi i dyfishtë i pandryshueshmërisë”.⁷¹

69 Për shembull: uniteti kombëtar (Indonezi), statusi i fesë (Tunizi), pluralizmi politik (Rumani), forma demokratike apo republikane e qeverisë (Francë), të drejtat zgjedhore (Brazil), të drejtat themelore të njeriut (Gjermani) dhe kohëzgjatja e mandatit presidencial (Honduras). Siç mund të kuptohet, dispozitat të cilat nuk mund t'i nënshtrohen ndryshimeve kushtetuese janë shpesh rezultat i traumave të kaluara nga vetë shtetet, të cilat në këtë mënyrë zgjedhin t'i paraprijnë “përsëritjes së historisë”.

70 Ky mekanizëm parashikohet në: Kushtetutën e Bosnje-Hercegovinës (1995), neni X2; Kushtetutën e Hondurasit (1982), neni 374; Kushtetutën e Nigerisë (2010), Neni 177; Kushtetutën e Ruandës (2003), neni 193.

71 Për më tepër lidhur me këtë problematikë, shih: Roznai Yaniv, “Towards a

3. Subjektet që mund të vendosin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese

Bazuar në nenin 49, paragrafi 2 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar, të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin vetëm të respektimit të procedurës së parashikuar nga Kushtetuta, sipas nenit 131, pika 2, dhe nenit 177, të Kushtetutës, e kanë vetëm **Presidenti i Republikës dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve**. Nga interpretimi literal i kësaj dispozite evidentohet se vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese **nuk është e detyrueshme**, por ngritja e kërkesës para kësaj Gjykate, për të kërkuar kontrollin e respektimit të procedurës kushtetuese për miratimin e amendamenteve kushtetuese, mbetet në diskrecionin e këtyre subjekteve.

Një rregullim të ndryshim i bën Kushtetuta e Republikës së Kosovës subjekteve që duhet ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në këto parashikime kushtetuese subjekti i vetëm i legjitimuar për referimin e amendamenteve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese është Kryetari i Kuvendit të Kosovës⁷², i cili e **ka detyrim që në çdo rast** në të cilin në Kuvend depozitohen propozimet për miratimin e amendamenteve kushtetuese, para miratimit të tyre në Kuvend duhet t'ia referojë këto amendamente Gjykatës Kushtetuese.

4. Afati për paraqitjen e kërkesës

Kërkesat për kushtetutshmërinë e ligjit për rishikimin e Kushtetutës mund të paraqiten brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit. Afati 60 ditor për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese lidhur me kërkimin e kontrollit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, përcaktohet nga neni 50, paragrafi 2 i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese. Pavarësisht se nga mënyra e formulimit të kësaj dispozite,

Theory of Unamendability”, New York University Public Law and Legal Theory Working Papers, faqe 27

72 Neni 113, paragrafi 9 i Kushtetutës së Kosovës: “Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.”

për shkak të përdorimit të termit “mund”, potencialisht mund të krijohet perceptimi se subjektet e legjitimuar për ngritjen e këtij pretendimi kanë mundësi të zgjedhin për t’iu drejtuar Gjykatës brenda këtij afati ose në një afat të mëvonshëm, mendoj se përdorimi i termit në fjalë është bërë lidhur me mundësinë, diskrecionin që kanë këta subjekte, bazuar në nenin 49, paragrafi 2 për t’iu drejtuar ose jo Gjykatës. Pra, subjektet mund të vlerësojnë se duhet ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese për ti kërkuar kontrollin formal të amendamenteve kushtetuese ose mund të vlerësojnë të mos e ngenë një kërkim të tillë para Gjykatës Kushtetuese, por nëse vlerësojnë të parën, atëherë kërkesën duhet ta ngrënë patjetër brenda afatit 60 ditor nga hyrja në fuqi e ligjit kushtetuese. Një interpretim i kundërt do të çenonte parimin e sigurisë juridike dhe pritsshmërive legjitime.

Nëse gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë së amendamentit kushtetues me procedurën e parashikuar nga Kushtetuta, amendamenti shfuqizohet ose ndryshohet nga Kuvendi, Gjykata Kushtetuese si rregull **pushon** gjykimin. Por, nëse Gjykata Kushtetuese çmon se pavarësisht shfuqizimit ose ndryshimit të amendamentit kushtetues objekt shqyrtimi, gjykimi **për shkak të një interesi publik ose shtetëror** duhet të vazhdojë, vazhdon gjykimin e çështjes dhe nuk e pushon atë.⁷³ Në përfundimin e gjykimit, në dispozitivin e vendimit, Gjykata Kushtetuese në çdo rast duhet të shprehet edhe për efektin e vendimit dhe pasojat e tij.⁷⁴

Përfundime

Kontrolli gjyqësor i amendamenteve kushtetuese është një institut i cili, në mënyrë të shprehur, ka gjetur rregullim të vonë në aktet juridike të Republikës së Shqipërisë, më saktësisht në mënyrë direkte nje lloj kontrolli i tillë është parashikuar me ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016. Konkretisht, nëpërmjet këtyre parashikimeve kushtetuese dhe parashikimeve më të detajuara të bëra në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar me ligjin nr.99/2016, Gjykata Kushtetuese ka kompetencën e

73 Neni 51, paragrafi 2, paragraf i shtuar me Ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

74 Neni 51/a, paragrafi 2, i shtuar me Ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

kontrollit të amendamenteve kushtetuese vetëm lidhur me respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

Bazuar në këto parashikime, Gjykata Kushtetuese ka kompetencë për të bërë një kontroll *aposteriori* të ligjeve që ndryshojnë Kushtetutën, duke kontrolluar vetëm nëse ndryshimet kushtetuese janë miratuar në pajtim me procedurën e parashikuar nga Kushtetuta në nenin 177 të saj dhe subjektet që kanë të drejtën për ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjeve kushtetuese, e kanë vetëm President i Republikës dhe jo më pak se 1/ 5 e deputetëve. Gjykata Kushtetuese nuk ka pushtetin për të bërë një kontroll material të ndryshimeve kushtetuese.

Pavarësisht se përcaktimi direkt, i shprehur i kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese ka gjetur rregullim vetëm vitin e fundit, nga interpretimi i dispozitave kushtetuese mund të thuhet se kompetencat e Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e amendamenteve kushtetuese kanë ekzistuar, duke krijuar hapësirat për bërjen nga Gjykata Kushtetuese të kontrollit material të tyre, lidhur me vlerësimin e pajtueshmërisë së tyre me “bërthamën” e Kushtetutës. Kontrolli gjyqësor i ndryshimeve kushtetuese mund të behej duke kontrolluar pajtueshmërinë e amendimeve kushtetuese me ka dispozitat kushtetuese të cilat nuk mund ti nënshtrohen amendimeve kushtetuese, të tilla si: pavarësia dhe territori i shtetit, dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë themelore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetësa fetare, bashkëjetësa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat.

Bazuar në analizen e bërë në këtë punim, kam mendimin se ashtu si dispozita të shumta kushtetuese të cilat u ndryshuan për t’iu përshtatur zgjidhjes së problematikave të ndryshme juridike, edhe përcaktimi i shprehur i ekzistencës së dispozitave të caktuara kushtetuese të cilat nuk do mund të ndryshoheshin dhe parashikimi i kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për të bërë kontrollin material të amendamenteve kushtetues do të duhej të kishte gjetur pasqyrim në Kushtetutë. Kjo me qëllim garantimin e një stabiliteti më të madh të normave juridike të cilat përbëjnë bërthamën e Kushtetutës, duke garantuar siguri juridike për gjithë sistemin.

Bibliografia

Legjislacion

- Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kushtetuta e Mbretërisë së Norvegjisë
- Ligji Nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i ndryshuar
- Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 03/L-121, “Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës”

Vendime Gjyqësore

- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr.57, datë 05.12.1997
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr.4, datë 02.06.1995.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr.25, datë 24.07.2009
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr.31, datë 19.11.2003
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr. 8 datë 08.03.2013
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nr. K029/12 dhe nr. K048/12
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nr . K0 44/14
- Vendim i Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara, Coleman kundër Miller, nr. 353, datë 5 Qershor 1939

Literaturë

- Sadushi Sokol, “*Drejtesia kushtetuese në zhvillim*”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012
- Sadushi Sokol, “*Kontrolli kushtetues*”, Shtëpia Botuese “Botimpex”, Tiranë, 2004
- Anastasi, Aurela; Omari, Luan, “*E drejta kushtetuese*”, Shtëpia botuese “PEGI”, Tiranë 2010

- Anastasi Aurela, *“Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri”*, Shtëpia botuese “PEGI”, Tiranë, 2007
- Merkuri Erind, *“Kushtetushmëria e Kushtetutës – kontrolli kushtetues mbi ndryshimet kushtetuese”*, Punime akademike mbi nevojën për ndryshime kushtetuese, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
- Kapiti Enriko, *“Nevoja për kufizime eksplicite për rishikimin e kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”*, Punime akademike mbi nevojën për ndryshime kushtetuese, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
- Hasani, Enver, *“Kontrolli abstrakt dhe preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese dhe mbrojtja nga shkarkimi i shefit të shtetit: rasti i Kosovës”*, botuar në Revistën “E Drejta – Pravo – Law”, nr.1/2013, botim i USAID dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
- Opinion i Komisionit Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, *“Opinion mbi ndryshimet e fundit të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, miratuar nga Nën-Komisioni për Reformën Kushtetuese në 15 Prill 1998, CDL-INF (98) 9
- Opinioni i Komisionit Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, *“Opinioni jo përfundimtar mbi draft-amendamentet kushtetuese për gjyqësorin, në Shqipëri”*, miratuar në seancën e 105-të Plenare (18-19 Dhjetor 2015), Nr. 824/2015, CDL-AD(2015)045
- Opinioni i Komisionit Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, *“Opinion mbi situatën kushtetuese në Ukarainë”*, Miratuar në Seancën e 85-të Plenare (17-18 Dhjetor 2010), Nr. 599/2010, CDL-AD(2010)044
- Smith Eivind, *““Old and protected? On the “Supra-Constitutional clause in the Constitution of Norway”*”, Israel Law Review, Vol. 44: 369
- Garlicki Lech, Garlicka Z.A. *“External review of Constitutional Amendments? International Law as a norm of reference”*, Israel Law Review, Vol. 44: 343
- Choudry Sujit, *“Globalization in Search of Justification: Toward*

- a Theory of Comparative Constitutional Interpretation*”, Indiana Law Journal, Volume 74, Issue 3, Article 4
- Roznai Yaniv, “*Towards a Theory of Unamendability*”, New York University Public Law and Legal Theory Working Papers
 - Roznai Yaniv, “*Unconstitutional Constitutional Amendments: A Study of the Nature and Limits of Constitutional Amendment Powers*”, The London School of Economics and Political Science
 - Dixon Rosalind, “*Constitutional Amendment Rules: A Comparative perspective*”, Chicago Public Law and Legal Theory Working Paper, Nr 347
 - Albert Richard, “*The Expressive Function of Constitutional Amendment Rules*”, Boston College Law School Faculty Papers
 - Halmai Gabor, “*Internal and External Limits of Constitutional Amendment Sovereignty*”
 - Barak Aharon, “*Unconstitutional Constitutional Amendments*”
 - International Institute for Democracy and Electoral Assistance, “*Constitutional Amendment Procedures*”

Abstract

Prof.Asoc.Dr. Skerdian Kurti	SUBJEKTET PËRGJEGJËS PËR KRYERJEN E VEPRAVE PENALE NË SHOQËRITË TREGTARE..... 181
Arbër BASHOLLI & Prof. Asoc. Dr. Engjëll LIKMETA	KUNDERVAJTJA, NJE PERQASJE MIDIS NORMES KANUNORE DHE BASHKEKOHORE. (RASTI I KANUNIT TE LABERISE)..... 182
Dr. Ervin SULKO	DISA ASPEKTE TË INTERPRETIMIT KUSHTETUES 183
Dr. Saimir SHATKU & Phd.c. Erdi KUKA	CËNIMI I PARIMIT PACTA SUNT SERVANDA NË KUADËR TË KONTRATËS SPORTIVE (rastet Matuzalem dhe Ariosa)..... 184
Msc. Marbona CUKA	INTEGRITETI DHE ROLI I TIJ NË PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT..... 185
MSc, Doktorante Linda GJERMANI	BAZAT LIGJORE TE PROGRAMEVE TE NDIHMËS SË JASHTME TË BE..... 186
Msc. Agathi NANO	VEPRAT PENALE E FALIMENTIMIT NE TE DREJTEN PENALE TE EKONOMISE..... 187
Msc. Ajet MAKUTI	LIGJSHMËRIA E VEPRIMEVE TË AUTORITETIT PËRGJEGJËS KOMBËTAR NË RASTET E FLUTURIMEVE "RENEGADE" 188
Artemida HOXHAJ	KONTROLLI GJYQËSOR I AMENDAMENTEVE KUSHTETUESE. RASTI I SHQIPËRISË 189

Prof.Asoc. Dr. Skerdian KURTI

Abstract

Most of the offences envisaged under the Criminal Code and other specific laws can be committed by general subjects, while another part may be committed only by subjects that enjoy certain qualities. A special significance in commercial criminal law takes the detailed study and knowledge of the entities responsible for committing offences of an economic nature. As noted above, it comes to criminal offenses which can be committed not only by special subjects, but also by general ones. what appears problematic in the current case due to the highly technical nature of these offences is the knowledge and understanding of the distinctive features of particular subjects. The definition of responsible subjects constitutes an important problem for the configuration of these offences, due to the fact that we are dealing with special subjects, which are lined with special qualities, that charge them with clearly defined rights and duties. Such a formulation of these offences may give rise to no less important problems of interpretation, especially in the collaboration cases of foreign persons and the formal exercise of specific functions provided by law.

Doktor në proces Arbër BASHOLLI

*Inspektor në Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të
Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
Email: abasholli@gmail.com*

Prof. Asoc. Dr. Engjëll LIKMETA

*Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë,
Universiteti i Tiranës
E-mail: engjell.likmeta@fdut.edu.al*

Abstract

Based on the testimony of a long ancient criminal legal tradition, special attention should be paid also to the Albanian Canons, as an invaluable asset of the Albanian country and people.

This paper aims to elaborate the Albanian customary law in the Middle Age, evoking the Canons, as an important source of data regarding the measures used to protect the social relationships at that time against any offences/infringements, whether criminal or administrative.

In this paper an important part will be dedicated to the meaning of concept of offence/infringement according to the Canon of Laberia, as well as the canon's organs responsible for its application and enforcement.

In particular, in this essay special focus will be given to the canonical administrative and penal provisions of the Canon of Laberia regulating the investigation, trial and enforcement of decisions in relation to the offenses/infringements, as well as provisions regarding the rules for offenders, their responsibility, as well as the punitive measures taken against them for committing the offenses/infringements in term of administrative and penal perspective.

Keywords: Canon; Offence/Infringement; Investigation; Trial.

Ervin SULKO

Abstract

The subject of this paper is the individual complaint/petition at the Constitutional Court, conceived as a procedural tool that can be used by any person when his/her fundamental rights are violated, within the range of rights for a due process. The purpose of this paper is to give a complete overview of this institute, starting from its establishment, adoption from the Albanian Constitution, and prevision from different constitutional justice systems. It is worth highlighting that based on the individual complaint the researchers of constitutional justice have started to make a new classification of constitutional justice models. This is due to the fact that this institute was not adopted in the same manner by all the countries; it presents special features from one system to another.

The origin of individual complaint, as a very important institute of constitutional justice, was found for the first time in Mexico and later in Switzerland, Germany, Austria and Spain. The right to file an individual constitutional complaint was introduced in Albania with the establishment of the Constitutional Court, immediately after the collapse of the socialist regime. Despite the changes that this institute underwent, it continues to be an effective remedy in the Albanian justice system by the Constitution of 1998. For illustration purposes, in relation to the use of this remedy, its characteristics and nature in the Albanian legislation, some cases from the judiciary practice of Constitutional Court, are included as well. At the end, in relation to the individual complaint and its regulation in the relevant legislations, a comparative study of Western European countries is given. It is noted that in the countries that adopted this institute, it presents differences, both in terms of acts being contested, deadlines to exercise it, and legitimate subjects to file an individual complaint.

Dr. Saimir SHATKU

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Phd.c.Erdi KUKA

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Abstract:

One of the most delicate aspects concerning Sports Contract, as working or service relationship between athletes and clubs, is the respect of the principle *pacta sunt servanda* and the regulation of the consequences in case of violation of this principle.

In practice, this principle is violated most often through unilateral, immediate and unreasonable resolution of contract. One of the issues addressed in this paper is how domestic legislation regulates these cases, and how they are settled by international judicial institutions established for this purpose.

In this regard we have analyzed two cases from the world of football in Europe (in Matuzalem case, the violation comes from the athlete and Ariosa case, the violation is committed by the football club), as is the sport with the richest jurisprudence on the matter. Understandably, because the popularity and huge economic interests that connect all of the football actors.

*The aim of this study is to highlight the importance of having a written contract and the importance of respecting the principle *pacta sunt servanda*, as in any other contract.*

Keywords:

Sports contract, legal framework, international and EU law, sport, CAS¹.

1 Court of Arbitration for Sport.

Msc. Marbona CUKA

Abstract

All the people want to live in a country with a high level of prosperity. Nobody wants to be represented by corrupt politicians, unprepared governors, or politicians who care only for their family members.

So, the question is: Can this be possible?

Governments, political parties, organizations, constantly declare that things can change and that they categorically oppose corruption. Unfortunately, the promises made, a great constitution, a good democracy built theoretically, are not enough to change the status quo. This gap between theory and practice, this lack of significant movement towards change, constitutes the goal of this paper.

Integrity, transparency and good governance are essential for the development of each country, within and outside Europe. These values are the foundation of a functioning democracy and a prerequisite for effective services to citizens. It is easier to say than done. It seems difficult to make real changes in society. Many countries all over the world are strengthening their repressive approach towards corruption through anti-corruption strategies, the adoption of laws, structures and agencies. Some countries are more and others less successful in their implementation. However, the focus only on repressive side of the medal is not enough. It is equally important to develop preventive policies to promote the construction of good governance and integrity. Recent years we have notify the increased international interest in the integrity as part of good governance. It also increased awareness that without a culture of good governance and integrity, the democracy will remain weak.

The research work for this paper is mainly based on foreign sources.

Keywords: *integrity, corruption, good governance, preventive policies.*

MSc, doktorante Linda GJERMANI

Summary

The role of European Community as provider of external assistance to developing countries is sanctioned in its founding Treaty. The Treaty enables EC to provide funding to developing countries but in a “complementary role“ to that of individual Member States. Currently, EC finances a number of assistance programs of geographical and thematic nature in addition to an European Development Fund funded by individual Member States and managed separately. Each program, called “instrument“ in the EC terminology, is guided by a specific Regulation. An additional legal framework for aid delivery is provided by the international agreements signed by the EC. EU is trying to speak with one voice with the Member States concerning development issues and is strengthening its representation worldwide through its Delegations. In the coming future, throughout the enlargement and primarily the consolidation process, it is likely that the legal framework of the Treaties will need post-Lisbon revisions in order to allow EC a primary role in foreign aid issues, compared to that of the Member States. EC might well become the leader and coordinator of their assistance instead of being mainly a complementary.

Msc. Agathi NANO

Abstract

In today's post-industrial society is paid more and more attention to the special development and protection of national economies within the globalization process.

Part of this economy is the economic and financial activity exercised by legal entity, considered as the most vital engine in the market economy.

It happens that, the legal entity, after reaching the stage of insolvency, enters to the bankruptcy procedures. This phase includes not only a set of rights and obligations for the insolvent debtor, but also carries the possibility of violation a range of interests of other persons involved in the creditor- debtor relationship.

Namely, if the cessation of legal entity's activity is realized knowingly and with intent to impair of its creditor's property interests, is putting into motion the tightening apparatus of criminal law, as *extrema ratio*, aiming to safeguard the creditor's interests and the regulation of this balance.

Albanian criminal legislation, in accordance with the change of economic and financial circumstances, provides in Chapter III of "Crimes against property and economic sphere", a category of offenses, through which it aims to ensure the smooth operation of the economic market, the strictly implementation of the bankruptcy procedure, as well as guaranteeing the creditor's rights and interests.

Forecast offense "bankruptcy" in our criminal law, it is due to the necessity of harmonization of our legislation with the *acquis communautaire*, as step toward Albania's membership in the European Union.

This paper aims to analyze the criminal offense of bankruptcy focusing as in its formal legal analysis but also presenting comparative reflections.

Ajet MAKSUTI

Abstract

The events of September 11, 2001 in the US showed that civil aircraft can be used as weapons to carry out terrorist attacks. This unknown action until then brought fundamental changes in the theory of threat and risk assessment. The reaction, in the framework of measures is easily visible, but very difficult in reality, as it implies several factors, including legal (international and domestic law), moral, psychological, military ones, etc.

On the difficulties of applying international law on the use of weapons against civil aircrafts there are experiences from different countries, to which we can refer to in order to design the measures that are being required. The problem arises if a state must sacrifice innocent people who are flying? What options does the international law provide for treating these cases?

Combating air threat requires the use of a wide range of organizational and technical efforts based on appropriate legislative solutions. The objective of this concept is to support the decision making process by providing the national authorities (NGAs) responsible for airspace security with real time reliable information about airspace security incidents. NGAs are considered as the end user and the rest actors should play only supporting role and facilitate the decision making process. One should keep in mind that there is no uniform procedure regarding the renegade. Each situation will be always assessed on individual basis and civil just like military controllers must be trained to identify suspicious behavior and to work in close cooperation.

Due to the complexity it carries out, this problem is still pending a final solution in terms of international law or national legislation that must be applied in such cases.

Artemida HOXHAI

Abstract

This paper aims to analyze the judicial control of constitutional amendments in the Republic of Albania, based not only on the provisions of the law, jurisprudence and attitudes of internal researchers, but also taking into account the major legal provisions of various international law systems, presenting the main tendencies that are internationally evidenced regarding the judicial control of constitutional amendments, in the context of the complete analysis of the judicial control of constitutional amendments in Albania. Through this analysis, the competences of the Constitutional Court of Albania are highlighted regarding the control of constitutional amendments during different periods of law development, starting in 1992.

